

**E DREJTA E JETËS SI E DREJTË KUSHTETUESE E PARË NË
KËNDVËSHTRIMIN E NENIT 2 TË KEDNJ-SË ME FOKUS
MBROJTJEN PROCEDURIALE**

Gerhard ISMAILI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat juridike, me profil e Drejta Publike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor:

Phd. Mirgen Prence

Numri i fjalëve: 58.390

Tiranë MAJ 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

©E drejta e autorit: Gerhard Ismaili. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

I vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm për rregullat e Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës në lidhje me plagjiaturën. Deklaroj se ky punim shkencor i paraqitur, është tërësisht punim origjinal i imi dhe nuk përmban materiale të shkruara nga persona të tjerë, me përjashtim të materialeve të referuara.

Botimi dhe riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i këtij punimi apo pjesëve të tij pa pëlqimin tim është i ndaluar.

ABSTRAKT

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në mënyrë të veçantë e drejta për jetën ka gjetur pasqyrim në mënyrën më të plotë në kushtetutat demokratike të çdo shteti. Por këto të drejta dhe liri nuk mund të respektohen dhe të gëzohen pa asnjëlloj kufizimi, pasi një mbrojtje absolute dhe e njëjlojtë e të drejtave në të gjitha aspektet dhe në përgjithësi për çdo shtetas, do të ishte praktikisht e pamundur. Prandaj ekzistojnë kufizimet në të drejtat dhe liritë themelore të individit, që kushtetutat dhe aktet ndërkombëtare i kanë klasifikuar si kufizime të lejueshme. Pavarësisht nga ky kuptim, ekzistojnë disa të drejta, që janë absolutisht të pacënueshme, për të cilat as vetë kushtetutat nuk e kanë mundësinë e lejimit të kufizimit të tyre. E drejta për të jetuar si atribut fundamental dhe vlerë e padiskutueshme e qenies njerëzore, është një nga këto të drejta të rëndësishme që mbrohet me ligj. Jeta njerëzore, duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore si një vlerë e cila qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Por mbrojtja e jetës së njeriut është e influencuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm, për të cilët edhe ligjvënësi mund të jetë ai që nëpërmjet ligjit që harton e miraton, të parashikojë hollësitë që mund të garantojnë këtë jetë njerëzore. Vetëm nëpërmjet ligjit mund të bëhen përjashtimet, kur si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese, kërkohet të hiqet jeta e dikujt. Ligji është ai, të cilit i jepet e drejta, në raste të veçanta dhe që kanë lidhje me vdekjen, në kuptim të nenit 2, pika 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mbi këto koncepte të drejta është ndërtuar legjislacioni ynë që më shumë i përgjigjet kushteve të një shoqërie moderne, të emancipuar dhe një demokracie solide. Në këtë aspekt legjislacioni shqiptar paraqitet shumë më pararendës se mentaliteti shoqëror dhe tradicional, gjë që përbën një pengesë tepër të vështirë në përsosjen dhe konsolidimin e kësaj shoqërie.

ABSTRACT

Respect of human rights and fundamental liberties and in particular the right of living has been reflected in the most democratic constitutions of any state. But these rights and liberties are respected and can not be indulged without any sort of restriction, as an absolute and uniform protection of human rights in all aspects and for every citizen in general; it would be virtually impossible. Therefore there are restrictions on the rights and liberties of the individual, that constitutions and international instruments have been classified as permissible restrictions. Despite this understanding, there are some rights that are absolutely inviolable, for which there is not a constitutions' possibility of allowing their limitations. The right of living as a fundamental attribute and unquestionable value of the human being, is one of these important rights protected by law. Human life, being considered such value since its inception, becomes a value above all other values protected by the Constitution of the Republic of Albania. In this way, legal protection of human life is a value that underlies all human rights and its denial would bring elimination of other human rights. But the protection of human life is influenced by a variety of factors, for which the legislator, through the laws that approve or design, provides details that can guarantee this human life. Exceptions can be made, only because of the law , when; as a consequence of protecting the most important constitutional right, someone's life is required to be taken. Law has the right in exceptional cases and related deaths, in the sense of Article 2, paragraph 2 of the European Convention on Human Rights. Our legislation is built on these concepts, in order to respond to the conditions of a modern, emancipated and a solid democracy. Regarding this matter, Albanian legislation appears much precursor to social and traditional mentality, which is a very difficult obstacle to perfection and consolidation of our society.

DEDIKIMI

Këtë punim ja dedikoj familjes time...!

FALENDERIME

Përfundimi i këtij studimi doktoral është bërë i mundur falë përkrahjes dhe dashamirësië së shumë personave, të cilët me mbështetjen e tyre më dhanë forcë për të përfunduar me sukses këtë projekt.

Natyrisht që një kontribut të padiskutueshëm në përfudimin e këtij studimi ka dhënë edhe udhëheqësi im PhD Mirgen Prencë të cilin e falenderoj përzemërsisht për mbështetjen, këshillat, rekomandimet, orientimet e nevojshme, kohën e shpenzuar, si dhe për mendimet me vlerë që më ka dhënë, pa të cilat ky punim nuk do të kishte përfunduar me sukses.

Falenderoj gjithashtu të gjithë kolegët e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për mirëkuptimin dhe ndihmën e vazhdueshme që më kanë dhënë në çdo rast, gjatë punës dhe hulumtimit shkencor për këtë studim.

Një tjetër falënderim i veçantë dhe i çmueshëm shkon për familjen time, për përkushtimin që kanë treguar ndaj meje gjatë gjithë këtyre viteve të studimit tim në Shkollën e Doktoraturës pranë UET, duke më mbështetur në çdo hap dhe në çdo iniciativë jetësore dhe studimore që kam ndërmarrë.

E DREJTA E JETËS SI E DREJTË KUSHTETUESE E PARË NË KËNDVËSHTRIMIN E NENIT 2 TË KEDNJ-SË ME FOKUS MBROJTJEN PROCEDURIALE

DEKLARATA E AUTORËSISË.....I

ABSTRAKT.....II

DEDIKIM.....IV

FALËNDERIME.....V

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KREU I: HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

1. Hyrje.....fq.1

2. Objektivat e studimit.....fq.3

3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit.....fq.3

4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor.....fq.5

5. Rëndësia dhe nevoja e studimit.....fq.5

6. Përmbledhja e kapitujve.....fq.8

KAPITULLI II: KONCEPTE TË PËRGJITHSHME MBI NATYRËN, FILLIMIN

DHE FUNDIN E JETËS

1.1. Kuptimi i jetës.....fq.10

1.2. Natyra dhe fillimi i jetës sipas nenit 2 të KEDNJ-së.....fq.14

1.3. Aborti dhe e drejta për jetën sipas nenit 2 të KEDNJ-sëfq.17

1.3.1. Rregullimi ligjor i brendshëm i Shteteve Pale të Larta Kontraktuese.....fq.21

1.3.2. Çështjet e abortit në Shqipëri. Problematikat dhe sfidat e radhës.....fq.24

1.4. Eutanazia. Vështrimi i përgjithshëm historik mbi konceptin e saj.....	fq.29
1.4.1. Koncept-përkufizimi i eutanazisë.....	fq.32
1.4.2. Format e eutanazisë.....	fq.35
a) Çështja <i>Dianne Pretty</i>	fq.41
b) Çështja <i>Lambert</i>	fq.43
1.4.3. Vetëvrasja dhe ndihma në vetëvrasje. Zhvillimet e fundit.....	fq.46
1.5. Dënimi me vdekje. Çështja e dënimit me vdekje sipas KEDNJ-së.....	fq.52
1.5.1. Neni 2 dhe Protokoli 6 dhe 13, shfuqizimi i dënimit me vdekje	fq.56
1.5.2. Çështja e dënimit me vdekje dhe zhvillimi historik në Shqipëri.....	fq.61
1.5.3. Parashikimi ligjor në vende të tjera	fq.62
1.5.4. Dënimi me vdekje dhe ekstradimi.....	fq.64
1.5.5. Ekstradimi, përjashtimi dhe dëbimi.....	fq.65
1.5.5.1. Çështja <i>Rrapo kundër Shqipërisë</i> si e vetmja çështje kundër Shqipërisë në kuadër të nenit 2 të KEDNJ-së.....	fq.75

KAPITULLI III: DETYRIMET POZITIVE PËR TË MBROJTUR JETËN SIPAS NENIT 2 KEDNJ. PËRPUTHSHMËRIA ME KUSHTET SUBSTANTIVE

3.1. Përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës.....	fq.78
3.2. Mbrojtja e jetës dhe integritetit të personave.....	fq.87
3.2.1. Detyrimet me karakter thelbësor.....	fq.87
3.2.2. Mbrojtja e jetës me ligj.....	fq.91
3.2.3. Mbrojtja që imponohet në kuadrin e veprimeve të organeve shtetërore.....	fq.94
3.2.4. Mbrojtja nga rreziqet që lindin si pasojë e veprimit të pushtetit publik.....	fq.97
3.2.5. Mbrojtja e individëve ndaj dhunës vdekjeprurëse të shkaktuar nga të tjerët..	fq.100

3.2.6. Mbrojtja nga vdekjet e personave që ndodhen në masën e arrestit.....	fq.110
3.2.7. Mbrojtja nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse në konfliktet ndërkombëtare të armatosura.....	fq.116
3.2.8. Parandalimi i vetëvrasjes.....	fq.123
3.2.9. Përdorimi i forcës me efekt vdekjeprurës nga agjentët e shtetit.....	fq.126
3.2.10. Detyrimi për të mbrojtur jetën në rrethana të tjera (<i>mbrojtja kundrejt rreziqeve mjedisore</i>).....	fq.131
3.3. Elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës.....	fq.138
KAPITULLI IV: ASPEKTET PROCEDURALE TË NENIT 2 KEDNJ	
4.1. Aspektet e mbrojtjes procedurale që ofron KEDNJ për mbrojtjen e jetës.....	fq.141
4.1.1. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik.....	fq.143
4.1.2. Hetimi duhet të jetë i plote dhe rigoroz.....	fq.147
4.1.3. Hetimi duhet të jetë i tillë që të përcaktojë përgjegjësinë e vdekjes.....	fq.151
4.1.4. Shpejtësia e autoriteteve në hetim.....	fq.153
4.1.5. Mundësia e marrjes pjesë të të afërmeve në procedurë.....	fq.156
KAPITULLI V: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	
5.1. Konkluzione.....	fq.159
5.2. Rekomandime.....	fq.167
BIBLIOGRAFIA.....	fq.169

KREU I: HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

1. HYRJE

E drejta e jetës është një e drejtë themelore e paderogueshme, e pandashme dhe e patjetërsueshme e individit. Ajo është një e drejtë themelore me fokus të gjerë, në të cilin përfshihen çështje që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme. E drejta për jetën gëzon një mbrojtje të posaçme nga instrumentat ndërkombëtare, ato evropiane, rajonale dhe kombëtare. Instrumentat ndërkombëtarë në lidhje me të drejtën e jetës i kushtojnë më rëndësi ekzistencës së jetës si dhe cilësisë së të jetuarit si proces, aq më tepër shoqëritë të cilat bazohen në një demokraci funksionale dhe në Shtetin e së drejtës.

Në këtë punim do të trajtojmë një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me të drejtën e jetës, pra elementët thelbësorë të së drejtës së jetës, siç janë mbrojtja substanciale, mbrojtja procedurale, detyrimet negative dhe detyrimet pozitive që ka shteti në mbrojtjen e jetës. Në fakt janë shtetet ato të cilat ofrojnë standarde më të larta për të drejtat themelore karshi individëve dhe qytetarëve të tyre si dhe implementimin e këtyre të drejtave. E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së si dhe në Protokollet Shtesë të kësaj Konvente. Të drejtat dhe liritë e sanksionuara nga Konventa Evropiane e të drejtave të Njeriut u bënë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (këtej e tutje GJEDNJ) në raport me çdo të drejtë të cënuar në të. GJEDNJ-ja është kompetente që të kontrollojë dhe sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e normave të përcaktuara në KEDNJ nga ana e institucioneve legislative dhe ekzekutive të Palëve të Larta Kontraktuese.

GJEDNJ-ja mund të vihet në lëvizje vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore sipas kuptimit nga parimet përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Vendimet e Gjykatës janë detyruese. Kur GJEDNJ-ja konstaton një shkelje, vendi në fjalë është i detyruar të ekzekutojë vendimin, duke marrë masa për të siguruar që një shkelje e tillë e ngjashme të mos ndodhë më.

E drejta e jetës, me të gjitha ato të drejta të tjera që rrjedhin dhe kushtëzohen prej saj, është e garantuar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kuadrin e lirive dhe të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që ndodhen në territor. Në bazë të nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kujtdo i sigurohet mbrojtja e jetës me ligj.

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtës së jetës së individit, e konceptuar dhe e sanksionuar si një nga të drejtat më themelore të njeriut, qëndron në themel të legjislacionit tonë kushtetues dhe të atij penal e procedural penal. Vendi që zë KEDNJ në legjislacionin e brendshëm shqiptar, përcaktohet qartë nga Kushtetuta e Shqipërisë. Mbrojtja e jetës së njeriut në çdo moment dhe në të gjitha rrethanat nuk është e njëjtë, pasi ajo është e influencuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm, për të cilët edhe ligjvënësi mund të jetë ai që nëpërmjet ligjit që harton e miraton, të parashikojë hollësitë që mund të garantojnë këtë jetë njerëzore. Vetëm nëpërmjet ligjit mund të bëhen përjashtimet, kur si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese ose thjesht të një të drejte tjetër që prevalon atë kohë, sipas rrethanave të çastit, kërkohet të hiqet jeta e dikujt. Jeta e individit është subjekt mbrojtjeje kushtetuese nga fillimi i saj dhe deri në përfundim. Për këtë arsye konsiderohet absolutisht e nevojshme të caktohen qartë kufijtë kohorë brenda kornizës të së cilëve gjejmë zbatim të gjitha parashikimet ligjore mbrojtëse të kësaj të drejte. Mendimet janë të ndryshme për atë çka përbën *fillimin e jetës* pra për *kur fillon ajo, por dhe kur mbaron?*

Një vlerë të veçantë në këtë studim ka përkufizimi dhe përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive nga ana e shtetit dhe agjentëve që veprojnë në emër të tij sidomos në funksion të mbrojtjes së jetës dhe integritetit të personave. Këto në fakt janë detyrimet me karakter thelbësor si për shembull mbrojtja e jetës me ligj dhe elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës. Një vend të rëndësishëm në këtë studim janë e drejta për jetë e fetusit, e drejta në vdekje, mbrojtja që imponohet në kuadrin e veprimeve të organeve shtetërore, mbrojtja nga rreziqet që lindin si pasojë e veprimit të pushtetit publik, mbrojtja ndaj të tretëve, parandalimi i vetëvrasjes dhe përdorimi i forcës me efekt vdekjeprurës nga agjentët e shtetit. Vitet e fundit është studiuar në kuadër të mbrojtjes së jetës edhe detyrimi për të mbrojtur jetën në rrethana të tjera siç mund të konsiderohen rreziqet mjedisore.

2. Objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i kësaj teze është të hulumtojë mbi të gjitha elementët kryesorë të së drejtës së jetës. Neni 2 përmban dy elementë thelbësorë që pasqyrohen në dy paragrafët e tij: një detyrim të përgjithshëm për të mbrojtur të drejtën për jetën “me ligj” (paragrafi 1) dhe ndalimin e privimit të jetës që rrethohet nga një listë përjashtimesh (paragrafi 2).

Qëllimi i këtij punimi doktoral nuk kërkon të analizojë vetëm proceset e mbrojtjes së jetës në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në qasjet e lartëpërmendura por dhe duke vëzhguar disa të drejta dhe liri themelore në praktikë, siç janë ato që kanë të bëjnë me procedurat e mbrojtjes, çështjet e abortit, eutanazisë etj. Jeta e individit është subjekt mbrojtjeje kushtetuese nga fillimi i saj dhe deri në fund. Për këtë arsye konsiderohet absolutisht e nevojshme të caktohen qartë kufijtë kohorë brenda kornizës të së cilëve gjejnë zbatim të gjitha parashikimet ligjore mbrojtëse të kësaj të drejte.

Objektivat e këtij punimi në mënyrë konkrete dhe të listëzuara janë:

- Analiza e mbrojtjes së të drejtës së jetës sipas nenit 2 KEDNJ-së
- Kufizimet e të drejtës së jetës. Aborti dhe eutanazia si kufizim i të drejtës së jetës.
- Studimi i thelluar dhe analizë e jurisprudencës së GJEDNJ-së
- Analiza e zbatimit të legjislacionit shqiptar në përputhje me standartet e vendosura nga KEDNJ-ja
- Analiza e përputhshmërisë me kushtet substantive të nenit 2.
- Përcaktimi i termave konkrete substanciale dhe procedurale për mbrojtjen e të drejtës së jetës.
- Përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive që ka shteti dhe agjentët e tij për mbrojtjen e jetës së individëve, me një fokus të veçantë në mbrojtjen procedurale.

3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit

3.1. Pyetjet hulumtuese të studimit

Arkitektura e një hulumtimi shkencor kurrësi nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do të përmbante dy elementë domethënës të tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura.

Pyetjet hulumtuese kanë rëndësi të veçantë për projektin kërkimor, sepse janë ato të cilat na japin drejtimin kryesor të studimit.

Në këtë studim kemi ngritur disa pyetje kërkimore. Pyetjet kërkimore janë në funksion të shtjellimit të fushës sonë të studimit lidhur me të drejtën e jetës. Ato janë:

1. Ç'kuptojmë me jetë? Kur fillon jeta dhe kur mbaron ajo?
2. Si mund të mbrohet e drejta për jetën?
3. A duhet të ketë dhe një të drejtë për të vdekur? A është e drejta për të vdekur rrjedhojë e të drejtës për të jetuar? A mundet individi të zgjedhë vetë të vdesë, pra a duhet legalizuar eutanazia?
4. Në ç'mënyrë e realizon shteti dhe vetë shoqëria civile mbrojtjen e jetës?
5. Cilat janë aspektet substantive dhe proceduriale të nenit 2 KEDNJ?

3.2. Hipotezat e studimit

Elementi i dytë i rëndësishëm në arkitekturën e punimit doktoral është hipoteza e studimit, e cila paraqitet në funksion dhe mbështetje të pyetjeve kërkimore. Ky studim ofron disa hipoteza të rëndësishme që shtrojnë problemin kryesor. Studimi përpiket të tregojë vërtetësinë e këtyre hipotezave në të gjithë paragrafët e tij.

Në mënyrë që t'i jepet një përgjigje pyetjes kërkimore dhe pyetjeve të tjera që ky punim doktoral ngre për shqyrtim; hipoteza kryesore mbështetet mbi premisën se vlera më superiore për shtetin dhe shoqërinë është njeriu dhe jeta e tij, e cila qëndron në themel të të gjitha të drejtave.

Në këtë drejtim *HIPOTEZA I* është që e drejta e jetës në përgjithësi, mbrohet në nivel të kënaqshëm edhe në vendin tonë, nëpërmjet institucioneve përgjegjëse që kryesojnë Shtetin.

HIPOTEZA II- Nuk ekziston ende një kompromis evropian ligjor apo shkencor në lidhje me përkufizimin biologjik të jetës, pasi Konventa (dhe po ashtu edhe shtetet Palë të Larta kontraktuese) nuk e qartësojnë se kur fillon apo mbaron jeta me qëllim përcaktimin e qartë të mbrojtjes së saj sipas nenit 2 KEDNJ.

HIPOTEZA III- Ndërkohë që mbrojtja substanciale e të drejtës së jetës në vendin tonë është gjithëpërfshirëse dhe e plotë, mbrojtja procedurale e të drejtës së jetës nuk zbatohet në mënyrën e duhur. Aspektet procedurale në vendin tonë lënë vend pikërisht për përmirësime të mëtejshme.

4. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor

Metodologjia përfaqëson një reflektim korrekt dhe të logjikshëm të analizës shkencore të projektit doctoral. Metodologjia në këtë studim përfaqëson analizën logjike, juridike dhe institucionale të mbrojtjes së jetës, si në detyrimet pozitive ashtu edhe në ato negative. Studimi ka në fokus të drejtën e jetës dhe konceptin kushtetues mbi të drejtën e jetës, si dhe të ndihmojë sadopak në përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar dhe për të arritur këtë qëllim mbledhja e të dhënave të këtij studimi mbështetet në një kombinim të disa metodave shkencore të përdorura, siç janë:

Metoda Historike: Ky studim ndër të tjera synon të japë dhe një panoramë më të detajuar lidhur me të drejtën e jetës deri në ditët e sotme dhe për të arritur këtë qëllim është përdorur metoda historike. Kjo ka një rëndësi të veçantë për të kuptuar rëndësinë e kësaj të drejte. Konkretisht është parashikuar në Kapitullin e dytë.

Metoda Cilësore: Për një analizë më të thelluar është përdorur edhe metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave si një model i efektshëm që na jep mundësi të përfshihemi më shumë në kontekstin aktual të repsektimit të së drejtës së jetës duke marrë në studim përjasjen që ka ligjvënësi shqiptar për të garantuar këtë të drejtë por dhe duke studiuar edhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë në rastet e cënimit të kësaj të drejte.

Metoda analitike: Ky punim për vetë karakteristikat e tij është mbështetur në metodën cilësore të analizimit të çështjeve të trajtura në të. Kjo metodë e përdorur në këtë studim bazohet kryesisht në analizën dispozitave ligjore e Kushtetuese, instrumentave apo akteve ndërkombëtare që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtës së jetës, në analizën e dimensionin social të së drejtës së jetës si e drejtë e padiskutueshme universale dhe e

patjetërsueshme si dhe në analizën e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Metoda hulumtuese: Kjo metodë është përdorur gjatë gjithë studimit. Kjo metodë përfshin procesin e mbledhjes së materialeve në format e shkruara dhe elektronike; të mbledhjes së vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe gjykatave të tjera në funksion të shkrimit dhe strukturës së temës. Hulumtimi është një proces që ka shoqëruar gjithashtu fazën e sistemimit të zërave bibliografik në funksion të finalizimit të këtij punimi.

Metoda përshkruese: Kjo metodë e përdorur në këtë studim ka pasur si qëllim përshkrimin dhe studimin e rasteve konkrete të përzgjedhura në mënyrë të kujdesshme duke iu referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për të zbuluar në thellësi mënyrën sesi kjo Gjykatë ka interpretuar Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut dhe përmbajtjen e kësaj konvente në lidhje me të drejtën e jetës. Gjithashtu metoda përshkruese e përdorur është një mjet i domosdoshëm për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme nga aspekte ligjore në ato praktike.

5. Rëndësia dhe nevoja e studimit

Pasi u njohëm me problematikën e këtij punimi dhe me parashtrimin e pyetjes kërkimore dhe argumentit kryesor, i cili do të përbëjë vektorin e kësaj teze, do të na duhet ta vendosim studimin brenda kuadrit të fushës studimore përkatëse dhe të paraqesim rëndësinë e këtij studimi, nevojën pse duhet te analizohet si dhe debatet akademike rreth fushës në fjalë.

Ky studim ka rëndësi të veçantë të studiohet pasi e drejta e jetës është e drejta parësore dhe prej të cilës burojnë edhe gjithë të drejtat e tjera. Rëndësia e studimit duket qartë edhe në kuadër të angazhimeve të vendit tonë për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të individit jo vetëm në kuadër të angazhimeve që rrjedhin prej antarësimit të KEDNJ por edhe në kuadër të respektimit të këtyre të drejtave me fokus integrimin e vendit në BE.

Po ashtu me rëndësi të veçantë paraqitet studimi pikërisht sepse e drejta e jetës përfshin elemente të cilët evoluojnë me kohën, ka prurje dhe analiza të reja sidomos sa i takon nivelit rajonal, KEDNJ-së dhe jurisprudencës së fundit të GJEDNJ-së lidhur me të drejtën e jetës. Në fakt vlen të theksohet këtu se kjo jurisprudencë, edhe lidhur me Shqipërinë thekson faktin që gjykatat shqiptare duhet të jenë më të kujdesshme në respektimin e standarteve të vendosura dhe duhet të realizojnë më mirë mbrojtjen e jetës nga pikëpamja procedurale. Kushtet procedurale të Nenit 2, po ashtu janë patjetër të të njëjtës rëndësie dhe në çështjet e vdekjeve të individëve që janë nën masën e arrestit. Në këtë kuadër, parashtrojmë dy konstatime. Së pari, detyrimi për një hetim të rregullt dhe brenda standarteve, për të përcaktuar faktet dhe për të siguruar përgjegjësinë e shtetit për vdekjen e individëve nën masën e arrestit “nuk kufizohet vetëm në çështjet ku është e dukshme se vdekjet janë shkatuar nga agjentë të shtetit”. Gjithmonë dhe në të gjitha rastet, autoritetet e një shteti kanë për detyrim të kryejnë hetime kur raportohet vdekja e një personi ndërsa mbahet nën arrest. Në të njëjtën mënyrë operacionet e forcave policore, përveçse duhet të jenë të autorizuar nga e drejta vendase, duhet të jenë të përcaktuara qartë nga kjo e drejtë në kuadrin e një sistemi garantues adekuat dhe të efektshëm, që ofron mbrojtje ndaj arbitraritetit dhe abuzimit me forcën e mekanizmave shtetërorë, madje edhe ndaj aksidenteve të paevitueshme, përfshirë këtu edhe detyrimin për një formim adekuat të forcave policore dhe të sigurisë.

Në këtë drejtim, pjesë e analizës do të jetë gjithashtu detyrimi pozitiv për Shtetet për të ndërmarrë hapat e duhura në mbrojtje të jetës së personave që ndodhen brenda juridiksionit të tyre, për çështjet në lidhje me problemet mjedisore që pretendohen se ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale që mbrohen nga Konventa, duke përfshirë pikërisht të drejtën për jetën. Po ashtu, një vlerë të veçantë, edhe pse konsiderohet një problem i kapërcyer, mbart çështja e dënimit me vdekje. Këtu studimi do të fokusohet në analizën konstruktive mbi debatet që mbartin sot çështjet e ekstradimit për shtetasit shqiptarë si dhe problematikat që shfaq vëndi ynë në funksion të mbrojtjes nga neni 2 i KEDNJ-së.

6. Përmbledhja e kapitujve

Punimi doktoral është strukturuar në bazë të një analize teorike gjithëpërfshirëse, dhe jurisprudenciale të ndarë në gjashtë krerë kryesorë. Secili nga kapitujt ka nëndarjet e veta dhe trajton aspekte të veçanta të punimit, të artikuluar në paragrafë dhe nënparagrafë. Kreu i parë, shqyrton aspektin hyrës dhe bazën metodologjike të studimit mbi të drejtën e jetës. Analiza e këtij kapitulli zhvillohet mbi bazën e një informimi të përgjithshëm, në lidhje me temën e projektit dhe me situatën në të cilën është vendosur objekti i studimit, pra elementët thelbësorë të së drejtës së jetës, me fokus të veçantë në mbrojtjen e saj. Pjesa e parë hyrëse analizon qëllimin e përgjithshëm, problematikën që mbart studimi si dhe rëndësinë ose vakumin që ai mbart në mjedisin shqiptar të kërkimit shkencor, ashtu sikurse dhe nevojën për studime të thelluara. Pjesa e dytë e këtij kapitulli zhvillon një analizë të dy elementëve bazë të studimit, pyetjen kërkimore të tij dhe hipotezën mbi bazën e të cilës është ngritur studimi. Themelet e projektit janë mbështetur tek metodologjia dhe llojet e metodave mbi të cilat është bazuar studimi.

Kreu i dytë, përmban një analizë të detajuar të aspektit historik të studimit. Kapitulli ngrihet mbi një analizë konceptuale të çështjeve kryesore që përbëjnë objektin e studimit lidhur me konceptin e mbrojtjes juridike të së drejtës së jetës, çështjet e fillimit dhe të mbarimit të jetës, për të saktësuar efektivisht mbrojtjen që garantohet nga neni 2 KEDNJ-së. Kapitulli trajton çështjet e rregullimit ligjor të brendshëm, sa dhe si përshtatet ai me standartet e Konventës si dhe çështjet e abortit, fetusit dhe të eutanazisë. Një vend të rëndësishëm në këtë kre është sfondi historik. Analiza nis pikërisht me fillesat e mbrojtjes së kësaj të drejte të para në këndvështrimin e evoluimit si dhe të aritjeve në këtë fushë. Këtu trajtohen në mënyrë konkrete kuptimi i jetës, aborti dhe e drejta për jetën sipas nenit 2 të KEDNJ-së, rregullimi ligjor i brendshëm i Shteteve Palë të Larta Kontraktuese si dhe çështjet e abortit në Shqipëri bashkë me problematikën dhe sfidat e radhës. Një vend të rëndësishëm në këtë kre ka vështrimi i përgjithshëm historik mbi konceptin e eutanazisë, përkufizimi i eutanazisë, format e eutanazisë, vetëvrasja dhe ndihma në vetëvrasje. Diskutimet aktuale mbi aplikimin e eutanazisë në vendin tonë janë gjithashtu pjesë e këtij kreu. Një pjesë të rëndësishme ketu zë edhe çështja e dënimit me vdekje në KEDNJ,

çështja e dënimit me vdekje dhe zhvillimi historik në Shqipëri dhe ekstradimi. Vlerë në këtë kre ka dhe çështja *Rrapo kundër Shqipërisë* si e vetmja çështje kundër Shqipërisë në kuadër të nenit 2 të KEDNJ-së.

Kreu i tretë trajton detyrimet pozitive për të mbrojtur jetën sipas nenit 2 të KEDNJ-së dhe përputhshmërinë me kushtet substantive, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë te përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës, mbrojtjen e jetës dhe integritetit të personave, duke i ndarë ato në detyrime me karakter thelbësor si mbrojtja e jetës me ligj, mbrojtja që imponohet në kuadrin e veprimeve të organeve shtetërore, mbrojtja nga rreziqet që lindin si pasojë e veprimit të pushtetit publik, mbrojtja ndaj të tretëve, mbrojtja nga vdekjet e personave që ndodhen në masën e arrestit, mbrojtja nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse në konfliktet ndërkombëtare të armatosura, mbrojtja e individëve ndaj dhunës vdekjeprurëse të shkaktuar nga të tjerët. Pjesë e këtij kreu është analiza e detajuar edhe e disa elementëve të tjerë të rëndësishëm në mbrojtjen e jetës sic është: parandalimi i vetëvrasjes, përdorimi i forcës me efekt vdekjeprurës nga agjentët e shtetit, detyrimi për të mbrojtur jetën në rrethana të tjera si mbrojtja kundrejt rreziqeve mjedisore. Po ashtu në këtë kre janë analizuar edhe elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës.

Kreu i katërt trakton aspektet e mbrojtjes procedurale që ofron KEDNJ-ja për mbrojtjen e jetës. Këtu analiza fokusohet në elementët konkretë të hetimit dhe mënyrën se si duhet te kryehet ai. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik; duhet të jetë i plotë dhe rigoroz. Po ashtu hetimi duhet të jetë i tillë që të përcaktojë përgjegjësinë e vdekjes. Pjesë e kësaj analize është edhe përcaktimi i disa kriterëve të tjera të rëndësishme në procesin e hetimit si për shembull shpejtësia e autoriteteve në hetim si dhe domosdoshmëria e një hetimi *expost* së bashku me mundësinë e marrjes pjesë të të afërmeve në procedurë.

Kreu i pestë përmban konkluzionet dhe rekomandimet e studimit lidhur me të drejtën e jetës së bashku. Pjesë e këtij punimi është edhe bibliografia e cila është ndarë në burime parësore, burime dytësore dhe ato të marra nga web-i.

KAPITULLI II: KONCEPTE TË PËRGJITHSHME MBI NATYRËN, FILLIMIN DHE FUNDIN E JETËS

1.1. Kuptimi i jetës

E drejta për jetën është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme, e patjetërsueshme e lidhur ngushtë me qenien njerëzore. Ajo qëndron në majën e piramidës së të drejtave të njeriut, pa gëzimin e saj asnjë nga të drejtat e tjera nuk do të ekzistonte (Daci. J, 2011:245). Dikur mbrojtja e jetës dhe vlera e saj varej nga gjykimi individual i vetë njerëzve. Kështu, përgjatë periudhave të dy luftërave botërore, njerëzimi u përball dhe njohu shkeljet dhe cënimet më të rënda të të drejtave të njeriut sidomos shkelja e të drejtës së jetës. Në vitet pas përfundimit të luftës së dytë botërore regjimi nazist kreu aktet më të tmerrshme kundër të drejtës së jetës, të cilat konsistonin në zhdukjen fizike të popullit hebre dhe të popujve të tjerë si romët e sllavët, të konsideruar si “raca inferiore” që përbënin, sipas ideologëve nazistë, rrezik real për homogjenitetin e “racës superiore” gjermane.¹ Nisur nga këto ngjarje njerëzimi kuptoi që e drejta e jetës është një domosdoshmëri në funksionimin e shoqërisë moderne, pa të cilën vazhdimësia e njerëzimit do të ishte e pamundur. Në këto kushte, njerëzimi u tregua i vendosur për të larguar skllavërinë dhe luftërat të cilat ishin motori shkatërrues i vlerës më të rëndësishme pa të cilën ekzistenca do të bëhej nul. Për rrjedhojë në shumë Kushtetuta të vendeve të ndryshme si dhe në konventat ndërkombëtare, u pa e nevojshme të parashikohej me anë të

¹ Shih <http://impakt.al/holokausti-e-verteta-e-genocidit-me-te-madh-ne-historine-njerezore/>. Në qershor të vitit 1941, batalionet e specializuara gjermane ushtruan vrasje në masë të hebrenjve, romëve, funksionarëve të shtetit sovjetik dhe mbështetësve të komunistëve në rajonet sovjetikë të pushtuara. Trupat SS vranë mbi një milionë hebrenj dhe qindra mijëra të tjerë, pa llogaritur edhe qytetarët sovjetikë jo hebrenj. Miliona hebrenj u deportuan gjatë periudhës 1941 – 1944, nga zonat gjermane e ato të pushtuara, drejt kampeve të posaçme të përqendrimit, të njohur më mirë si kampet e shfarosjes. Në këto kampe, të burgosurit vriteshin nëpër dhomat me gaz të ndërtuara posaçërisht.

dispozitave ligjore një mbrojtje më e plotë e të drejtës së jetës, që të ofronte garancinë më të madhe të mundshme. Fenomeni i jetës, gjatë dekadave të fundit ka zgjuar një interes universal ligjor sepse mbrojtja e jetës njerëzore nuk ka qenë gjithmonë prioritet i shoqërisë, ndaj dhe realizimi i kësaj vlere njerëzore, ishte rezultat i një përpjekjeje të vështirë intelektuale. Në shoqërinë moderne, jeta e njeriut është tashmë një e drejtë e padiskutueshme universale, e patjetërsueshme, e cila mbrohet si e drejtë kushtetuese si dhe me një sërë konventash ndërkombëtare. Edhe pse e drejta e jetës nuk mund të kuptohet jashtë konceptit të shoqërisë njerëzore dhe nuk mund të zhvishet nga karakteri i saj universal duhet theksuar se sulmet terroriste që po zhvillohen në kohët e fundit krijojnë pasiguri dhe provojnë se e drejta e jetës, si e drejtë supreme ligjore, dhe që është thelbësore për ruajtjen dhe sigurimin e të gjithë të drejtave të tjera, po kalon në planë të dytë, duke pranuar sakrifikimin dhe humbjen e jetëve të njerëzve të pafajshëm dhe shndërrimi i tyre në statistika në kuadër të humbjeve të pranueshme për hir të një kauze tjetër më të madhe, si ajo e sigurisë dhe paqes ndërkombëtare. Këto sulme po shkaktojnë pasiguri globale në bashkëjetesën e popullsisë. Në këtë punim do të shohim se është bërë një përpjekje e madhe për të gjetur mënyrën me të cilën njeriu duhet të sigurojë të drejtën e padiskutueshme universale, të patjetërsueshme që nuk është veçse e drejta për të jetuar. Vlera që mbron e drejta që po analizojmë është jeta e njeriut, si sinonim i ekzistencës dhe duke nënkuptuar jetën si të kundërtën e vdekjes. Jeta është një emërtim i shumanshëm që mund të lidhet me ecuritë (proceset) vazhduese në të cilat gjallesat bëjnë pjesë ndërmjet pllenimit ose mitozës dhe vdekjes. Përkufizimi biologjik i jetës është një çështje që ka ngjallur debate filozofike që në lashtësi dhe diskutime shkencore për shekuj me radhë, të cilat ende nuk kanë sjellë një zgjidhje të përbashkët dhe të pranueshme, kjo edhe për shkak të ndërhyrjeve fetare.

Mbrojtja kushtetuese e jetës synon dy objektiva, dy elementet që përbëjnë në vetvete fenomenin biologjik të jetës, atë material dhe atë shpirtëror, materien dhe energjinë. Kjo ndarje, dallim, në materiale dhe shpirtërore ishte bërë tashmë nga Platoni, që besonte se trupi është i vdekshëm por shpirti është i pavdekshëm dhe se ky i fundit i nënshtrohet ringjalljeve të njëpasnjëshme. Sot, kjo është konsideruar si anakronik dhe dogmatik dhe nga pikëpamja ligjore jeta njerëzore trajtohet si një dhe i vetmi fenomen biologjik, qenie fizike, si një njësi e strukturuar me bazë ligjet e fizikës dhe të biologjisë².

Jeta e personit mbrohet me ligj. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. E drejta për jetën paraqitet në Kushtetutë, *si një vlerë*, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera (Caretta, P., 2005:17). Parimet themelore të mbrojtjes së jetës gjejnë mbështetje të plotë në këto dispozita. Jeta është një e drejtë, atribut fundamental i qenies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret në çfarëdolloj mënyrë, njeriu në të njëjtën kohë eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Në nenin 21 të Kushtetutës së Shqipërisë, në Kreun e II-të, të lirive dhe të drejtave vetjake, ligjvënësi kushtetues shprehet se *“Jeta e personi, mbrohet me ligj”*. Në nenin 2 të Konventës për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) kërkohet që *“e drejta për jetën e çdokujt të mbrohet me ligj”*. Jeta e njeriut, duke patur një vlerë të padiskutueshme, bëhet objekt i mbrojtjes kushtetuese.

² Në të vërtetë dhe jeta e kafshëve mbrohet me ligj por jo në kuptim të nenit 2 të KEDNJ dhe të nenit 21 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ajo mbrohet në kuadër të mbrojtjes së pronës private pasi kafshët e cdo lloji si ato shtëpiake ashtu dhe ato prodhuese, bagëtitë e imta ose të trasha, janë pronë e pronarëve të tyre, gjithashtu mbrohen me anë të ligjeve të posacme, p.sh. ligji 10 465, dt. 29.9.2011, Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë, etj.

Mbrojtja e jetës së njeriut në çdo moment dhe në të gjitha rrethanat nuk është e njëjtë, pasi ajo është e influencuar nga një sërë faktorësh të ndryshëm, për të cilët edhe ligjvënësi mund të jetë ai që nëpërmjet ligjit që harton e miraton të parashikojë hollësitë që mund të garantojnë këtë jetë njerëzore. Vetëm nëpërmjet ligjit mund të bëhen përjashtimet³, kur si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese ose thjesht të një të drejte tjetër që prevalon atë kohë, sipas rrethanave të çastit, kërkohet të hiqet jeta e dikujt. Ligji është ai, të cilit i jepet e drejta, që në raste të veçanta dhe që në kuptim të nenit 2, pika 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të lejojë edhe marrjen e jetës për njeriun. Konkretisht, këto raste kanë gjetur rregullimin e tyre ligjor në dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal që parashikojnë institutin juridik të mbrojtjes së nevojshme⁴, apo në ligjet e tjera, të cilët i japin të drejtë Forcave të Armatosura, forcave të policisë, rojave civile të armatosura që njeriut mund t'i merret jeta dhe të pranohet kjo lloj vdekje që i shkaktohet atij, qoftë dhe nga shteti, nëpërmjet organeve të tij, nuk ka të bëjë dhe nuk mund të njëjësohet me dënimin me vdekje, si lloj dënimi që jepej më parë nga gjykata, por është e lidhur me ato raste përjashtimore, shprehimisht të sipërcituara. Mbi këto koncepte është ndërtuar dhe legjislacioni ynë dhe, në fakt, ky është kuptimi kushtetues e ligjor, mbi të cilin realizohet mbrojtja e jetës së njeriut. Legjislacioni realisht, në këtë aspekt, i

³ Përjashtime në legjislacionin shqiptar, ligji për përdorimin e armëve nr. 8290 dt 24.02.1998, neni 19 i Kodit Penal, për mbrojtjen e nevojshme, i cili përjashton nga ndjekja penale atë që kryen një vepër penale (edhe vrasje, shiko rastin e vrasjes së dyfishtë të kryer nga Flamuri Ymeri e dy personave Brenda në banesën e tij-sipas tij dhe rezultatit të hetimeve të prokurorisë së Tiranës) duke qënë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i castit me kusht që, karakteri imbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, etj.

⁴ Shih nenin 19 i Kodit Penal Shqiptar 'Mbrojtja e nevojshme. *Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qënë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i castit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit. Mospërputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.*

përgjigjet kushteve të një shoqërie moderne, të emancipuar dhe me një pengesë tepër të vështirë në përsosjen dhe konsolidimin e kësaj shoqërie.

1.2. Natyra dhe fillimi i jetës sipas nenit 2 të KEDNJ-së

E drejta e jetës është një e drejtë më rëndësi rilevante dhe universale nga gëzimi i të cilës varet vazhdimësia e komunitetit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e saj dhe kemi krijuar instrumentat e duhura për të garantuar këtë të drejtë, por pavarësisht kësaj nuk kemi ende një garanci absolute të saj dhe shpesh herë përballemi me situata të ndryshme të cilat sfidojnë legjislacionin e krijuar. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut është një nga instrumentet e cila proklamon dhe mbron të drejtën e jetës. Këtë të drejtë e gjejmë të sanksionuar në nenin 2 të KEDNJ-së nga ku në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se “*E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji.*” Nga interpretimi i këtij paragrafi arrijmë të evidentojmë që KEDNJ-ja mbron të drejtën e jetës të çdo individi pa bërë dallime dhe i referohet në kontekst vetëm jetën njerëzore. E drejta e jetës trajtohet në nenin 2 të kësaj konvente, jo vetëm për faktin e evidentimit që ajo është një nga të drejtat themelore të njeriut, por edhe për të theksuar rëndësinë e saj sepse pa këtë të drejtë, çdo e drejtë tjetër nuk do të ekzistonte. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Sipas KEDNJ-së e drejta e jetës nuk është e derogueshme dhe askush nuk mund të mohoj këtë të drejtë qoftë edhe në kohe lufte apo të ndonjë emergjence publike që mund të jetë kërcënuese për jetën e kombit. Por nga interpretimi i paragrafit të 1 të nenit 2 të KEDNJ-së del në pah që e drejta e jetës pavarësisht kuadrit ligjor i cili garanton mbrojtjen e

saj është një e drejtë e cënueshme dhe mbrojtje e saj nuk është absolute. Konventa garanton cenimet e qëllimshme të kësaj të drejte por në rastin kur ka një vendim gjykate të formës së prerë i cili urdhëron ndërprerjen e jetës së një individi, atëherë në këtë situatë pushon mbrojtja e konventës dhe legjitimohet po me anë të kësaj Konvente cenimi i saj.⁵ Pra, paragrafi 1 i nenit 2 të KEDNJ-së karakterizohet në pjesën e parë nga detyrimi që kanë të gjithë për të mbrojtur të drejtën për jetën me anë të ligjit dhe në pjesën e dytë legjitimon me anë të vendimit të gjykatës cenimin e kësaj të drejte, nën mburojën e shprehjes absolutisht e domosdoshme.

Konventa garanton vetëm jetën e qenieve njerëzore, ndërsa jetesa e kafshëve dhe ekzistenca e “personave juridikë” nuk gëzojnë mbrojtje nëpërmjet këtij neni. Kështu “*Personat juridikë*”, si kompanitë tregtare, që janë “*persona*” në kuptim të KEDNJ-së, mund të mbështeten tek Konventa në lidhje me disa të drejta që realisht i gëzojnë, si në respektimin e së drejtës për pronën⁶ dhe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor në përcaktimin e të drejtave të tyre civile dhe të detyrimeve. E drejta për lirinë e shprehjes mund të kërkohet nga mediat dhe botuesit, etj,⁷ e drejta për lirinë e tubimit nga shoqatat⁸, dhe e drejta për lirinë e fesë nga organizatat fetare⁹.

⁵ Vendimi në *McCann dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe, 5 shtator 1995, para. 147, me reference edhe tek vendimi *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 7 korrikut 1989, para 88.

⁶ Për shembull, *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, vendimi i 9 dhjetorit 1994. vëreni se Neni 1 i Protokollit të Parë i jep shprehimisht “*cilitdo personi fizik apo juridik*” të drejtën për të gëzuar në mënyrë paqësore pronat e tij. Kjo është e vetmja dispozitë në Konventë dhe në protokollet e saj shtesë që e parashikon këtë gjë.

⁷ Për shembull, *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 nëntorit 1991; *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (II)*, vendimi i 26 nëntorit 1991, *Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, vendimi i 28 marsit 1990.

⁸ Për shembull, *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë* (shih shënimin e mësipërm). *Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, vendimi i 7 korrikut 1989.

Por asnjëra prej tyre nuk përmban “*të drejtën për jetën*” në kuptimin e nenit 2 të KEDNJ-së (Janis M., Kay R., and. Bradley A., 2008 :130).

Konventa nuk e qartëson se çfarë është jeta dhe ku fillon apo mbaron mbrojtja e Nenit 2 të Konventës kjo si pasojë e mungesës së një kompromisi në nivel botëror ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, edhe sepse Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, edhe GJEDNJ-ja nuk kanë vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë drejtim. Si e përcaktoi edhe Gjykata në çështjen e *Vo kundër Francës*, çështja se kur fillon e drejta për jetën i përket hapësirës së vlerësimit që Gjykata zakonisht konsideron se, Shtetet duhet të gëzojnë në këtë sferë, pavarësisht nga interpretimi i Konventës, një “*instrument ligjor jetik që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme*”. Arsyetimi për këtë konkludim identifikohet në faktin se detyrimi i një mbrojtjeje të ofruar nën ombrellën e KEDNJ-së nuk ka një konsensus brenda shumicës së vetë Shteteve Kontraktuese, veçanërisht në Francë, nga ku kjo e fundit është bërë subjekt debatesh, dhe së dyti, se nuk ka një kompromis mbarë europian mbi pyetjen se nëse fëmija i pa lindur “fetusi” është person, pra subjekti mbartës i së drejtës së Nenit 2 të Konventës.

Në vend që të imponojë një standard uniform, është vlerësuar dhe po vazhdohet të vlerësohen se çështjet në lidhje me kuptimin e fillimit të jetës duhen trajtuar individualisht sipas rasteve dhe shteteve u është dhënë liri e konsiderueshme për të rregulluar vetë kuadrin ligjor për problematikën në fjalë duke i dhënë rëndësinë e duhur proporcionale interesave të ndryshme që rrezikohen dhe duke ekuilibruar interesin e pretenduar me privimin nga e drejta substanciale e garantuar. Kjo vërehet edhe nga jurisprudenca e

⁹*Pastori X dhe Kisha e Shentologjisë kundër Suedisë*, Kërkesa Nr. 7805/77, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 5 majit 1979 (ka kthyer në të kundërtën një vendim të hershëm: *Kisha e X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 3798/68, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 17 dhjetorit 1968).

organeve të Konventës si Komisioni ashtu edhe Gjykata, në lidhje me çështje që kanë trajtuar ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e aktit të ndërprerjes së induktuar të shtatzënisë (*abortus provocatus*) me nenin 2 të KEDNJ, që këtej e tutje do të quhet thjesht “abort”, eutanazinë dhe ndihmën në vetëvrasje (Kamm, F.M., 1996: 272).

1.3. Aborti dhe e drejta për jetën sipas nenit 2 të KEDNJ-së

Çështjet e abortit dhe te drejtat që lidhen me fetusin trajtohen në këndveshtrimin e nenit 2 të KEDNJ-së. Në lidhje me çështjet e abortit, kërkuesit kryesisht në momentin e hartimit të kërkesave drejtuar GJEDNJ-së ,përveç përdorimit të nenit 2 të KEDNJ-së, ata shfrytëzojnë si bazë ligjore edhe të drejtën e mbrojtjes së jetës private dhe familjare¹⁰, të drejtën e individit për të pasur akses në gjykatë¹¹ në lidhje me aksesin në informacion mbi abortin si dhe të drejtën për lirinë e shprehjes¹².

Në çështjen *Brüggemann dhe Scheuten kundër Gjermanisë*, për shembull kërkuesja ka përdorur si bazë ligjore nenin 8 të Konventës që garanton të drejtën për respektimin e “jetës private”, duke argumentuar se vetëm ajo kishte të drejtën që të vendoste nëse do t’i nënshtrohej abortit ose jo. Në një çështje tjetër siç ishte ajo e *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Komisioni argumentoi që aborti nuk trajtohej nga neni 2 i Konventës, pra ky nen sipas Komisionit nuk ofron mbrojtje për abortin. Në veçanti, ai nuk e përfshin abortin në listën e akteve të lejueshme që rendit në paragrafin e dytë të cilat nuk konsiderohen se bien në kundërshtim me këtë nen. Sipas Komisionit, kjo nënkuptonte që kishte vetëm tre mundësi: ose që Neni 2 nuk mbulon fare fetusin e palindur, ose që njeh të drejtën për jetën të fetusit

¹⁰ Shih nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

¹¹ Po Aty. Shih nenin 6.

¹² Po Aty. Shih nenin 10.

me disa kufizime të nënkuptuara; apo që i jep të drejtë absolute për jetën fetusit (Kroff.D, 2001:11).

Komisioni përjashtoi interpretimin e idesë së dhënies së fetusit cilësinë e mbartësit të së drejtës absolute të jetës, me përmbajtjen që kjo e fundit ka kur bëhet fjalë për njeriun e lindur të gjallë, sepse nuk lejonte që të merrej në konsideratë si humbje e pranueshme, jeta e nënës, duke argumentuar se ndryshe do të nënkuptonte se jeta e palindur e fetusit do të konsiderohej se është e një vlerë më të lartë sesa jeta e gruas shtatzënë¹³.

Ky konkluzion nuk mund të jetë interpretimi i drejtë dhe konform frymës që përcjell Neni 2 gjithmonë në lidhje me abortin, sepse gati të gjitha Palët e larta Kontraktuese të Konventës e lejonin abortin kur ai ishte i nevojshëm për të shpëtuar jetën e nënës. Në fakt, që nga viti 1950, vit kur u hartua Konventa, kishin lindur debate nëse mund të tolerohej “një tendencë drejt liberalizimit të mëtejshëm të abortit”. Në një çështje të hershme të viteve `80 u tentua drejt interpretimit të nenit 2, *pro* përgjigjes pozitive të pyetjes së parë, pra njohjen e fetusit si mbartës i së drejtës absolute të jetës, duke e njehësuar atë me njeriun e lindur të gjallë. Kur u diskutua rreth kufizimeve mbi të drejtën në përmbajtje të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të Nenit 2 u konstatua se të gjitha kufizimet e mësipërme, nga natyra e tyre, kanë të bëjnë me persona që kanë lindur tashmë dhe nuk gjejnë zbatim për fetusin, kështu arrijmë në konkluzion se, si përdorimi i përgjithshëm i termit “çdokush” “*toute personne*” në Konventë, edhe konteksti në të cilin përdoret ky term në Nenin 2, tentojnë të mbështesin pikëpamjen se ai nuk e përfshin fëmijën e palindur¹⁴.

¹³ Vendimi X kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 19.

¹⁴ Kërkesa nr.8416/79, Vendim i Papranueshmërisë i dt: 13 Majit 1980.

Në përfundim, gjykata bazoi vendimin e saj rreth kësaj divergjence specifike në lidhje me jurisprudencën e Gjykatave Kushtetuese Austriake dhe Gjermane dhe të Gjykatës së Lartë Norvegjeze mbi çështje të ngjashme. Gjykata Kushtetuese Austriake vendosi në 1974 se Neni 2 i Konventës (*që zbatohet drejtpërdrejtë në Austri*) nuk mbulonte jetën e fetusit të palindur, ndërsa Gjykata Kushtetuese Gjermane konstatoi në vitin 1975 se fjala “çdokush” në frazën “*çdo kush ka të drejtën për jetën*” në dispozitën korresponduese në të Drejtën Gjermane (*pararendëse e Kushtetutës së Gjermanisë së ribashkuar*) i referohej “*çdo qenieje njerëzore që jeton*” dhe se e drejta në këtë mënyrë shtrihej në fakt edhe për qeniet njerëzore të palindura (që jetojnë). Gjykata e Lartë Norvegjeze ishte më pragmatike. Siç u perifrazua në H. Kundër Norvegjisë, ajo vendosi në 1979 se: “*ligjet mbi abortin duhen që domosdoshmërisht të bazohen te një kompromis që duhet të arrihet duke respektuar jetën e palindur dhe qëndrimet e tjera thelbësore që krahasojnë vlerat e mbrojtura në kuadër të faktit të rrezikut të madh të humbjes së njëres prej tyre*” (Kroff.D,2001:12). Ky kompromis ka reflektuar në vendimin që legjislatori të lejojë abortin e dëshiruar dhe shprehur me vullnet të plotë nga personi vetë, në bazë të rrethanave të përcaktuara nga Akti Norvegjez për Ndërprerjen e Shtatzënisë i vitit 1978. Komisioni i ka shqyrtuar nga afër dispozitat specifike të Aktit Norvegjez të Ndërprerjes së Shtatzënisë të vitit 1978 duke theksuar se ka lejuar vetëm “*abortin e bërë nga personi*” brenda 12 javëve të para të shtatzënisë, aborti midis 12 dhe 18 javëve lejohej me autorizim nga dy doktorë nëse shtatzënia, lindja apo kujdesi për fëmijën mund të vendosë fëmijën në një situatë të vështirë për jetën dhe ndërprerja e shtatzënisë pas javës së 18-të lejohej vetëm nëse do të kishte arsye veçanërisht të rëndësishme për të ndërmarrë një veprim të tillë dhe asnjëherë nëse do të kishte arsye për të prezumuar se fetusi është i destinuar të hiqet.

Gruaja në çështjen në fjalë kishte marrë autorizim për ndërprerje në javën e 14-të. Duke adoptuar pikëpamjet e Gjykatës së Lartë Norvegjeze, nxjerrim konkluzionin si më poshtë: Ashtu si e tregon edhe kjo çështje, ekzistojnë mendime të ndryshme përsa i përket faktit nëse, një autorizim i tillë, autorizim nga dy doktorë nëse shtatzënia, lindja apo kujdesi për fëmijën mund të vërë shtatëzanën në një situatë të vështirë për jetën, krijon një ekuilibër të drejtë midis:

1. nevojës legjitime për të mbrojtur fetusin dhe
2. interesave legjitime të gruas në fjalë (e drejta absolute për jetën Neni 2 KEDNJ).

Megjithatë, duke marrë në konsideratë sa më sipër në lidhje dhe me legjislacionin norvegjez, kërkesat për ndërprerjen e shtatzënisë, si dhe rrethanat specifike të kësaj çështjeje, nuk konstaton se Shteti, legjislativi përkatës, ka shkuar përtej lirisë së tij të vlerësimit, që sipas dhe GJEDNJ konsiderohet se e ka në këtë fushë të ndjeshme siç është aborti.

Në trajtimin e çështjes *Reeve kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁵, gjykata nuk e trajtoi çështjen e abortit nisur nga fakti që Komisioni e kishte konstatuar si kërkesë të pa bazuar në ligj. Në këtë çështje nëna e një fëmije 2 vjeçar që kishte lindur me defekte të rënda kongjenitale që mund dhe duhet të ishin konstatuar me parë nga doktorët që e trajtuan atë gjatë shtatzënisë u ankua në emër të fëmijës së saj se këtij të fundit i ishte ndaluar të ndiqte një hap kundër autoritetit shëndetësor ku punonin këta doktorë për “jetë të gabuar” dhe pretendonte në emër të fëmijës se ishte shkelur drejta e fëmijës për “akses në gjykatë”¹⁶.

¹⁵ *Reeve kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 24844/94, Vendimi i Pranueshmërisë i Dt: 30 nëntorit 1994.

¹⁶ Shih nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Sipas saj Shteti nuk kishte lejuar pretendimin për dëmet e shkaktuara ndaj fëmijës, në bazë të asaj që lejohej që fëmija të lindte në rrethana në të cilat nëna e saj do të kishte pasur mundësi të abortonte, nëse vetëm do të kishte qenë në zotërim të fakteve të plota. Në këtë çështje GJEDNJ-ja vendosi se përsa i përket kufizimit për “aksesin në gjykatë” ajo i përket hapësirës së vlerësimit të Shtetit. Ajo e konsideroi kufizimin “proporcional në mënyrë të arsyeshme pasi pretendimet shtrohen për cilindo akt të gabuar që kontribuon në paaftësinë e fëmijës dhe përsa akti i gabuar ndikon tek prindërit, ky veprim shtrohet edhe për dëmet që pretendoheshin (Kroff.D, 2001:13).

1.3.1. Rregullimi ligjor i brendshëm i Shteteve Pale të Larta Kontraktuese

Çështja e lejitimit ose jo të abortit ka qenë objekt i diskutimeve të vazhdueshme në panelet e ndryshme mjekësore dhe në ato juridike. Në aspektin juridik hartimi i një legjislacioni për lejitimin e abortit ka qenë një sfidë ndaj jetës. Aktualisht nuk ka ende një përcaktim në lidhje me momentin e fillimit të jetës. Në terminologjinë mjekësore me abort do të kuptohet ndërprerja përpara kohe e shtatzënisë me qëllim shkatërrimin e fetusit duke mos lejuar ardhjen e tij në jetë (Nosi,1953:33).

Në lidhje me përcaktimin e momentit të jetës aktualisht nuk kemi një përkufizim dhe një legjislacion të unifikuar i cili do të ndihmonte në zgjidhjen e këtij ngërçi ligjor. Kjo për vetë faktin se vetë GJEDNJ-ja ja ka atribuar të drejtën e përcaktimit të fillimit të jetës legjislacioneve të brendshme të shteteve.

Ende sot nuk është përcaktuar nëse koncepti i jetës është një koncept absolut apo një koncept gradual nga ku kuptohet se jeta e një individi fillon gradualisht në zhvillimin e fetusit. Në disa legjislacione jeta e individit fillon pas lindjes, këto janë kryesisht vendet të

cilat e legjitimojnë abortin. Këto legjislacione e konsiderojnë fetusin veçse një grumbullim qelizash, por nëse embrioni nuk është qenie njerëzore, por vetëm një grup qelizash, atëherë, si mund të konceptohet ndryshe ekzistenca e njeriut nëse do të legjitimohej në masë aborti? Sipas shkencës periudha e zhvillimit të fetusit është koha kur njeriu fillon jetën biologjike (Saunders 2003, fq 16.).

Të gjitha aktet kombëtare ose ndërkombëtare ofrojnë mbrojtjen e jetës së një individi që nga momenti që kjo është ekzistonte, pra nga momenti kur lind i gjallë. Ekspertët ligjorë ndërkombëtarë të cilët kanë hartuar dhe dokumentuar projekt-ligjet ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe për rrjedhojë dhe të drejtës së jetës në asnjë akt ndërkombëtarë nuk kanë gëzuar të ofrojmë mbrojtje ligjore të jetës që nga momenti i konceptimit por vetëm nga lindja. Pra ka një ngërç ligjor dhe të pakapërcyeshëm midis faktit të mbrojtjes së jetës dhe lejitimit të abortit. Në nivele kombëtare çështja merr përmasa të ndryshme sepse disa legjislacione ndërkombëtarë shprehen se e drejta e jetës fillon që në momentin e ngjizjes. Kështu në nenin 4 të Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, gjejmë të sanksionuar që *“jeta e njeriut duhet të mbrohet në përgjithësi, që nga momenti i mbetjes së gruas shtatzënë”*, Edhe disa legjislacione të vendeve anëtare të KEDNJ-së nuk ndajnë të njëjtën qasje në lidhje me konceptin e fillimit të jetës dhe abortit. Kështu shumë vende Evropiane nuk kane gjetur një konsensus në lidhje me përcaktimin e konceptit të embrionit dhe për rrjedhojë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u jep vendeve anëtare të drejtën e vlerësimit të çështjes së fillimit të jetës duke u mbështetur në standardet kombëtare të çdo vendi anëtar të saj (I.Zumi, 2011:19). Aborti gëzon rregullime të ndryshme ligjore në legjislacione të ndryshme.

Gjermania: në Gjermani aborti lejohet vetëm në raste të përcaktuara nga ligji. Të gjitha format e tjera të abortit përveç atij që realizohet kur rrezikohet jeta e gruas, konsiderohet si i paligjshëm. Fillimisht gruaja duhet të paraqitet në një qendër këshillimi e specializuar në rastet e abortit, për të patuar një bisedë e cila konsiderohet e detyrueshme në bazë të legjislacionit gjermane. Pas përfundimit të kësaj bisede qendra e këshillimit vendos nëse do ta pajis grua me certifikatën e lejitimit të abortit.

Suedia: Në Suedi aborti është ligjësuar për herë të parë nëpërmjet Aktit të Abortit në vitin 1938. Aborti lejohet në qoftë se shtatzënia përbënte një kërcënim serioz për jetën e gruas, në qoftë se ajo është produkt i një përdhunimi, ose në qoftë se ka pasur një mundësi të konsiderueshme se çdo serioze kusht mund të trashëgohet nga fëmijën e saj, ajo mund të kërkojë një abort. Aborte në Suedi lejohen deri në javë e 22, pas javës së 22 duhet të ekzistojë një arsye shume e fortë mjekësore e cila do të lejonte abortin.

Franca: Në France aborti lejohet në raste se rrezikohet jeta e gruas apo kur fetusin po vuan nga një sëmundje e rëndë dhe të pashërueshme në diagnozën, mund të praktikohet përtej kësaj periudhe deri në momentin e fundit të shtatzënisë. Në legjislacionin francezë aborti lejohet deri në javën e 12. Në ndryshimet që i janë bërë legjislacionit në vitin 2015 u vendos një shkurtime i periudhës 1 javore në 2 ditë, të reflektimit kërkesës për abort që duhet të shqyrtohet nga ana e mjekut, me synimin e mos jetimit të kalimit të afatit 12 javor¹⁷.

Portugalia: Portugalia është një ndër vendet që e legalizoi abortin më onë se disa vene të tjera, me konkretisht ligji për abortin në Portugali u miratua në 10 prill 2007. Ky ligj parashikon se gruaja mund të paraqesë kërkesë më shkrim.

¹⁷Shih https://fr.wikipedia.org/wiki/Interruption_volontaire_de_grossesse_en_France.

Në bazë të disa ndryshimeve të fundit aborti lejohet si mjeti i fundit, sepse pavarësisht liberalizimit të ligjeve, në praktikë, shumë mjekë nuk pranojnë të kryejnë aborte sepse Portugalia vazhdon ende sot të mbetet një vend ku tradita katolike me ndikim të lartë fetarë. Abortet në fazat e mëvonshme janë të lejuara për arsye të veçanta, të tilla si rreziku për arsye shëndetësore gruas, përdhunim dhe krime të tjera seksuale, apo cen fetusit; me kufizime të rritur gradualisht në 12, 16 dhe 24 javësh. Që nga viti 2010, shkalla e abortit ishte 9.0 aborte për 1000 gra të moshës 15-44 vjet. Në shkurt 2016, parlamenti portugez vetoi dhe miratoi zyrtarisht një ligj të ri që përjashton nga pagesa dhe këshillimi mjekësorë për gratë që kërkojnë abort¹⁸.

1.3.2. Çështjet e abortit në Shqipëri. Problematikat dhe sfidat e radhës

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj shprehet “*se jeta e personit, mbrohet me ligj*”. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut¹⁹ dhe Paktin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike²⁰ dhe në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²¹ përcaktohet se aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë fuqi ligjore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë mbrojtja e të drejtës së jetës mbështetet edhe në mbrojtjen që bëhet nga aktet ndërkombëtare. E drejta e jetës në Shqipëri ka gëzuar mbrojtje që në fillimet e saj. Jeta konsiderohej e shenjtë dhe aborti ishte një akt i dënueshëm nga ana e opinionit dhe nga ana e akteve ligjore që vepronin në këtë periudhë. Kështu në të drejtën

¹⁸ Shih https://wikipedia.org/wiki/Abortion_in_Portugal.

¹⁹ Shih nenin 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁰ Shih nenin 6 të Paktin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike.

²¹ Shih neni 116 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se “*Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë*”: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

zakonore e cila funksiononte në bazë të kanuneve të ndryshme çdo veprim që mund të cenonte jetën e gruas konsiderohej krim kundër jetës dhe sipas normave të kanunit parashikohej si masë dënimi gjakmarrja ndaj personit që cenonte jetën e gruas (Elezi, 1983:14).

Edhe gjate periudhës së monarkisë aborti konsiderohej si vepër penale dhe ishte i ndëshkueshme. Nga një analizim që i bëhet legjislacionit shqiptar në periudha të ndryshme vërehet se më shume vendoset në qendër dhe i jepet rëndësi veprimeve kriminale ndaj grave shtatzëna sesa abortit se akt spontan. Pra nuk ka një kuadër ligjor ose një ligj i cili mund të na ofroj një pasqyrë të qartë se si funksiononte aborti spontan ose i këshilluar nga mjeku për të shpëtuar shëndetin e nënës. Një e drejtë tjetër e lidhur me jetën është dhe ajo e zhvillimit të fëmijës. Për shembull, në ligjin Nr. 8528 të vitit 1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji". Prodhuesit detyrohen që etiketat e prodhimit të ushqimeve për fëmijë të përmbajnë formulimin "ushqimi i gjirit është ideal për ushqimin e fëmijës" Një problem i diskutueshëm lidhur me të drejtën e pamohueshme për të jetuar të fëmijës është dhe aborti pasi ky i fundit është një parakusht që nuk duhet të plotësohet në mënyrë që pastaj të mund të lindë fëmija, pra më saktë do të shpreheshim me termin, '*të drejtën e jetës për fetusin*'. Deri në vitin 1995 aborti vullnetar nuk ishte lejuar ligjërisht në Shqipëri.

Më 7 dhjetor 1995, u miratua nga Kuvendi Popullor Ligji Nr. 8045, "Për ndërprerjen e shtatzënisë". Megjithëse në nenin 1 të tij parashikohet se Ligji garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës, jepen dhe përjashtimet se ky parim mund të shkelet kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Ligji "Për ndërprerjen e shtatzënisë", garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit të tyre. Ndërprerja e shtatzënisë lejohet vetëm

për arsye shëndetësore (nëna dhe fëmija) dhe për arsye psiko-sociale në rastin e një shtatzënie jashtë martesore të të miturave deri në 16 vjeç ku ndërprerja e shtatzënisë bëhet me miratimin e prindit ose kujdestarit ligjor. Përveç rasteve të ndërprerjeve të shtatzënisë për arsye shëndetësore, lejohet dhe ndërprerja vullnetare me kërkesën e nënës. Kodi ynë penal, në seksionin V të tij ku trajton vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës, parashikon dënime me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet në rastet e ndërprerjes së shtatzënisë pa pëlqimin e gruas²² se duke përjashtuar këtu rastet e justifikuara të mbrojtjes së shëndetit të gruas, kjo vepër dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Në vijimësi të këtij seksioni në nenet 94 dhe 95 parashikohen dhe sanksione për abortin e paligjshëm duke e konsideruat atë një kundravajtje penale të dënueshme me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet dhe masa rëndohet në gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet kur nga shkaktimi i abortit është rrezikuar ose shkaktuar vdekja e nënës.²³ Në nenin 95 konsiderohet si kundravajtje penale dhe dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë, duke u dënuar me gjobë ose me burgim gjer në një vit²⁴.

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme të Kodit Penal Shqiptar, duket qartazi se aborti në vendin tonë nuk *ndalohet* por *kufizohet*. Kjo dhe në ndërlidhje me dispozitën kushtetuese të nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet e drejta për jetën. Karakterin e të drejtës absolute në Shqipëri, e drejta për jetën e përfiton nga

²² Shih nenin 93 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë “Ndërprerja e shtatzënisë së gruas pa pëlqimin e gruas”.

²³ Shih nenin 94 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se “Ndërprerja e shtatzënisë e kryer jo në ambiente spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, ose nga një person që nuk është mjek ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.”

²⁴ Shih nenin 95 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

rëndësia e saj dhe renditja që i bëhet ndër të drejtat e tjera në KEDNJ, në Kartën e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuar etj, sanksionet e parashikuara ndër to janë të detyrueshme për të drejtën kombëtare²⁵, pasi Shqipëria ka aderuar në këto organizata, e përfiton nga cilësia e saj si themelin e të drejtave, atë universal, që garanton dhe mundëson ushtrimin e të gjithë të drejtave të tjera vetjake dhe politike, me anë të të cilave mundësohet vetë ekzistenca e sistemit demokratik, të cilin kemi zgjedhur si më të përshtatshmin për të rregulluar bashkëjetesën, të paktën në vendet perëndimore.

Ligji Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” për herë të parë legjitimonte procesin e abortit por më kufizimin që të realizohen vetëm nga mjeku specialist obstetërgjinekolog në institucione shëndetësor, të cilat mund të ishin shtetërore ose private por sipas udhëzimit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit²⁶. Në nenin 9 të këtij ligji përcaktoheshin rastet në të cilat lejohej me autorizimin e mjekut aborti²⁷. Në rastin kur mjeku konstaton se fetusin ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasiguritë ai duhet menjëherë të informoj gruan me qëllim që ajo të marrë një vendim të përshtatshëm në lidhje me procesin e abortit, po kështu mjeku në bazë të këtij ligji detyrohet të japë një informacion të detajuar në lidhje me pasojat negative të abortit²⁸. Ligji Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” në nenin 6 parashikon një afat 7 ditorë në lidhje me paraqitjen e kërkesës për aborte pranë mjekut i cili do të realizoj ndërhyrjen dhe më tej në nenin 8 të ligjit përcaktohen kushtet e realizimit të

²⁵ Neni 5 i Kushtetutës së Shqipërisë.

²⁶ Shih nenin 3 paragrafi 1 Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”.

²⁷ Shih nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” ku përcaktohet se mjeku autorizon abortin në rastet kur: nga vazhdimi i shtatzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikohet jeta ose shëndeti i gruas, fetusin ka keqformime të papajtueshme me jetën, apo sëmundje invaliduese me trajtim të pasiguritë, shtatzënia i krijon probleme psikosociale gruas, shtatzënia është rezultat i përdhunimit ose një krimi tjetër seksual, vërtetohen arsye të tjera sociale.

²⁸ Po Aty, Shih nenin 3 paragrafi 1 Ligjit.

kërkesës së abortit në rastin e vajzave të mitura. Kështu ligji kërkon autorizim nga ana e prindërve ose të një personi që ka përgjegjësinë prindërore në rastin e kërkesës për abort nga një e mitur²⁹. Porsa i takon afateve brenda të cilave lejohet aborti ligji parashikon se *“Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore mund të bëhet deri në javën e 22 të shtatzënisë, në rast se një komision i përbërë nga 3 mjekë, pas ekzaminimit dhe konsultimit, gjykon se vazhdimi i shtatzënisë dhe/ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e gruas”*³⁰.

Në rastet kur gruaja vlerëson se shtatzënia i krijon probleme psikosociale, ndërprerja e vullnetshme mund të kryhet brenda javës së 12 të shtatzënisë³¹. Në rastet kur ka dyshime ose denoncime së gruaja ka qenë subjekt i një përdhunimi atëherë mblidhet një komisione me tre anëtarë i përbërë nga juristë, specialistë mjekë dhe punonjës socialë të cilët vendosin nëse shtatzënia është produkt i përdhunimit ose jo. Në bazë të këtij ligji mjekut i mundësohet liria e zgjedhjes në realizimin ose jo të abortit,³² dhe nëse mjeku specialist shkel dispozitat e këtij ligji parashikohet fillimi i një procesi penal ndaj tij.³³ Dënimi i abortit parashikohet edhe në dispozitat 93.94.95 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Nga analizimi i dispozitave të Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” dhe atyre të kodit Penal arrijmë në konfuzionin së aborti në Shqipëri është një

²⁹ Shih nenin 8 të Ligjit Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”.

³⁰ Po Aty. Shih nenin 9 paragrafi 1.

³¹ Po Aty. Shih nenin 10.

³² Po Aty. Shih nenin 16.

³³ Po Aty. Shih nenin 17. Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 4, 6, 7, 12, 13, 14 dhe 16 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, dënohet si kundërvajtje administrative me gjobë nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë. Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenin 15 dënohet me gjobë deri në 100 mijë lekë. Gjjobat jepen nga organet e kontrollit të caktuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

proces i legjitimuar i cili lejon pa procedura të përcaktuara realizimin e tij përpara javës së 10, dhe më vonë kufizohet më anë të paraqitjes së një kërkesë me shkrim.

Mendoj që dispozitat e Kodit Penal duhet të jenë subjekt i rishikimeve bazuar në ndryshimet sociale që ka pësuar shoqëria.

1.4. Eutanazia. Vështrimi i përgjithshëm historik mbi konceptin e saj

Fenomeni i eutanazisë është hasur që në Greqinë e Lashtë. Ajo konsiderohej e pranishme dhe aplikohej kryesisht te foshnjat dhe tek të moshuarit, shpesh si masë e imponuar nga vetë shteti sepse konsiderohej në dobi të vetë njerëzve por edhe për qytet-shtetet (Platoni, 407-410). Kështu zonat në të cilat është hasur kryesisht fenomeni i eutanazisë ishin zonat e Keadas dhe Eurotas në Laconia (Greqinë e Lashtë), ku spartanët hidhnin fëmijët e tyre të sëmurë dhe të moshuarit në nevojë. Shumë filozofë ishin mbështetës të eutanazisë, madje në kohët romake në Marseille ka ekzistuar një qendër e veçantë trajnimi e cila ofronte një pije helmuese të sëmurët rëndë (Dranakis Pavlos, 722).

Luteri dhe Bacon argumentojnë se funksioni i mjekësisë është rehabilitimi i shëndetit dhe lehtësimi i dhimbjeve kur kjo ndihmon të ofrojë një vdekje të qetë dhe të lehtë. Në Spartën e lashtë ishte e pranuar një formë kongjenitale e eutanazisë, njohur në kohët moderne si *“eugonikë”*, sipas së cilës foshnjat që lindnin me të meta fizike ose mangësi të tjera, të cilat do të bënin jetën e tyre të dhimbshme dhe do të shkaktonin probleme (ekonomike/sociale) në qytet, braktiseshin në mënyrë që të vdisnin nga mungesa e kujdesit. Por dhe Platoni në veprën e tij i referohet *“Politia”* në çështjen e eutanazisë. Duke e përshkruar qytet-shtetin ideal mendon se trupi i sëmurë duhet të vritet. Propozon gjithashtu *“eutanazinë”* në favor dhe si të imponuar për dobi të politikave sociale të shumë

nevojshme dhe argumenton duke thënë se sakrifikimi i jetës³⁴ nuk duhet konsideruar akt i dënueshëm nga ligjet njerëzore dhe ligji i natyrës, pasi ky akt, në rezultatin e tij dhe në përmbushje të qëllimit të mirë, ndikon pozitivisht në mirëqënien sociale të popullsisë së shëndetshme dhe aktive të mbetur. Ai, duke e analizuar nga një këndvështrim tjetër, kundërshton gjithashtu zgjerimin e pakuptim të jetës duke pretenduar se, nga momenti që personit i vjen koha e vdekjes, është e kotë që të sforcohet dikush dhe të tjerë, për të stimuluar jetën dhe për ta zgjatur atë, për asnjë arsye. Mund të konkludojmë se “eutania” në lashtësi konceptohej shumë më ndryshe nga sa sot. Kjo perceptohet vetëm duke marrë parasysh dhe duke ballafaquar mardhëniet sociale në këto dy epoka. Në lashtësi ajo që interesonte më shumë Grekët, ishte vdekja e mirë dhe e lavdishme, pra parapëlqenin vdekjen që do u siguronte “pavdekësinë” ndër breza sesa vazhdimësinë e jetës që mund të rezultonte e poshtëruar për shkak të dobësisë së shkaktuar nga pleqëria dhe pamundësia për të qënë zot i vetes. Eutania ishte meditar nga grekët e lashtë dhe ka shkaktuar gjithashtu polemika duke rreshtuar përballë saj edhe kundërshtarë. Fillimisht, e takojmë në *Betimin e Ipokratit*: “...nuk do të jap asnjë ilaç që shkaktonte vdekjen për asnjë njeri dhe nuk do të japë një këshillë të tillë ...”.

Gjatë periudhës së Mesjetës zhvillimet historike dhe shoqërore ndryshuan kuptimin e fenomenit të eutanazisë dhe qëndrimin e njerëzve ndaj tij. Prevalenca e krishtëritit reflektoi dhe dogmatikën e tij në konsiderimin e jetës si një dhuratë që vjen nga Perëndia, si e mira dhe vlera absolute, dhe papajtueshmërinë me çdo veprim, përpjekje ose dhe mendim për ndërprerjen e saj. Termi “eutania” është përdorur gjithashtu në fillimet e shekullit të

³⁴ Eutania eugonike ose dhe ajo e dëshiruar, konsiderohej si një akt i detyrueshëm, dhe si një sakrificë e shoqërisë, e cila vërtet në fakt humbte një anëtar të saj, që kaq shumë ka nevojë, por kjo pranohej si humbje e justifikuar për një qëllim më të lartë, atë të të mirës së shoqërisë.

13-të për të nënkuptuar përshpejtimin e ardhjes së vdekjes për të shmangur dhimbjen fizike ose për të përfunduar një jetë plot vuajtje e mjerim.

Filozofi gjerman Nitchë mbrojti tezën e eutanazisë për të sëmurët. Qeveria Kombëtare Socialiste e Gjermanisë urdhëroi vrasjen 80.000 pacientëve, qytetarë gjermanë, që vuanin nga sëmundje të pashërueshme dhe pjesërisht e realizoi³⁵. Në Angli, në vitin 1932, u themelua një grup shoqëror që synonte legalizimin e eutanazisë kështu në vitin 1936 u paraqit në Dhomën e Lordëve një projektligj i veçantë në favor të Eutanazisë me kushte si, kërkesë nga pacienti dhe certifikatë e lëshuar nga dy doktorë që vërtetonte diagnozën e sëmundjes së pashërueshme si dhe vendim nga një komision i veçantë mjekësor. Ky projektligj nuk u miratua kurrë³⁶. Po kështu nuk u miratua edhe projektligji i paraqitur në Senatin e SHBA-ve (OTA Kraous- Koukla, E., 1979).

Në vitin 1952 OKB-së i është dorëzuar një kërkesë e firmosur nga 2.000 individë që kërkojnë garantimin e eutanazisë si të drejtë të njeriut. Kërkesa u refuzua. Ndërsa Parlamenti i Këshillit të Evropës me rezolutën 779/29-1-1976 u bëri thirrje vendeve anëtare të sigurojnë te shtetasit e tyre mbështetje psikologjike për përballimin e vdekjes (Karabela D. Lambros, 1987:16-30).

Në Gjermani debati për fenomenin e “*eutanazisë*” u rindez para fillimit të Luftës së Dytë Botërore dhe mbështetej në mendimin se pacientët që vuajnë nga sëmundje të pashërueshme, mund të kërkojnë vetë ndërprerjen e jetës së tyre, për të shmangur kështu dhimbjen, në përputhje kjo me kërkesat dhe vlerat që përmbledhonte ndjenja e humanizmit. Megjithatë, “*eutanazia*” gjeti aplikim në Gjermani gjatë periudhës së sundimit të Hitlerit,

³⁶ “*Eutanazia për Xhorxhin V*”, Gazeta Vima. 14/12/1986.

nëpërmjet modalitetit të ‘*eugonikës*’ të realizuar me anë të ‘*programit të eugonikës*’, të njohur si ‘*programi i eutanazisë T4*’. Ky program parashikonte sterilizimin masiv mes popullsisë, për të arritur eliminimin e elementëve të padëshirueshëm mes saj dhe u realizua në përqindje shumë të madhe. Është vlerësuar se rreth 300.000 njerëz janë vrarë si rezultat i këtij programi, nga të cilët gjysma ishin fëmijë. Ky program u projektua nga vete Adolf Hitleri dhe qëllimi i tij ishte “*pastërtia gjenetike*” e kombit gjerman e arritshme me shfarosjen e kategorive të caktuara të personave të konsideruar si “*të padenjë për të jetuar*” mes të cilave përfshihen homoseksualët, personat me aftësi të kufizuara, personat me deformime fizike, të meta psikike, etj. Kjo shfarosje barbare masive dhe torturuese e aq shumë njerëzve u konsiderua nga nazistët si ‘*eutanazi*’. Ajo që mungonte veçse, si element përbërës i aktit të ‘*eutanazisë*’ si ai konceptohej dhe në koherencën e ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore, ishte dëshira e personit për të përfunduar jetën e tij. Nazistët i karakterizuan këto eliminime fizike si akte mëshire, dhe pse për nga përmasat që mori, nga mungesa e pëlqimit nga viktimat apo të afërmit e tyre dhe nga vetë qëllimi që nuk ishte tjetër perverse aplikimi i ‘*eugonikës*’ në formën më të tmerrshme të realizuar kurrë më parë për të kryer genocid njerëzor, është e qartë se ky akt ishte thjesht një vrasje e paramenduar në masë të popullsisë së paarmatosur.

1.4.1. Koncept-përkufizimi i eutanazisë

Termi ‘eutanazia’ rrjedh nga bashkimi i fjalëve të greqishtes së lashtë *euthanatos* ku ‘*eu*’ do të thotë e mirë dhe ‘*θανatos*’ do të thotë vdekje. Pra, në kontekst të një përkthimi të thjesht do të thotë vdekje e mirë. Këto dy fjalë kanë shkaktuar përplasje filozofike por njëkohësisht kanë shërbyer edhe si boshti rreth të cilit është zhvilluar mendimi njerëzor

duke u munduar t'i analizojë. 'εὖ' koncepti i *të mirës*, në përgjithësi si materiale dhe shpirtërore ka qenë gjithmonë një pikë referimi për njerëzimin, diçka ideale, të cilën është përpjekur për të kuptuar dhe të përqsasë duke e lidhur ngushtë me ekzistencën e llojit të vet. 'θάνατος' *vdekja*, nga ana tjetër, është konceptuar dhe si mishërimi i së keqes, i vuajtjeve njerëzore dhe i dhimbjes, gjithashtu si një realitet me të cilin kurrësi nuk mund të komprometohet.

Eutanazia fjalë për fjalë, në një përkthim sa më korrekt dhe qasje me mendimin filozofik të grekëve të lashtë, përcillet si *vdekja e mirë*, e lavdishme, e bukur, si *vdekja që vjen pa dhimbje e vuajtje*, si *vdekja e dëshirueshme*. Sot, termi, *eutanazia*, nënkupton "shkaktimin e vdekjes të një personi/pacienti, pa dhe me pëlqimin e tij, "që vuan nga një sëmundje e pashërueshme e cila njëkohësisht shkakton vuajtje të mëdha dhe të papërballueshme për të dhe për të cilin sipas diagnostikimit dhe pas të gjithë mënyrave të trajnimit mjekësor, nuk mund të shpresohet për shërim" (Scherer, J., 1997: 211).

Ky koncept i ri ka shkaktuar debate në arenën ndërkombëtare dhe ka ndezur diskutime intensive dhe polemika rreth etikës ligjit, deontologjisë etj. Standardet mjekësore tronditin. Në gjithnjë e më shumë situata, dy objektivat e mjekësisë, pikërisht kontributi në ruajtjen e jetës dhe lehtësimi nga dhimbjet, identifikohen si qëllimi kryesor dhe i pa negociueshëm. Vlerave morale si element përbërës të krijimit të bindjes për "shenjtësinë e jetës" u ushtrohen presione nga mbështetës të parimit të lirisë së vullnetit dhe të personalitetit të njeriut (Scherer, J & Simon R., 1999:2). Debati mbi eutanazinë është zhvilluar në vendet si SHBA, Kanada, Australi, Britani e Madhe, Holandë, vende ku shoqërive u është premtuar përkujdesje më e mirë për njerëzit, me mbështetje në teknologjinë ndihmëse më të përparuar. Vendimi i Parlamentit Holandez më 28-11-2000

për legalizimin e eutanazisë përçau opinionin ndërkombëtar. Asnjë çështje tjetër nuk ka prekur aq shumë thelbin e ekzistencës etike, filozofike dhe biologjike të individit si çështja e "*Menaxhimit*" të jetës së një të sëmurit, i cili kalon ditët e tij të fundit të jetës i përmbytur në dhimbje dhe dëshpërim. Shumë argumente pro dhe kundër eutanazisë janë bërë në intervale kohore të ndryshëm nga njerëz të njohur të politikës dhe fushës mjekësore dhe shumë mendime të ndryshme janë dhënë (Barile, P., 1984:53).

Eutanazia ka ngjashmëri me vetëvrasjen. Dallimi kryesor qëndron në faktin se personi i cili kërkon "eutanazinë e tij" është atë moment realisht i paaftë fizikisht t'i japë vetë fund jetës së tij dhe kështu që kërkon pjesëmarrjen e një personi tjetër për finalizimin e aktit. Një parakusht, për këtë arsye, por edhe një element konceptual i eutanazisë është dëshira apo edhe thjesht pëlqimi i personit për t'i dhënë fund jetës së tij. Për të qenë i vlefshëm pëlqimi, duhet që personi, kërkues i eutanazisë, të ketë qetësinë shpirtërore dhe të gëzojë shëndetin mendor në mënyrë që të shprehet vullneti i vërtetë i tij (Casonato, C., 2009: 14). Në raste ku është e vështirë ose e pamundur për t'u dhënë pëlqimi i pacientit, është e mundur që vendimi për eutanazi, të mbështetet në vullnetin e supozuar, domethënë në çka do të kërkonte vetë individi në qoftë se do të kishte mundësi ta bënte. Kjo kjo teori gjithsesi mbetet akoma e debatueshme (Pakes, F, 2005:119). Elementi i dytë konceptual i eutanazisë identifikohet te ekzistenca/prezenca gjithmonë e një personi të dytë. Vdekja në eutanazi shkaktohet nga një palë e tretë, e cila duhet të ketë si synim të eliminojë fizikisht pacientin.

Eutanazia është bazuar pra dhe në vullnetin e kryerësit. Por veprimi i mësipërm duhet të motivohet vetëm nga dhembshuria, dashuria për pacientin dhe dëshira për ta lehtësuar nga dhimbjet që po vuan. Nëse diçka e tillë nuk ndodh, por veprimi ka motiv

tjetër, si interesa ekonomike ose të cdo lloji për vepruesin ose të tretë, atëherë nuk jemi në rrethanat e një akti eutanazie por mund të përmbushen elementë të veprës penale të vrasjes me paramendim.

Një tjetër kusht për krijimin e kushteve të cilat do të na ballafaqonin me një akt eutanazie, është edhe gjendja shëndetësore e pacientit, e cila me rrjedhojën e saj nuk do të linte asnjë dyshim për vdekjen e sigurt të këtij të fundit duke shkaktuar vuajtje dhe dhimbje të paevitueshme. Në këto raste presupozohet se në procesin e dhimbjeve, edhe pse mbetet për tu diskutuar, pasi në shumë raste, nuk mund të konkludohet shkencërisht se pacienti ndjen dhimbje (Giunta, F., 1997: 42).

Së fundmi, duhet që procesi i dhënies fund të jetës së pacientit të jetë i tillë, metodikisht i studjuar, duke trajtuar cdo rast si unik, në mënyrë që të “sigurohet” një vdekje e shpejtë, duke eliminuar ne kufijte e mundësive dhimbjet dhe vuajtjet e mundshme dhe absolutisht duke respektuar dhe moscenuar dinjitetin e pacientit³⁷.

1.4.2. Format e eutanazisë

Një nga kriteret për dallimin mes formave të eutanazisë është nëse pacienti ka aftësinë fizike dhe mendore për t’u shprehur në mënyrë të qartë. Nëse po, atëherë eutanazia është vullnetare, pasi personi shpreh vullnetin e tij të lirë. Nëse pacienti nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, atëherë eutanazia është e pavullnetshme dhe vendimi merret nga mjeku ose të afërmit. Mund të bazohet dhe në shprehjen e vullnetit në kohë të mëparshme që i paraprijnë kushteve për aplikim të aktit (*psh personi në moshë të re*

³⁷ Akoma në këtë pikë nuk po analizojmë ligjshmërinë e aktit dhe as bazën morale dhe etike ku mund të bazohet.

shprehet me shkrim noterial, deklarate noteriale, se dëshiron se nqs ndodh të vuajë nga semundje e pashërueshme dhe në pamundësi të shprehjes së vullnetit të tij në atë kohë, t'i mundësohet aplikimi te personi i tij i 'eutanasisë''). Kriter vendimtar për klasifikimin e eutanazisë si të vullnetshme, të pavullnetshme ose të paracaktuar nuk është thjesht konsensusi. Ky kriter vetëm nuk mjafton, pasi është e detyrueshme shprehja e qartë e vullnetit të lirë dhe të supozuar, pasi në qoftë se ky i fundit mungon mund të gjendemi para një akti që cënon thelbin e të drejtave themelore të njeriut, të drejtën e jetës (Neeley, G S., 1995 :116).

Kriteri i dytë për të dalluar eutanazinë, është mënyra e kryerjes së aktit, në qoftë se ky i fundit kryhet me veprime të cilat ndërhyjnë fizikisht në trupin e pacientit. Nëse bëhet me injeksion vdekjeprurës, me barna vdekjeprurese ose në ndonjë mënyrë tjetër atëherë kemi të bëjmë me eutanazi aktive. Nëse veprimi thjesht lejon rrjedhën e ngjarjes si ajo do të vazhdonte, pa ndërhyrje njerëzore për suportim të jetës, psh heqja e prizës së mekanizmit mbështetës, mund të konsiderohet si eutanazi pasive. Eutanazia duhet të klasifikohet në dy nivele, në atë të shprehjes së vullnetit dhe të mënyrës së veprimit në realizimin e saj. Këto dy nivele komunikojnë me njëri tjetrin, angazhohen për të arritur kombinime të ndryshme të tilla si eutanazi të vullnetshme, të pavullnetshme, aktive, pasive etj. Pra kemi disa forma të eutanazisë të cilat janë:

- a) Eutanazia aktive. Është ndërhyrje e drejtëpërdrejtë, veprim aktiv mbi të sëmurin për t'i kursyer dramën që po përjeton. Këtu eutanazia realizohet me mjete të metodave mjekësore, si psh me ineksion vdekjeprurës. Vendimin për eutanazinë aktive mund ta marri vetë personi/pacienti, nëqoftë se është i aftë ose të afërm të rrethit familjar ose dhe mjeku që e ndjek dhe ka përgjegjësinë për të (New York Task Force on Life

and the Law.,1994:79). Është konsideruar si eutanazi aktive dhe vetëvrasja e asistuar, për shkak se mjekët shpesh herë japin këshilla dhe ilaçe për pacientët të cilët kanë shprehur dëshirën për të kryer vetvrasje (Katrougkalos G., 1993:103). *Eutanazia aktive është akti njerëzor i paramenduar me të cilin arrihet rezultati i dëshiruar, vdekja nëpërmjet ndërhyrjes së drejtëpërdrejtë fizike me mjete ose substanca të kontrolluara, në trupin e pacientit.* Në mungesë të kësaj ndërhyrje, pacienti do të vazhdonte të jetonte për një kohë vërtet të kufizuar por të pacaktuar saktësisht, brenda kufijeve të parashikimit të diagnozës mjekësore. Zakonisht, akti vendimtar është një injeksion vdekjeprurës ose dhënia e barnave helmuese me pasojë shkaktimin e pashmangshëm të vdekjes së shpejtë dhe pa dhimbje. Eutanazia aktive është kundërshtuar nga shumica e sistemeve ligjore si e njëhësuar me vrasjen me paramendim në rrethana cilësuese. Po ashtu dhe për legjislacionin penal shqiptar, një akt eutanazie aktive do të konsiderohej si vrasje me dashje në përputhje me nenin 76 të Kodit Penal. Arsyet e kundërshtimit të eutanazisë aktive gjenden te frika e abuzimit me këtë të drejtë nga ana e personit ose personave që legjitimohen në kryerjen fizikisht të aktit duke pasur parasysh se janë pjesëmarrës në vendimmarrjen finale të aktit (të afërmit ose mjeku në rast të eutanazisë aktive të pavullnetshme). Jetët e shumë të sëmurë dhe të moshuarve do të vireshin në rrezik ose te ata do të mund të ushtrohej presion psikologjik, kanosje, për të kërkuar shprehjen e vullnetit për të përfunduar jetën dhe për më shumë do të ishte shumë e vështirë të mund të provohej vullneti i pacientit i shprehur në mënyrë, nganjëherë dhe heshtësore. Në këto raste është e vështirë të provohet nëse vdekja ka ardhur si pasojë e eutanazisë apo si pasojë e vrasjes me paramendim, gjithsesi nuk mund

kurrsesi të mungojë dashja si element përbërës i eutanazisë. Eutanazia nuk mund të kryhet nga pakujdesi).

- b) Eutanazia pasive. Është *eutanazia e tërthortë*, pra ndërprerje të qëllimshme të trajtimit mjekësor të pacientit, në mënyrë që të lejohet ardhja e vdekjes për të. Është heqje dorë nga çfarëdo trajtimi me instrumenta artificiale ose metodë tjetër teknike që do të mbante në jetë pacientin. Në ditët e sotme mjekësia është fokusuar në eutanazinë pasive. Shumica e mjekëve e favorizojnë dhe e përkrahin eutanazinë pasive pasi përkrahin të drejtën e pacientin për jetën por dhe të drejtën e tij për të pasur një vdekje të dëshiruar dhe të konsideruar sipas rrethanave që zhvillohet, rast pas rasti ngjarja, një vdekje natyrale (Meisel, A., 1995:53). Zgjatja e jetës së një pacienti, vdekja e të cilit është absolutisht e pashmangshme në një interval kohor të shkurtër dhe lehtësisht, (*sipas praktikave dhe eksperiencës profesionale të mjekëve*), të përcaktuar, do të ishte e pakuptimtë që të mundësohej me mjete teknike. Gjithashtu, mes juristëve dhe teologëve vlerësohet dhe si një akt që përmban në vetvete dhe vlera morale.
- c) *Eutanazia vullnetare* konsiston në dëshirën dhe vetëdijen e pacientit për të vdekur. Në rastin e eutanazisë aktive pacienti shfaqë vullnetin e tij për të vdekur me anë të refuzimit të marrjes së trajtimit kërkesave të vazhdueshme për ta ndihmuar të vdesë.
- d) *Eutanazia jo-vullnetare* kemi atëherë kur pacienti është totalisht i pavetëdijshëm dhe i patë për të vendosur mbi të drejtën për të jetuar apo për të vdekur. Në rastin e eutanazisë jo-vullnetarë vendimin e saj e merr një i afërm ose një person i cili ka përgjegjësinë e pacientit. Edhe rastet e të miturve të cilët ligjërisht nuk kanë të

drejtë vendimmarrje dhe nuk ka zotësi për të vepruar, dhe ku vendimin për të vdekur e marrin prindërit do të klasifikohet si eutanazi jo-vullnetare.

- e) *Eutanazia indirekte* konsiston në lejimin ose përdorimin e medikamenteve të cilat mund të reduktojnë dhembjet e pacientit por që kanë një ndikim dhe efekt të kundërt në procesin e jetës duke e reduktuar atë. Kryesisht mjekët realizojnë eutanazi indirekte duke i injektuar pacienteve doza të larta qetësuesish për të lehtësuar dhimbjet por ë këto medikamente përshpejtojnë procesin e vdekjes (Ramsay,2011:308).

Eutanazia eugonike, ose në favor të bashkësisë konsiston në eutanazinë që ka si subjekt persona me aftësi të kufizuara, si mendore ashtu dhe fizike. E quajtura ndryshe dhe eutanazi eugonike, realizohet për të “lehtësuar” shoqërinë nga një kosto ekonomike, psikologjike etj. Argumentet që mbështesin këtë lloj eutanazie renditen të pakta

1. jeta e atyre që kanë për detyrë të kujdesen për pacientët e sëmurë është e papërballueshme dhe e padurueshme, si psikologjikisht ashtu dhe ekonomikisht dhe
2. lindja si të gjallë dhe përkujdesja e personave me të meta fizike dhe psikike degradon familjet, pjesë përbërëse të së cilave janë personat e lartpërmendur.

Në ditët e sotme integrimi në shoqëri i personave me aftësi të kufizuara iniciuar nga shoqatat për të drejtat e njeriut dhe mbështetur nga politika motivuese, i ka kthyer këta persona në aktorë aktiv të jetës social ekonomike të vendit duke i përshtatur në një shoqëri që i pranon tashmë dhe jo vetëm, por dhe se merë frytet e punës produktive të tyre. Kjo, ka sjellë si rezultat dhe rrëzimin e argumenteve të mbështetësve të eutanazisë eugonike (Iason, E., 1999: 21-28).

Dimensioni moral dhe psikologjik i fenomenit të eutanazisë ka shkaktuar shumë polemika duke u bërë shkak për argumentime diametralisht të kundërta. Mbështetësit e eutanazisë argumentojnë se para rastit të një pacienti që vuan nga një sëmundje e pashërueshme që shkakton gjatë zhvillimit të saj në organizmin e njeriut, dhimbje të papërballueshme dhe që mund të cilësohen si torturuese, atëherë jeta e këtij pacienti nuk mund më të konsiderohet një e mirë për të, si dhurata e dhënë nga Zoti ose natyra, por tani më, si një makth i vërtetë, nga i cili mund të shpëtohet vetëm me vdekje, pra vetëm me eutanazi, dhe kështu kjo e fundit nuk mund të trajtohet si një akt i dënueshëm si ligjërisht, dhe moralisht, por si një detyrim karshi pacientit dhe personalitetit të tij, si një akt human që rrjedh nga thellësia e shpirtit, për të shërbyer një të mirë përparësore (Kamm, F.M., 1996:27).

Sipas mendimit tim, vendosja e rregullave të qartë të zhvillimit të procesit të eutanazisë dhe kufijve në vendimmarrjen përfundimtare, është një domosdoshmëri që do mundësojë këtë akt humanizmi (eutanazia) duke i ofruar individëve të shoqërisë sigurinë se ekzistojnë dhe funksionojnë mekanizma në kuadër të shtetit të së drejtës, të cilët kur të nevojiten do t'u shërbejnë si alternativë që t'i çlirojnë ata nga rrethana të frikshme, në të cilat mund të gjenden në fund të jetës së tyre. Eutanazia përbën një problem shqetësues të kohëve moderne. I parë si i tillë, duke u vendosur brenda kornizës së zhvillimeve social-politike, ekonomike, teknologjike etj, që mundësuan ri konceptimin e të drejtave themeltare njëkohësisht dhe garantimin e tyre, fillimisht në nivel ndërkombëtar dhe më pas i imponuar nëpërmjet aderimit të shteteve si në organizata ndërkombëtare si dhe në respektim të konventave të BE-së për të drejtat e njeriut, ka ndezur debate publike (Zdenkowski, 1997:174).

Këto instrumente të reja që ofrojnë mundësinë e zgjatjes së jetës edhe në situata që më parë konsiderohej si e pamundur, na shtyn të mendojmë sërish për vlera të caktuara morale të tilla si liria, autonomia dhe përgjegjësia, si të ushtruara individualisht ashtu dhe në kolektiv.

a) *Çështja Dianne Pretty*

Në lidhje me të drejtën për të vdekur në praktikën gjyqësore njihen dy çështje të rëndësishme të cilat trajtojnë pikërisht vullnetin e individit për të kërkuar të drejtën e vdekjes. Kushtu në çështjen *Sanles kundër Spanjës* ku trajtohet rasti i Z. Sampedro i cili ishte tetraplegjik prej shumë vjetësh dhe në moshën 50 vjetarë në vitin 1993 ai iu drejtua gjykatës spanjolle me një kërkesë, me anë të të cilës kërkonte të gëzonte dhe t'i njihej e drejta për të vdekur me ndihmën e personave të tjerë. Në këtë rast Gjykata Spanjolle e kishte ende çështjen në gjykim kur Z. Sampedro vdiq dhe në këto kushte nuk arriti të jepte me një vendim për rastin e tij³⁸.

Çështja e dytë është ajo e *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁹. Në lidhje me çështjen e eutanazisë vendimi *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar* ka një rëndësi të vecante. Diane Pretty në moshën 43 vjeçare vuante nga skleroza laterale amiotroforike, e cila ishte një sëmundje e pashterueshme. Paraliza ishte në të gjithë pjesën e trupit përveç kokës, dhe kishte vështirësi të theksuara në komunikimin verbal si dhe ushqimimi i saj realizohen nëpërmjet aparaturave mjekësore. Në bazë, jo vetëm të legjislacionit anglez, vetëvrasja nuk përbenë vepër penale, por ajo ndodhej në pamundësi fizike që të realizonte aktin e vetëvrasjes dhe dëshironte që bashkëshorti i saj ta ndihmonte që të vdiste pa vuajtje

³⁸ Shih çështjen *Sanles kundër Spanjës*, Vendimi për Pranueshmërinë i 20 tetorit 2000.

³⁹ Shih çështjen *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 29 prillit 2002.

dhe në mënyrë të denjë. Por ndihma në vetëvrasje konsiderohet vepër penale dhe është e dënueshme në bazë të legjislacionit anglez, dhe për rrjedhojë e ndodhur në këto kushte Diane Pretty, nuk dëshironte të rrezikonte lirinë e bashkëshortit, iu drejtua më një kërkesë organeve kompetente. Një prej përfundimeve të rëndësishme është se: Baza ligjore mbi të cilën ankuesja, zonja Diane Pretty e mbështeti ankesën e saj ishin nenet 2⁴⁰, 3⁴¹, 8⁴², 9⁴³ dhe 14⁴⁴ të të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut. Autoritete britanike e refuzuan kërkesën e zonjës Diane Pretty, dhe për këtë arsye ajo iu drejtua GJEDNJ-së me të njëjtin objekt. Në 29 prill Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut me anë të një vendimi unanim, me një trup me shtatë gjyqtarë, ka refuzuar ankesën e zonjës Diane Pretty kundër qeverisë britanike, ku kjo e fundit nuk i ofrojë mbrojtje për në ndjekje penale ndaj bashkëshortit të saj i cili duhet të ndihmonte atë në kryerjen e vetëvrasjes. Gjykata refuzoj kërkesën e Diane sipas të cilës nuk po respektohej e drejta e saj, duke theksuar që jeta e saj

⁴⁰ Shih nenin 2 të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku thuhet se E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj. 2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme: a. në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; b. për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjrisht; c. për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

⁴¹ Shih nenin 3 të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku thuhet se Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

⁴² Shih nenin 8 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku thuhet se Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve

⁴³ Shih nenin 9 të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku thuhet se Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

⁴⁴ Shih nenin 14 të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku thuhet se Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

mbrohej në bazë të nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata në lidhje me nenin 9 është shprehur se e ka gjetur të pabazuar kërkesën e ankueses se refuzimi ka ardhur si pasojë e besimit fetarë, duke mos e pranuar dhe mos krijuar mundësinë e një precedenti të pavend me këtë çështje. Në lidhje me interpretimin e nenit 14 të KEDNJ-së Gjykata e refuzoj ankesën e Diane, në lidhje me diskriminimin e pretenduar nga ajo, përse i përket të drejtës për vetëvrasje për personat që janë fizikisht të paaftë. Gjykata e ka arsyetuar refuzimin e saj me arsyetimin se në bazë të legjislacionit anglez ndihma në vetëvrasje konsiderohet vepër penale dhe është e dënueshme.

b) Çështja Lambert dhe të tjerë kundër Francës

Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 46043/14) kundër Republikës së Francës depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nga katër shtetas francezë, Mr Pierre Lambert dhe znj Viviane Lambert, Z. David Philippon dhe znj Anne Tuarze, më 23 qershor 2014. Në kete datë ankuesit që janë katër shtetas francezë, Mr Pierre Lambert dhe znj Viviane Lambert, Z. David Philippon dhe znj Anne Tuarze depozituan në Gjykatë ankimin Nr. 46043/14 kundër Republikës së Francës, duke përdorur si bazë ligjore nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁴⁵. Shtetasi francez Vincent Lambert, në vitin 2008, në moshë 39 vjeçare, si pasojë e një aksidenti rrugorë pësoj dëmtime të rënda dhe të parikuperueshme mendore, dëmtime të cilat i pengonin zhvillimin e një jetese në kushte

⁴⁵ Shih nenin 34 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore , ku thuhet se; Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

autonomie dhe të pavarura nga aparaturat apo ndihma fizike e një individi tjetër që duhej të kujdesej për të. Pasojat e këtij aksidenti e shndërruan në tetraplegjik duke e vendosur në gjendjen e vetëdijes minimale, e cila gjykohet nga raportet mjekësore si e pakthyeshme. Lambert nuk kishte mundësi të krijonte asnjë lloj komunikimi dhe jetesa e tij lidhej pas aparaturave mjekësore.

Ankuesit në kërkesën drejtuar Gjykatës pretenduan se kishte shkelje të neni 2 të KRDNJ-së, sepse tërheqja e të ushqyerit dhe hidratimit artificial të Vincent Lambert, përbënte keqtrajtim, duke arritur deri në torturë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventa⁴⁶ dhe do të shkelte integritetin e tij fizik, në shkelje të nenit 8 të Konventës.⁴⁷ Ankuesit pretenduan gjithashtu se sipas nenit L. 1110-1 të Kodit të Shëndetit Publik duhet të përdoren të gjitha mjetet në dispozicion për t'i siguruar për çdo individi të drejtën themelore për mbrojtjen e shëndetit. Po kusht në nenin L. 1110-2 të Kodit të Shëndetit Publik parashikohet se se pacienti ka të drejtën e respektimit të dinjitetit të tij/të saj, ndërsa neni L. 1110-9 shtjellon të gjitha garancitë të cilat i kërkojnë atij të drejtën e kujdesit paliativ. Në nenin L. 1110-10 trajtohet kujdesi sa më aktive dhe i vazhdueshme i destinuara për lehtësimin e dhimbjeve, lehtësimin e vuajtjeve psikologjike, ruajtjen e dinjitetit të pacientit dhe mbështetjen e të afërmit e tij apo të saj. Mbi këtë bazë ligjore u hartua ankuesit pretenduan shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së ne Gjykatë.

⁴⁶ Shih nenin 3 të Konventës Eurapiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore , ku thuhet se . Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

⁴⁷ Shih nenin 8 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore , ku thuhet se 1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve

Gjatë trajtimit të kërkesës së ankuesve Gjykata vërejti se nuk kishte konsensus midis shteteve anëtare të Këshillit të Europës në favor të lejimit mbi tërheqjen e trajtimit të cilat mbanin në jetë pacientin e përmendur. Gjykata ishte plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e çështjeve së ngritur nga rasti në fjalë, e cila bënte fjalë për një çështje jashtëzakonisht komplekse në aspektin mjekësor, ligjor dhe etike. Në këto kushte Gjykata përsëriti se në këtë çështje vendimi për të tërhequr trajtimin ishte në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë të Konventës, dhe për të përmbushur dëshirën e pacientit në përputhje me ligjin kombëtar, ishte nën përgjegjësinë e autoriteteve vendore. Roli i Gjykatës konsistonte vetëm në shqyrtimin e pajtueshmërisë së kërkesës me detyrimet pozitive që rrjedhin nga neni 2 i Konventës. E gjendur në këto kushte Gjykata vendosi të shqyrtonte raste të trajtuara nga legjislacioni i brendshëm francez, e vetëdijshme për rëndësinë e rastit dhe për precedentin që do të krijonte në marrjen e këtij vendimi.

Gjykata vuri në dukje se procedura në rastin konkret ka qenë e gjatë dhe e përpiktë, duke tejkaluar kërkesat e përcaktuara me ligj, dhe konsiderohet se, edhe pse aplikantët nuk u pajtuan me rezultatin, procedura kishte plotësuar kërkesat që rrjedhin nga neni 2 i Konventës.

Gjykata arriti në përfundimin se rasti në fjalë kishte qenë subjekt i një shqyrtimi të hollësishëm dhe se çdo mendim i dhënë dhe do konkluzion janë analizuar në mënyrë të kujdesshme dhe nën metodën e argumentimit të detajuar mjekësor nga ana e ekspertëve mjekësor dhe vëzhgimeve të përgjithshme nga autoritetet të rangut të lartë të organeve mjekësore dhe etike. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet vendase kanë respektuar detyrimet e tyre pozitive që rrjedhin nga neni 2 i Konventës, në funksion të lirisë së vlerësimit lënë atyre në rastin në fjalë, dhe se nuk kishte shkelje të nenit. Gjykata vendosi të

autorizojë pezullimin e trajtimit mjekësor që e mban të gjallë. Pavarësisht se në Francë eutanazia ishte e ndaluar me ligj, shohim që në vitin 2005 behet një përpjekje për të bërë të mundur zbatimin e eutanazisë pasive. Kjo formë eutanazie konsiston në lejimin e stafit mjekësorë për të zgjedhur nëse duhet ndaluar trajtimi për një pacient. Nisur nga fakti që më 24 qershor 2014, Këshilli francez i shtetit kishte vendosur në favor të ndërprerjes së trajtimeve mjekësore të cilat mbanin gjallë Lambert, duke marrë në konsideratë dhe kërkesën e bashkëshortes së tij, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendosi në favor të bashkëshortes së Lambert, duke arsyetuar që ky vendim nuk përbënte shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së. Gjatë shqyrtimit të kërkesës në lidhje me pretendimin e ankuesve që kishte shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, Gjykata u shpreh se kjo bazë ligjore është absorbuar nga përdorimi i nenit 2 të KEDNJ-së si bazë ligjore dhe se nuk ishte i nevojshëm përdorimi i këtij neni.

1.4.3. Vetëvrasja dhe ndihma në vetëvrasje. Zhvillimet e fundit

Pjesa më e madhe e religjioneve e konsiderojnë vetëvrasjen si mëkat, ndërsa në disa shtete ajo konsiderohet si krim. Për herë të parë termi vetëvrasje (*suicid*) është përdorur në shekullin XIII. Më parë quhej “vrasja” (*homicid*) e vetvetes. Vetëvrasja nuk është mishërim i forcës dhe shpesh vjen pas një periudhe të gjatë depresioni. Vetëvrasja duket si zgjidhja e problemeve kur personi mendon se tani nuk ka zgjidhje për problemet e tij. Vetëvrasja në shumicën e shoqërive është e ndaluar. Nga pikëpamja juridike, kryerja e vetëvrasjes në shumicën e vendeve të botës nuk konsiderohet si krim pasi nëqoftëse do të konsiderohej si i tillë, duhet që dhe autori i saj të dënohej dhe nuk mund të dënohej kurrësi një i vdekur. Ndërsa, ndihma që jepet për shkaktimin e vetëvrasjes, në shumë vende konsiderohet si

krim. Studimi i parë shkencor për vetëvrasjen është kryer nga Emil Dyrkemi (Emil Durkheim 1858-1917) i cili në vitin 1897 botoi njërin nga librat më të rëndësishëm në sociologji, “Vetëvrasja: një studim në sociologji” (Durkheim, E., 1897 :22-54).

Në lidhje me termin e vetëvrasjes studiues të ndryshëm kanë arritur në konkluzionin se me vetëvrasje do të kuptojmë ‘*veprimin e një personi për të shkaktuar vdekjen e vet, për t’i shpëtuar një situatë të gjykuar të padëshirueshme për të.*’ Depresioni është paraprijës i shumicës së vetëvrasjeve. Vetëvrasja është pasoja më e tmerrshme e depresionit bipolar apo atij unipolar. Sot në botë është rritur ndjeshëm numri i personave të cilët kryejnë vetëvrasje. Kështu sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë në çdo 40 sekonda në botë dikush bën vetëvrasje. Vetëvrasja tani zë vendin e tetë në botë, në mesin e shkaqeve kryesore të vdekjes në popullatën e përgjithshme dhe madje është shkaku i tretë kryesor i vdekjes së individëve të moshave ndërmjet 15 dhe 24 vjeç. Ndonjëherë, vetëvrasja është menduar edhe si vepër e arsyes së lartë. Seneka, një filozof romak ka thënë: “*Jeta nuk është e mirë, përveç jetës së mirë. Prandaj, njeriu i mençur jeton mirë aq sa duhet, e jo aq gjatë sa mundet... Ai gjithmonë duhet ta mendojë jetën në kushtet e cilësisë e jo në të sasisë ... Vdekja e hershme apo e vonshme nuk ka rëndësi, vdekja e mirë apo nga sëmundja ka*” Shumë vende të botës kanë qëndrime nderuese apo lavdëruese rreth vetëvrasjes. Në Japoni vetëvrasja është një akt i glorifikuar sepse populli japonez beson se vetëvrasja është një zgjidhje krenare e problemeve të pazgjidhura. Edhe pse shumë kultura e pranojnë vetëvrasjen, në të shumtën e rasteve ajo konsiderohet si një akt i fundit dëshpërues për dalje nga situata (Gaumer, C, and Griffith, P, 1998:357). Jeta e individit është subjekt mbrojtjeje kushtetuese nga fillimi i saj dhe deri në përfundim.

Për këtë arsye konsiderohet absolutisht e nevojshme të caktohet qartë kufijtë kohorë brenda kornizës të së cilëve gjejnë zbatim të gjitha parashikimet ligjore mbrojtëse të kësaj të drejte (Vv, Aa., 2005:406).

Në lidhje me ndihmën e dhënë për vetëvrasje Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kur përballet me këtë çështje, i lë gjithmonë një hapësirë më të gjerë vlerësimit të gjykatave të brendshme kombëtare. Lind pyetja a jemi përpara shkeljes së nenit 2 të KEDNJ në rastin ku i jepet trajtim analgjezik një personi në gjendje të rëndë shëndetësore, që po vdes, dhe nëse ky trajtim ka efektin anësor të përshpejtimit të vdekjes së pacientit. (Kroff. D,2011:18) Për këtë çështje, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandon se Shtetet Anëtare duhet: *të sigurojnë që, përveç kur pacienti zgjedh ndryshe, një person në gjendje terminale apo që është duke vdekur, të marrë përkujdes të duhur për qetësimin e dhimbjeve edhe nëse ky trajtim si efekt anësor mund të kontribuojë në shkurtimin e jetës së individit*⁴⁸. GJEDNJ, në çështjen *Pretty* (Brown, A., 2002:8), të cilës do i referohem më poshtë, iu referua Rekomandimit 1418 (1999). Përsa i përket dakortësisë për këtë çështje dhe njohjen e lirisë së zgjedhjes për individin në këtë rekomandim dhe në praktikën shtetërore, duhet pranuar se mundësia e një përjasje të tillë nuk bie në kundërshtim me Konventën. Në lidhje me faktin nëse eutanazia mund të konsiderohet e pranueshme dhe në përputhje me Konventën edhe në mungesë të një shprehjeje të qartë të vullnetit të personit në fjalë, dhe jo ndihmë në vetëvrasje, akoma nuk është përcaktuar nga organet e Konventës. Vrasjet e mëshirshme konsiderohen si të pranueshme në bazë të Rekomandimit Nr: 1418 të viti 1999, në rastet kur pacienti e kërkon vetë, si rasti i heqjes së

⁴⁸ Shiko te Rekomandimi i KE nr.1418 (1999), paragrafi 9.

aparatis që mbante në jetë pacientin si në çështjen e mësipërme të Z. A⁴⁹. Çështjet që ka trajtuar GJEDNJ-ja konsistojnë në faktin që një i sëmurë rëndë fizikisht, që gëzon shëndet të plotë mendërisht ka të drejtë të zgjedhë që të vdesë duke kryer vetëvrasje, sesa të vazhdojë të jetojë dhe nëse ndodh kështu, nëse ai person mund të kërkojë asistencë nga të tjerët për ta realizuar këtë, apo nëse shteti ka të drejtë apo detyrim për të ndërhyrë në parandalimin e saj⁵⁰. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave i referohet kryesisht nenit 2 të KEDNJ-së dhe neneve 3 dhe 8 në mënyrë të tillë që të mund të demonstrojë përjasjen e saj holistike ndaj të drejtave që mbrohen në Konventë.

Në trajtimin e çështjes *X kundër Gjermanisë* të vitit 1984 Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës. Çështja në fjalë konsistonte me ushqimin me forcë nga ana e autoriteteve të një të burgosuri i cili ishte futur në grevë urie. I burgosuri e bazoj mëkresën e tij në nenin 3 të Konventës duke pretenduar që nga ana e autoriteteve ishte përdorur një trajtim çnjerëzor dhe poshtërues që bije në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Por ai nuk e parashtroi të drejtën e tij për të zgjedhur një vdekje duke e vrarë veten me anë të grevës së urisë, në bazë të Konventës. Në këto kushte GJEDNJ rrëzoi kërkesën e shtetasit X me arsyetimin se “*Ushqimimi me zor i një personi përfshin në fakt*

⁴⁹ Vija ndarëse midis heqjes “pasive” të aparatis që mban jetën e pacientit dhe eutanazisë “aktive” nuk është e qartë. Shih për shembull çështjen e Mbretërisë së Bashkuar te *Re J*, të përmendur në vendimin tek *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në paragrafin 18. Problemi i pëlqimit gjithashtu nuk është i qartësuar mirë. Gjatë adoptimit të Ligjit Holandez mbi Eutanazinë të vitit 2001, Parlamenti Holandez diskutoi nëse një deklaratë me shkrim e personit që kërkon eutanazi në rastin e një *demenca senile* (harresë) në vijim, mund të përbëjë motiv për dhënien fund të jetës së atij personi kur ajo shfaqet, por kjo çështje nuk zgjidhet qartësisht në ligj. Kushti kryesor në bazë të ligjit (përveç përcaktimit të një “vuajtjeje të pashpresë dhe të padurueshme”) mbetet dhënia e lirë dhe e shprehur e pëlqimit nga ana e pacientit, bazuar në informacionin e detajuar dhënë pacientit në lidhje me gjendjen dhe këndvështrimin të tij apo të saj - që sugjeron se kjo nuk mund të përmbushet paraprakisht *in abstracto*. Nga ana tjetër, ligji lejon eutanazinë tek fëmijët midis moshës 12 dhe 16 vjeç me pëlqimin e fëmijës dhe prindit, nëse fëmija konsiderohet “i aftë për të bërë një vlerësim të arsyeshëm të interesave të tij [apo të saj].” Neni 2 paragrafi 4 i Ligjit mbi Eutanazinë.

⁵⁰ Një çështje në lidhje me një situatë ndryshe, Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar, në të cilën Shteti akuzohej se nuk kishte mbrojtur mjaftueshëm një person të sëmurë mendërisht nga vetëvrasja, trajtohet në pjesën mbi “parandalimi i vetëvrasjeve nga të burgosurit”.

elementë poshtërues që në rrethana të caktuara mund të konsiderohen se ndalohen nga Neni 3 i Konventës. Në Konventë përcaktohet se Palët Kontraktuese kanë detyrimin t'i sigurojnë çdokujt të drejtën për jetën si ajo parashtrohet në nenin 2. Konkretisht në rastin në fjalë detyrimi i shtetit konsistonte në marrjen e masave kundër realizimit të qëllimit të tij që lihet vetëvrasja. Dhe këto mas ishin ushqyerja forcërisht e të burgosurit. Kjo masë legjitimohet nga Konventa në kuadër të detyrimeve pozitive që ka shteti ndaj mbrojtjes së të drejtës së jetës, sepse nëse nga ana e shtetit nuk do të ishin marrë masat e duhura, dhe i burgosuri do të lihej të vetëvritej nga grave e urisë, atëherë do të ishim përpara kushteve të ofrimit të ndihmës për të realizuar vetëvrasje.

Dianne Pretty kunder Mbretërisë së Bashkaur është çështja që u trajtua nga GJEDNJ/ja. Vuante nga sëmundja e neuronit motorik, e cila ishte një sëmundje e pashërueshme e cila ishte në një fazë të avancuar. Ajo ishte e paralizuar dhe nuk kishte mundësi komunikimi dhe as lëvizjeje. Ushqimimi dhe gjithë procesi jetësor i saj varej totalisht nga aparaturat mjekësore. Dianne në këto kushte dëshironte t'i jepte fund jetës së saj me ndihmën e bashkëshortit të saj duke qenë se e ndjente vetën të poshtëruar nga kjo formë jetese. Por në legjislacionin anglez vetëvrasja nuk konsiderohet vepër penale por ndihma që i ofrohet një individi për të realizuar vetëvrasje konsiderohet si e tillë dhe është e dënueshme.⁵¹ Kështu Dianne i parashtroj Drejtorit të Ndjekjeve Publike një kërkesë ku kërkonte që bashkëshorti i saj të përjashtohej nga dënimi në rast se do ta ndihmonte atë në realizimin e aktit të vetëvrasjes duke qenë se ajo ndodhej në pamundësi fizika për ta realizuar këtë akt.

⁵¹ Gjithashtu sipas legjislacionit penal grek i cili ndalon asistencën në vevrasje në nenin 301 të Kodit Penal Grek.

Kërkesa e saj u refuzua nga ana e drejtorit dhe për këtë arsye Dianne iu drejtua gjykatës anglezë për të rrëzuar vendimin e dhënë nga Drejtorit të Ndjekjeve Publike, kërkesë e cila iu refuzua edhe nga ana e gjykatës. E gjendur me dy vendime refuzimi Znj. Pretty i'u drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila pranoj të shqyrtoj kërkesën e saj duke theksuar se e drejta për jetë garantohet në nenin 2 të KEDNJ-së. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje Gjykata vendosi të tregohej e kujdesshme duke moj lejuar interpretime të gabuara nga ana e shteteve të cilat e njohin të drejtën për të vdekur. Nisur nga fakti që kërkesa e Dianne ishte e bazuar edhe në disa nene të tjera të Konventës, dhe Gjykata e shpreh se në momentin e marrjes së vendimit do të merrte në konsideratë edhe këto nene. Kështu ankuesja e mbështeti ankesën edhe te neni 3 të Konventës duke argumentuar se refuzimi i kërkesës së saj për të kryer vetëvrasje do të përbente një trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues. Poshtërues. Gjykata në vendimin e dhënë nuk konstatoj shkelje të nenit 3 në rastin e Dianne dhe në lidhje pretendimin e ankuseses për nenit 3, Gjykata u shpreh se interpretimi i këtij neni do të realizohet në kontekst me nenin 2 të KEDNJ-së. Pra sipas argumentimin që jep gjykata neni 3 nuk u mund t'i imponoj shteteve detyrimin për të lejuar që personat të ndryshëm të ndërmarrin hapa për të realizuar vetëvrasje apo për të ndihmuar në vetëvrasje.

Në Shqipëri ndihma në vetëvrasje nuk dënohet me ligj, në ndryshim nga Greqia e cila ndihmën që ofrohet në e konsideron vepër penale duke e dënuar me burgim. Sipas Kodit Penal grek kush kryen vrasje pas një kërkesë këmbëngulëse dhe të rëndësishme të viktimës dhe për mëshirë për atë që vuan nga një sëmundje e rëndë, e pasherueshme, dënohet me burgim. Ligjvënësi penal grek garanton të drejtën e jetës edhe në legjislationin e brendshëm nëpërmjet nenit 5 të Kushtetutës Greke, duke i dënuar aktet e vetëvrasjes dhe

të eutanazisë dhe duke theksuar edhe një herë karakterin absolut të të drejtës për jetën por njëkohësisht dhe duke ruajtur ato ekuilibra që duhet të ruhen, sipas dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjatë zbatimit të këtyre dispozitave.

1.5. Dënimi me vdekje. Çështja e dënimit me vdekje sipas KEDNJ-së

Dënimi me vdekje është një çështje shumë e rëndësishme e cila shpesh herë diskutohet dhe vlerësohet e veçuar nga çështjet e tjera në kontekstit të tij shoqëror. Përpjekjet për heqjen e dënimit me vdekje janë dëshmi e nivelit të civilizimit të shoqërisë në të cilën jetojmë. Çështja e heqjes së dënimit me vdekje është kryefjala e iniciative në lidhje me mbrojtjen e jetës, nisur nga fakti që ky dënim është një cenim i pastër i të drejtës së jetës (Daci.J,2011:247).

Çdo kush gëzon mundësin e gëzimit të të drejtave të njeriut pavarësisht nëse ka kryer ose jo një veprim i cili është i dënueshëm nga ligji. Mesazhi i një shoqërie që beson në të drejtat e njeriut është që këto të drejta nuk duhet të shkelen kurrë⁵². Por dënimi me vdekje rrezikon seriozisht respektimin të drejtave të njeriut duke cenuar të drejtën e jetës pa të ekzistencën e të cilës çdo e drejtë tjetër nuk do të kishte zbatueshmëri dhe për rrjedhojë

⁵² Gjithkush, anëtar i familjes së të cilit ka rënë viktimë e një krimi të dhunshëm, ndjen shumë emocione të forta përfshirë tërbim, zemërim, tronditje, dëshpërim, vuajtje, neveri dhe një dëshirë për t'u hakmarrë dhe për të ndëshkuar personin që kreu atë krim. Këto janë reagime krejt të natyrshme njerëzore. Çdokush do të donte që ky person të kapej sa më shpejt që të ishte e mundur dhe të ndëshkohej ashpër. Kjo kërkon një imponim efikas të ligjit dhe një sistem gjyqësor të efektshëm. Një sistem ku krimet hetohen në mënyrë të efektshme dhe të plotë, të dyshuarit gjykohen shpejt dhe me drejtësi dhe fajtorët ndëshkohen. Është thelbësore që të ketë procedura të përshtatshme për të siguruar që të kapet dhe ndëshkohet personi i saktë, jo dikush që është i pafajshëm ndërsa autori i krimit të lejohet të jetë i lirë. Dënimi me vdekje nuk siguron se do të kapet autori i saktë i krimit. Shumë më shpesh ofron një reagim tepër dramatik që shërben për të fshehur mungesën e efikasitetit në sistemin e drejtësisë penale. Vrasja e autorit të krimit do të ishte një reagim barbar dhe anakronik ndaj kësaj situatë të tmerrshme dhe që nuk i përshtatet një shoqërie të civilizuar të udhëhequr prej shtetit të së drejtës. Historia e përpjekjes për të krijuar shtetin e së drejtës është një histori e kufizimit në rritje të hakmarrjes personale në politikën publike dhe kodet ligjore. Është një histori e krijimit të procedurave efikase dhe të drejta që i përshtaten një shoqërie njerëzore, e cila ndëshkon kriminelët duke respektuar të drejtat themelore të njeriut.

nuk do të ekzistonte. Dënimi me vdekje ka gëzuar një rregullim ligjorë që në Kodin e Hammurabit, i cili parashikonte dënimin me vdekje për 25 krime, mes të cilëve dhe tradhtia bashkëshortore⁵³. Format dhe mënyrat e ekzekutimit të dënimit me vdekje anë qenë të ndryshme në periudha të ndryshme. Kështu mënyra e ekzekutimit me kryqëzimi përdorej në periudhën e antikitetit kryesisht nga romakët⁵⁴.

Pushkatimi ishte një formë tjetër ekzekutimi të dënimit me vdekje e cila ka gjetur zbatim kryesisht në shekullin XVIII fillimisht në Shtetet e Bashkuara gjatë Luftës për Pavarësi (1775-1783) dhe më vonë mori përmasa aplikimi pothuajse në të gjithë botën. Kësaj forme ekzekutimi nuk i ka shpëtuar edhe Shqipëria e cila e ka përdorur gjatë periudhës së regjimit komunist. Më vonë filloj të zbatohet qëllimi me gurë, varja me litar, gijotina, dhoma me gaz, karrigia elektrike etj, ku kjo e fundit nis të përdorej në shekullin XX, tani nuk përdoret më. Në shekullin XX u përdorën dhe dhomat me gaz që në fillim u përdorën në SHBA, për t'u përhapur më pas në Gjermaninë naziste gjatë Holokaustit (Janis, M., Kay, R., and Bradley, A., 2008:130).

Praktikat e fundit që po përdoren për zbatimin e dënimit me vdekje është injektimi vdekjeprurës i cili konsiston në injektimin e disa substancave kimik në trupin e të dënuarit që shkaktojnë bllokimin e aparatit frymëmarrës. Aplikimi i kësaj mënyre realizohet duke marrë në konsideratë të drejtën e individit për të vdekur me dinjitet. Shoqëria civile ka realizuar nisma të shumta në lidhje me sensibilizimin e legjislacioneve për heqjen e dënimit me vdekje. Aktualisht dënimi me vdekje rezulton të jetë hequr në 139 shtete. Shteti i parë i

⁵³ Shih Kodin e Hamurabit i cili përcaktonte dënimin me vdekje në këtë kod janë *akuza fallco, rrëmbimi i fëmijëve, dhunimi i shtëpisë*, por dhe pse duket sot e çuditshme, *vrasja* nuk përfshihej shpesh.

⁵⁴ Viktima kryqëzohej, dhe më pas vdiste nga hemorragjia, infarkti ose bllokimi i rrugëve të frymëmarrjes, pas një agonie që zgjaste më ditë. Kryqëzimi është bërë mjaft i njohur nga kryqëzimi i Jezu Krishtit.

cili ka hequr dënimin me vdekje duke treguar në këtë mënyrë një zhvillim të lartë demokratik dhe ku respektimi i të drejtave të njeriut ka qenë në nivele të larta është Duka i madh i Toskanës më i cili e konsideronte këtë dënim si *“të përshtatshëm vetëm për popujt barbarë”*. Vendi i fundit që ka hequr dënimin me vdekje është Letonia cila e shfuqizoj atë në vitin 2013. Ka ende vende të cilat e lejojnë dhe aplikojnë dënimin me vdekje Kina,⁵⁵ Irani, Iraku, Arabia Saudite dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës⁵⁶ Amnesty International⁵⁷ lufton heqjen e dënimit me vdekje në botë, argumenton në raportet e saj se dënimet shpesh vijnë nga procese të padrejta dhe mbi të gjitha në vendet ku aplikohet dënimi me vdekje të dhënat tregojnë se krimi nuk është dekurajuar. Në vendet ku është në fuqi ekzekutimi me vdekje mund të dënohesh me këtë dënim edhe për korrupsion, tradhti bashkëshortore, drogë, evazion fiskal, vjedhje makinash, ndërsa në Korenë e Veriut dënohen edhe homoseksualët, por edhe nëse shikon një telenovelë të ndaluar. Gjatë vitit të paktën 28 vende kanë falur me ndryshimin e llojit të dënimit disa dënime me vdekje (More Th., 1981:102).

⁵⁵ Sipas Amnesty International Kina ka më shumë dënime me vdekje se të gjitha shtetet e tjera së bashku, por nga ana tjetër Pekini nuk e tregon asnjëherë numrin e saktë.

⁵⁶ Sipas Amnesty International në SHBA, qeveria është shumë transparente me të dhënat, ku sipas organizatave të të drejtave civile dënimi kapital konfigurohet si një lloj lotarie makabre: nga 22 mijë krime të ndodhura çdo vit, rreth 100 persona dënohen me vdekje. Viti i rekordit të tmerrshëm të dënimit me vdekje në SHBA ishte 1996, me një rekord prej 315 ekzekutimesh. Në 2014-ën shifra zbriti në 35. Dënimi me vdekje është ligjor në 32 shtete të SHBA-ve, ndërsa është shfuqizuar në 18, dhe në disa nga këta shtete, si në atë të Nju Jorkut është cilësuar si antikushtetues. Nga dënimi deri në ekzekutim kalojnë mesatarisht rreth 5757 ditë. Misuri, Teksas dhe Florida janë shtetet ku xhelatët punojnë më shumë. Dhe në Teksas nga viti 2011 i dënuar nuk ka më të drejtë të zgjedhë vaktin e fundit. Në foto: vakti i fundit i Larry Eayne EHITE, i dënuar me vdekje në vitin 1997. Pjesa më e madhe e të dënuarve me vdekje në SHBA nga viti 1608 deri më 2002 kishin si profesion “skllavin (11,5% në total), të ndjekur më pas nga profesione të ndryshme, si ushtarët që janë më të shumtë së gangsterët (118 të parët, 110 të dytët); piratët (68); etj. Sot statistikat thonë se më shumë mundësi për t’u dënuar me vdekje janë kategoritë e varfra ose ata që i përkasin një minorance etnike ose fetare si pasojë e diskriminimit të sistemit gjyqësor. Gjithashtu ngaqë të varfit dhe të marginalizuarit kanë më pak akses në burimet juridike të nevojshme për t’u mbrojtur

⁵⁷ Qëllimi i Amnesty International është të promovojë, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, respektimin e të drejtave të njeriut.

https://translate.google.al/translate?hl=sq&sl=it&u=https://it.wikipedia.org/wiki/Uso_della_pena_di_morte_nel_mondo&prev=search

Në Kaliforni dënimi me vdekje konsiderohet si një shërbim i kushtueshëm i cili i kushton taksapaguesve rreth 180 deri në 300 milion dollarë çdo vit.

Nisur nga fakti që dënimi me vdekje shkel të drejtat themelore të njeriut, ndaj traktatet europiane ashtu edhe ndërkombëtare parashikojnë heqjen e dënimit me vdekje në kohë paqeje dhe madje dhe në kohë lufte. Protokolli Nr. 6 I KEDNJ i trupëzon qartë standard dhe parimet europiane, duke parashikuar heqjen e dënimit me vdekje në kohe paqeje (Daci.J.2011:247).

Dënimi me vdekje është një shkelje e hapur e së drejtës për jetën të pranuar ndërkombëtarisht⁵⁸, si dhe e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues. Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (veçanërisht çështja e rëndësishme *Soering*) tregon se “*fenomeni i radhës së vdekjes*” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbën trajtim çnjerëzor dhe poshtërues duke shkelur Nenin 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mizoria e këtij ndëshkimi nuk është kufizuar në brutalitetin e vetë vrasjes, por gjithashtu në ashpërsinë mendore dhe fizike të pritjes së radhës për ekzekutim. Përveç kësaj, dënimi me vdekje shpesh zbatohet në një mënyrë të padrejtë, arbitrare dhe diskriminuese, ai përdoret jo proporcionalisht kundër të varfërve,

⁵⁸ Kohët e fundit, planet e Hungarisë për rikthimin në fuqi të dënimit me vdekje, kanë vënë në lëvizje gjithë Bashkimin European, kështu tema e nxehtë e dënimit kapital është rishfaqur në Europën moderne, ku besohej se ky ritual i përkiste tashmë historisë. Vlen të shihet edhe një herë se çfarë përhapje ka dënimi me vdekje sot në botë, për të kuptuar peshën dhe rëndësinë e problemit. Dënimi me vdekje vazhdon të praktikohet në 36 vende të botës. Ndërkohë 103 shtete e kanë shpallur të paligjshëm këtë lloj dënimi për të gjitha llojet e krimeve, kurse 6 shtete e kanë nxjerrë nga përdorimi për krime të zakonshme (duke e mbajtur atë për rrethana speciale, siç janë krimet e luftës). 50 shtete e kanë anuluar *de facto* dënimin me vdekje (pra, s’e kanë përdorur në dhjetë vjetët e fundit). Afërsith të gjitha vendet e botës e ndalojnë ekzekutimin e individëve nën moshën 18 vjeç. Vetëm Irani dhe Arabia Saudite e Sudani kanë kryer dënime me vdekje në këtë moshë. Bashkimi European e ndalon praktimin e dënimit me vdekje për vendet anëtare, me anë të nenit 2 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European. Këshilli i Europës, i cili ka 47 vende anëtare, gjithashtu e ndalon përdorimin e dënimit me vdekje. Megjithatë sot 60% e njerëzimit jetojnë ende në vende ku dënimi kapital nuk është shpallur jashtë ligjit, si Kina, SHBA, India dhe Indonezia. Shqipëria e anulloi formalisht dënimin me vdekje në 1 tetor të vitit 2000.

pakicave dhe anëtarëve të bashkësive racore, etnike dhe fetare. Vetëm një politikë penale humane dhe morale bën dallim ndërmjet kriminelit dhe kriminit dhe kjo është e vetmja politikë me vlerë për një shoqëri demokratike.

1.5.1. Neni 2 dhe Protokoli 6 dhe 13, shfuqizimi i dënimit me vdekje

Deri në vitin 1997 në Europë kishte vende që aplikonin në liri të plotë duke e sanksiononur në ligj dënimin me vdekje. Këshilli i Europës synonte të krijonte një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁵⁹, dhe i dha prioritet procesit të shfuqizimit të dënimit me vdekje. Dënimi me vdekje konsiderohet si një formë e papranueshme e ndëshkimit e papajtueshme me të drejtat themelore të njeriut si e drejta për jetën etj (OSCE,2014:1).

Në vitin 1983 Këshilli i Evropës miratoi instrumentin e parë ligjërish të detyrueshme me anë të të cilit siguroar heqjen e pakushtëzuar të dënimit me vdekje në kohë paqeje. Ky akt ishte pikërisht Protokoli Nr.6 i KEDNJ-së. Ë nënin 2 të këtij protokoli parashikohet se " Një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për akte të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky legjislacion dhe në përputhje me dispozitat e tij. Ky shtet do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dispozitat përkatëse të legjislacionit në fjalë ". Protokoli Nr.6 i KEDNJ-së. Protokoli në nenin 5 të Protokollit Nr.6 përcaktohet se "*Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të dorëzimit të*

⁵⁹ Konventë e miratuar më 1950, sipas të cilës shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zotohen të respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, të drejtat qytetare e politike.

instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në lidhje me të cilët do të gjejë zbatim ky Protokoll.” Duke theksuar në këtë mënyra kufizimet territoriale të përdorimit të këtij Protokolli. Për shtetet anëtarë të cilat kanë miratuar Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut paragrafi i parë i nenit 2 të KEDNJ-së është zëvendësuar nga klauzolat në Protokollet 6 dhe 13 të Konventës që shfuqizojnë dënimin me vdekje në kohë paqeje dhe në të gjitha rrethanat përkatësisht⁶⁰.

GJEDNJ-ja në çështjen e Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar rrëzoi pretendimin e Amnesty International që në Europën Perëndimore dënimi me vdekje të konsiderohej si një ndëshkim çnjerëzor dhe poshtërues brenda kuptimit të Nenit 3 të Konventës⁶¹.

Argumentimi që ka Gjykata në lidhje me marrjen e këtij vendimi ishte se Protokollin Nr. 6 në këtë periudhë nuk ishte ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar. Në këto rrethana, pavarësisht nga karakteri i veçantë i Konventës, Neni 3 nuk mund të interpretohet se ndalon në përgjithësi dënimin me vdekje⁶².

Në çështjen Ocalan kundër Turqisë⁶³ ku Z. Abdullah Ocalan që ishte rrëmbyer nga agjentët turq nga Kenia për në Turqi fillimisht u dënua me vdekje nga ana e një Gjykatë të Sigurisë së Shtetit. Z. Ocalan pretendoi, ndërmjet të tjerash, se dënimi me vdekje nga vetë natyra e tij ishte çnjerëzor dhe poshtërues⁶⁴.

⁶⁰ Protokollin Nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Shfuqizimin e Dënimit me Vdekje, STE 114, e 28 prillit 1983, hyri në fuqi që në 1 mars 1985, Protokollin Nr. 13 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Shfuqizimin e Dënimit me Vdekje në të gjitha Rrethanat, STE 187, e 3 majit 2002, në fuqi që në 1 korrik 2003.

⁶¹ Vendimi tek *Soering*, para. 101.

⁶² Vendimi tek *Soering*, paragrafët 102 – 103.

⁶³ *Ocalan kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 majit 2005, shih edhe vendimin e Dhomës më 12 mars 2003.

⁶⁴ Kërkuesi pretendoi edhe se cdo rekurs ndaj dënimit me vdekje, pra, jo vetëm të zbatimit aktual të këtij dënimi, por edhe tamam të detyrimit për të mos e ekzekutuar, do të cënonte të dy Nenet, 2 dhe 3 të Konventës. Gjykata e hodhi poshtë këtë pretendim: shih paragrafët 154 – 155.

Protokollin Nr. 6 është ratifikuar nga të gjitha shtete me përjashtim të Turqisë, Armenisë dhe Rusisë⁶⁵.

Këshilli i Europës po e kufizon të drejtën e anëtarësimit të shteteve të reja, me shfuqizimin e dënimit me vdekje dhe për rrjedhojë në të gjitha këto territore nuk ekziston më dënimi me vdekje. Protokollin Nr.6 dhe se ky protokoll është ratifikuar nga dyzet e një Shtete. Në Nenet 3 dhe 4 të Protokollit se nuk mund të bëhet asnjë derogim nga ky nen në bazë të Nenit 15 të Konventës dhe se nuk mund të bëhen rezerva në lidhje me të. Protokollin Nr.6 parashikon heqjen e dënimit me vdekje dhe lejimin e tij vetëm në kohë lufte.⁶⁶ Në këto kushte shohim që jeta e individit ishte e mbrojtur nga dënimi me vdekje vetëm në periudha të caktuara kohore. Për rrjedhojë u ndje nevojshme sigurimi i saj në çdo periudhë , dhe për këtë arsye Këshilli i Europës miratoi Protokollin Nr. 13 i cili hiqte dënimin me vdekje në çdo kohë he rrethanë. Ky protokoll u nënshkrua në 3 maj të vitit 2002 dhe hyri në fuqi në 1 korrik 2003.

Shqipëria e ka ratifikuar këtë protokoll në vitin 2002, nisur nga fakti që vëni ynë është anëtarë në Këshillin e Europës. Protokollin Nr. 13 të KEDNJ-se konsiston në heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, përfshirë edhe për akte të kryera në kohë lufte plagë. Ky akt nuk krijon detyrime shtesë për shtetet por përbenë aktin e parë ndërkombëtar i cili nuk e lejon dënimin me vdekje në asnjë periudhë. Sa më sipër tregon rëndësinë e adoptimit dhe gati ratifikimin universal të Protokollit Nr. 6 të Konventës që shfuqizon dënimin me vdekje në kohë paqeje dhe të adoptimit dhe ratifikimit të gjerë (por jo ende

⁶⁵ Në lidhje me datën e vendimit të Dhomës të 12 marsit 2003. Protokollin Nr. 6 tani është ratifikuar nga dyzet e gjashtë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës (duke përfshirë Turqinë) dhe është nënshkruar nga dy të tjerët, Monako dhe Rusia . Monako që atëherë e ka ratifikuar Protokollin e 6-të, vetëm Rusia nuk e ka ratifikuar ende.

⁶⁶ Shih nenin 2 të Protokollit Nr.6 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje.

universal) të Protokollit Nr. 13. Në nenin 1 të Protokollit Nr. 6, shfuqizon dënimin me vdekje duke përcaktuar se' *Dënimi me vdekje do të shfuqizohet. Askush nuk do të dënohet apo ekzekutohet me këtë dënim.*”. Pra është e nevojshme garantimi i këtyre akteve për të siguruar jetën e individit nisur nga fakti që dënimi me vdekje është i pakthyeshëm, dhe se që të mund të respektohet e drejta e jetës duhet të shfuqizohet ky dënim dhe në legjislacionin vendas. Në ato vende ku dënimi me vdekje vazhdon të jetë i ligjshëm, ekzistojnë probleme të mëdha lidhur me respektimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare, veçanërisht në kufizimin e dënimit me vdekje vetëm për krimet më të rënda, përjashtimi i kundërvajtësve të moshës rinore nga fushëveprimi i tij, dhe garancia për një gjykim të drejtë.

Heqja në rang global i dënimit me vdekje është një nga synimet kryesore të politikës së BE-së, në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Në vitin 2010, BE-ja ka dhënë më se 15 deklarata mbi dënimin me vdekje, nga të cilat numri më i madh ishin mbi rastet individuale të aplikimit të tij, dhe zbatoi një numër të madh të iniciativave politike kundër dënimit me vdekje. Përfaqësuesja e Lartë dhe Zëvendës Presidentja Kethrin Eshton gjithashtu deklaroi, në fjalimin e saj në Parlamentin Evropian në qershor 2010, se puna e BE-së drejt heqjes së dënimit me vdekje në mbarë botën është *“prioritet personal i saj (BE-së)”*. Heqja e dënimit me vdekje është një nga prioritetet tematike nën Instrumentin Evropian për të Drejta të Njeriut (EIDHR). Nga viti 1994, Komisioni Evropian, përmes EIDHR-it ka financuar mbi 50 projekte në mbarë botën, me buxhet të përgjithshëm prej më se 33 milionë euro. Qëllimet përfshijnë lobimin dhe përkrahjen e kufizimit në zbatimin e dënimit me vdekje, si dhe moratoriumin dhe heqjen e tij, me ngritjen e vetëdijes së publikut në shtetet e mbetura, me anë të arsimit publik, të mundohet të ndikojë opinionin publik, studime për mënyrën se si sistemet e shteteve për dënimin me vdekje përputhen me

standardet minimale ndërkombëtare, informimi dhe përkrahja e strategjive për zëvendësimin e dënimit me vdekje, sic është dënimi alternativ, përpjekjet për të siguruar mundësinë që të burgosurit të dënuar me vdekje të kenë qasje në nivelin e duhur të ndihmës ligjore dhe trajnimi për avokatët dhe gjykatësit të kufizojnë mundësinë e dënimit me vdekje.

Thirrja e re për Propozime lidhur me veprimet kundër dënimit me vdekje u shpall më 15 qershor 2011, me buxhet prej 7 milionë euro. Kështu EIDHR-ja është burimi kryesor i financimit për projektet përkrahëse për heqjen e dënimit me vdekje në mbarë botën. Dhe si shembull konkret, mund të paraqesim, aktivitetin e financuar nga EIDIR (Instrumentin Evropian për të Drejta të Njeriut), ku në 13 dhe 14 tetor, të 2011 në kuadër të një aktiviteti të financuar nga EIDHR, në Kigali u mbajt një konferencë rajonale mbi heqjen dhe/ose moratoriumin e ekzekutimit të dënimit me vdekje. Konferenca, ku u takuan përfaqësues të Ministrive të Drejtësisë dhe të Punëve të Jashtme nga më se 20 shtete të Afrikës subsahariane, kishte për qëllim të diskutonte heqjen e dënimit me vdekje në Afrikë dhe të shtonte numrin e shteteve që përkrahin rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për moratorium mbi dënimin me vdekje, e cila dhe u votua më pas, në vitin 2012. Ky është një shembull konkret për mënyrën se si Bashkimi Evropian, shtetet në zhvillim dhe shoqëria civile mund të punojnë së bashku dhe të kontribuojnë drejt ndryshimit të kufizimit progresiv dhe heqjes së dënimit me vdekje në mbarë botën (Sharpe, R., Swinton, K., and Roach, K., 2002:186).

1.5.2. Çështja e dënimit me vdekje dhe zhvillimi historik në Shqipëri

Kur dëgjojmë për një krim veçanërisht të urreyer, apo jetojmë me pasigurinë e përditshme që vetëm duket se është duke u rritur, apo jemi të afërm me viktimën e një veprimi brutal, ne përfshihemi prej reagimeve intensive dhe atëherë mund të ndiejmë se autori i krimit duhet të dënohet me vdekje. Vrasjet e ndodhura në fund të vitit 2007 për shkak të gjakmarrjes ose për motive të tjera kanë ngjallur një debat të gjerë publik në media, parlament etj. Dënimi me vdekje prek instinktet tona më të thella. Frika; dhembja, neveria, hakmarrja, pasiguria, nderi, indinjata, urrejtja dhe shumë emocione të tjera ndikjon në opinionet tona. Do e trajtoj këtë temë jo vetëm në kontekstin shqiptar por dhe në kontekst më të gjerë se kaq, në atë global. Duke nxjerrë një konkluzion përfundimtar të vlevshëm i cili është i mbështetur në argumenta shkencorë.

Më 1.1.1952, hyri në fuqi Kodi Penal ku dënimi me vdekje parashikohej në 31 nene, sidomos për krime kundër shtetit, kundër pasurisë, kundër jetës, etj, çka tregonte për ashpërsinë e sanksioneve penale në legjislacionin penal të shtetit totalitar. Ky kod veprroi për rreth 25 vjet dhe në bazë të tij u dënuan me vdekje shumë njerez, ndërmjet të cilëve edhe të pafajshëm. Për të plotësuar më mirë kërkesat e shtetit totalitar me 1 tetor 1977 hyri në fuqi kodi i ri, i politizuar e ideologjizuar. Dënimi me vdekje nuk jepej kundër personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kishin mbushur moshën 18 vjec, si dhe kundër grave që në kohën e kryerjes së krimit ose të gjyqimit, ishin shtatzena. Në bazë të këtij kodi u dënuan me vdekje në proceset gjyqësore të viteve 80-te mjaft persona të akuzuar për krime kundër shtetit. Me gjithë ashpërsimin e sanksioneve penale, vrasjet për hakmarrje gjakmarrje në vitet 1945-1990 zinin 17%, kurse pas viteve 50-te e sidomos 60-te shkonin drejt uljes aq sa në vitet 1951-1955-13.5%, nga viti 1965-1989-asnjë. Shndërrimet e thella

politike, sociale-ekonomike që u bënë pas përmbysjes së shtetit totalitar, nga lëvizja studentore e viteve 90-të dhe reformat në drejtesi diktuan nevojën e një kodi penal të ri që ti përgjigjej kërkesave të demokracisë pluraliste. Me ndryshimet që iu bënë kodit penal me ligjin Nr.7769, datë 16.11.1993, u hoq dënimi me vdekje për krimet e parashikuara nga nenet 51, 52, 58, 60- a, 62 dhe 101 paragrafi i dytë, duke e reduktuar dënimin me vdekje. Me ligjin Nr.7895 datë 27.1.1995 u miratua kodi penal i ri, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 1995, bazuar në parime demokratike. Pjesa e përgjithshme, parashikon dënimin me vdekje, bashkë me burgimin e përjetshëm, si dënim alternativ. Pjesa e posacme e parashikon në 13 raste dënimin me vdekje krahas burgimit të përjetshëm. Pakësimi i dënimit me vdekje në krahasim me kodet penale të shtetit totalitar, është shprehje e demokratizimit të tij. Karakteristike kryesore e kësaj periudhe është se jo vetëm dënimi me vdekje u pakësua në legjislacionin penal, por edhe në praktikën gjyqësore u zbatua si dënim i jashtezakonshëm. Në vitet 1990-1995 janë dënuar me vdekje. Në vitet 1996-1999 (gjashtë muji parë) u dënuan me vdekje gjithsej 17 veta, për krime tejet të rënda, por nga këta nuk është ekzekutuar asnjë, pas marrjes angazhim të shtetit tonë para këshillit të Evropës, për të pezulluar për tre vjet ekzekutimin e dënimit me vdekje.

1.5.3. Parashikimi ligjor në vende të tjera

Ndërsa orvatjet e para të sundimtarëve të kulturuar evropianë nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë për të hequr dënimin kapital se shpejti u përmbysen, lëvizja për ta kufizuar atë vetëm për vrasje ishte e suksesshme në shumë vende aty nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në vitet 1850 shtetet amerikanoqëndrore të Miçiganit e të Viskonsinit e hoqën krejtësisht dënimin me vdekje për vrasje, ndërsa Venezuela u bë vendi i parë që e

hoqi atë për të gjitha krimet më 1863. Portugalia (ku nuk ka pasur ekzekutime qysh nga viti 1843), vendi i parë evropian që hoqi dënimin kapital për vrasje më 1867, u pasua shpejt nga Holanda, Rumania, Italia dhe Norvegjia. Pas luftës I botërore me to u bashkuan Suedia, Danimarka dhe Zvicra. Me mbarimin e tiranisë fashiste, dënimi kapital u braktis në fillim nga Italia 1944 (ai që rivendosur nga Musolini) dhe pastaj nga Republika Federale Gjermane më 1949. Por ajo që e dallon periudhën e sotme nga e kaluara, kur heqja e dënimit me vdekje ishte me tepër një çështje e brendshme “kombëtare”, është zhvillimi i një lëvizjeje politike ndërevropiane për ta bërë heqjen e tij gurin e provës të standardeve kombëtare të pranueshme të respektimit të të drejtave të njeriut. Në fillim të shekullit vetëm tre shtete e kishin hequr në mënyrë të përhershme dënimin me vdekje për të gjitha krimet: Kosta Rika, San Marino dhe Venezuela. Më 1948 numri arriti në tetë. Në fund të vitit 1978 ai u rrit në nëntëmbëdhjetë. Gjatë njëzet viteve të kaluara numri u rrit më se trefish. Gjashtëmbëdhjetë vende të tjera kanë hequr dënimin me vdekje për të gjitha krimet, me përjashtim të atyre të jashtëzakonshme si krimet e kohës së luftës. Krahas vendeve që e kanë hequr dënimin me vdekje për të gjitha krimet ose për krime ordinere, janë edhe njëzet e katër që mund të konsiderohen abolicioniste de facto, duke qenë se ato e mbajnë dënimin me vdekje në ligj, por nuk kanë kryer kurrfarë ekzekutimesh gjatë dhjetë viteve të kaluara, ose kanë marrë një angazhim ndërkombëtar që të mos e bëjnë. Dënimi me vdekje në këto vende ka një domethënie shumë më të madhe simbolike sesa praktike. Këto shifra bëjnë në total 103 vende që e kanë hequr dënimin me vdekje në ligj ose në praktike. Nëntëdhjetë e dy vende të tjera mund të thuhet se e mbajnë dënimin me vdekje, por numri i vendeve që më të vërtet ekzekutojnë të burgosur çdo vit është më i vogël. Më 1997, për shembull, Amnesty International ka regjistruar 2607 ekzekutime në dyzet vende në mbarë botën. Shumica

dërmuese e ekzekutimeve të raportuara, 85%, janë kryer vetëm në katër vende: në Kinë, Iran, Arabinë Saudite dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

1.5.4. Dënimi me vdekje dhe ekstradimi

Në çështjen *Soering* të vitit 1989, Gjykata u shpreh se ende nuk kishte një shpjegim ligjore adekuat për të përcaktuar nëse do të kishim shkelje të nenin 2 të KEDNJ-së nëse ajo do të lejonte ekstradimi në një vend ku kërkuesi mund të përballlet me dënimin me vdekje. Gjykata u shpreh se jemi përpara rastit të një trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues për arsyes së pritjes në radhë e vdekjes në çështjen në fjalë në Shtetin e Virxhinias të Shteteve të Bashkuara. Fakti që shumica e vendeve ka nënshkruar Protokollin Nr: 6, atëherë nuk lejohet dënimi me vdekje sepse ije në kundërshtim me nenin 2 të Konventës.⁶⁷ Pra shtete nuk mund të ekstradojnë një individ në raste se janë të vetëdijshëm që y individ në venin pritës mund të dënohet me vdekje për veprën penale të kryer sepse ky shtet nuk është subjekt i fuqisë së protokollit Nr.6 dhe atij Nr.13. n këto kushte shteti ekstradues duhet të marrë një konfirmim nga ana e shteti pritës se individ nuk do të dënohet me vdekje, përpara se të realizoj ekstradimin e tij. Kërkesa nga ana e shtetit ekstradues behet vetëm nëse ka një dyshim real dhe nëse ekzistojnë motive të karakterit substantive që të çojnë në konkluzionin se ky individ në venin pritës do të jetë subjekt i dënimit me vdekje. Nëse një shtet do të realizonte në kusht të tilla ekstradimin e një individ ther ajo do të përbëjë shkelje të Konventës. Përveç detyrimit të shtetit për të bërë këtë kërkesë , edhe individ ka të drejtë në bazë të nenit 13 të Konventës, i cili i lejon personat pa përjashtim të drejtën për një zgjidhje efektive përpara gjykatave për një shkeljeje andaj një rreziku të pretenduar për

⁶⁷ Shih nenin 2 të Konventës Euroipiane të të Drejtave të Njeriut.

të drejtat e tij ose të saj substantive në bazë të Konventës, për të kërkuar mos ekstradimin në këto kushte në sistemin gjyqësor të brendshëm. Individi mund t'i drejtohet edhe GJEDNJ-së me po të njëjtën kërkesë cila vendos si masë të përkohshme, mosekstradimin e tij deri në marrjen e një vendimi përfundimtarë. Shteti ekstradues nuk duhet ta dorëzojë personin, ndryshe Shteti në fjalë do të shkelte Nenin 34, nëse nuk do ta përmbushë atë kërkesë (Kroff.D,2006.100).

Shteti ekstradues do të shkelte nenet 2 dhe 13 dhe kundrejt Nenit 5, nëse do të dorëzonte individin pa kaluar nëpërmjet një procedure formale në Shtetin ekstradues. Kohët e fundit vërehet aplikimi gjerësisht i praktikave të marrjes së një garancie nga pala tjetër përpara se të realizohet ekstradimi i tij, kjo me qëllimin e vetëm të sigurimit të jetës së tij. Kjo zbatohet edhe për personat që gjenden nën rrezikun e ekstradimit apo dëbimit në një vend ku ata mund të përballen me dënimin me vdekje për të sfiduar ekstradimin e qëllimshëm apo dëbimin në gjykatat vendase. Jo të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar dhe ratifikuar Protokollin Nr:13-të, dhe kjo gjë krijon mangësi ligjore në sistemin mbrojtjes nga dënimi me vdekje. Një ndër këto shtete është dhe Rusia e cila nuk e ka ratifikuar Protokollin dhe mund të ekstradojë persona për në Shtetet që e mbajnë dënimin me vdekje në kohë paqeje, përse kohë që rrethanat e saj nuk cenojnë Nenin 3. Shtetet të cilat parashikojnë dënimin me vdekje e kanë shumë të vështirë të kenë një sistem gjyqësorë të paanshëm i cili mund t marrë vendime objektive në lidhje me ekstradimin ose dëbimin e këtyre personave (Nozick, R., 1974: 28-29).

1.5.5. Ekstradimi, përjashtimi dhe dëbimi

Nuk legjitimohet në parim ekstradimi, përjashtimi apo dhe dëbimi i individit nga vendi, shtetas i të cilit ai nuk është, e bazuar kjo në Konventën Europiane të të Drejtave të

Njeriut,. Gjithsesi, Konventa mund të zbatohet për situata në të cilat kërkuesi do të vuajë, apo mund të vuajë pasoja të kundërta në lidhje me disa të drejta të Konventës, si pasojë e një zhvendosjeje të qëllimshme nga një Shtet që është Palë në Konventë, në një Shtet që nuk është Palë në Konventë, megjithëse këto pasoja mund të materializohen vetëm në këtë të fundit, pra jashtë juridiksionit të Shtetit Palë ekstradues të Konventës, domethënë jashtë hapësirës juridike që mbulon Konventa si e tillë⁶⁸.

Kjo gjë u përcaktua fillimisht në çështjen e Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar⁶⁹. Çështja kishte të bënte me ekstradimin e qëllimshëm të një shtetasi gjerman, Jens Soering, nga Mbretëria e Bashkuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për tu përballur me akuzat për vrasje, të ndodhur në shtetin e Virxhinias. Nëse do të gjendej fajtor, kërkuesi do të dënohej me vdekje në atë juridiksion. Nëpërmjet Ambasadës së saj në Uashington DC, Mbretëria e Bashkuar kërkoi siguri nga ana e Shteteve të Bashkuara në lidhje me masën e dënimit, pra garanci për shqetësimin e saj se mos te i pandehuri dhe më pas fajtori, aplikohet dënimi me vdekje. Për shkak se dënimi me vdekje është hequr në Britaninë e Madhe, Ambasada morri udhëzime që të kërkojë garanci nga ana e SHBA-ve, në përputhje me kërkesat e Traktatit mbi Ekstradimin. Kërkoj garanci që me dorëzimin dhe dënimin e Z. Soering për krimet për të cilat ishte akuzuar, nëse do të ndëshkohej me dënimin me vdekje, ky dënim të mos ekzekutohej. Nëse kjo gjë nuk do të ishte e mundur për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara, pra garancia që kërkohet, dhe kjo për motive kushtetuese, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kërkuan që Qeveria e Shteteve të

⁶⁸ Trajtimi i hershëm i zbatueshmërisë territoriale të Konventës në pjesën për “Përdorimin e forcës vdekjeprurëse në konfliktet ndërkombëtare të armatosura”, fq 90-95 e kësaj teze.

⁶⁹ *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 qershorit 1989.

Bashkuara t'u bëjë një rekomandim autoriteteve kompetente që kërkuesi të mos ndëshkohet me dënimin me vdekje, dhe nëse vendoset për një ndëshkim të tillë, të mos kryhet⁷⁰.

Në përgjigje të kësaj kërke, Shtetet e Bashkuara i transmetuan autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar një deklaratë zyrtare nga Z. James Updike, Prokurori për Kontenë e Bedford Virxhinias, i cili kishte në kompetencë të tij ushtrimin e ndjekjes penale. Në këtë deklaratë, prokurori amerikan nuk dha asnjë garanci të tillë, dhe u shpreh në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje në Mbretërinë e Bashkuar se “*se ka qenë vullneti i Mbretërisë së Bashkuar që dënimi të hiqet, apo të mos kryhet.*” Megjithatë, Z. Updike nuk dëshironte të jepte më shumë siguri dhe kishte si qëllim të kërkonte dënimin me vdekje në çështjen e Z. Soering pasi provat, sipas përcaktimit të bërë nga ai, e mbështesnin kërkesën e prokurorisë për një dënim të tillë, kjo në zbatim rigoroz dhe të ligjit të Kontesë⁷¹.

Në atë kohë, Protokolli 6 i Konventës, që shfuqizon dënimin me vdekje në kohë paqeje për ato Shtete që e nënshkruajnë atë, ende nuk ishte ratifikuar nga Mbretëria e Bashkuar. Kështu, Gjykata nuk mund të shqyrtonte çështjen duke iu referuar atij protokolli. Siç vërehet në kapitullin në lidhje me dënimin me vdekje më poshtë, Gjykata nuk kishte më vullnetin për të gjykuar në atë çështje se dënimi me vdekje nga vetë natyra e tij, është çnjerëzor dhe poshtërues. Megjithatë, kërkuesi pretendoi se kushtet me të cilat ai do të përballej nëse do të dënohej me vdekje në Virxhinia të njohur si “*fenomeni i pritjes në radhë për të vdekur*” ishin çnjerëzore dhe poshtëruese dhe rrjedhimisht, cenonin Nenin 3 të Konventës. Në përgjigje të këtij argumenti, Gjykata përmblodhi parimet që udhëheqin zbatueshmërinë e Konventës për çështjet e ekstradimit, në të cilat pretendohet se ekstradimi

⁷⁰ Vendimi tek *Soering*, paragrafi 15.

⁷¹ Po Aty, paragrafi 20.

i qëllimshëm në vendin pritës do të rezultojë në një trajtim që bie në kundërshtim me Nenin 3 dhe u shpreh si më poshtë *‘‘Për ta përmbledhur, vendimi nga një Shtet Kontraktues për të ekstraduar një të pandehur mund të përfshijë zbatueshmërinë e Nenit 3 të KEDNJ, për trajtimin e çështjes, dhe rrjedhimisht kështu, përfshin përgjegjësinë e atij Shteti duke u bazuar në Konventë, kur motivet substantive kanë bërë të besohet se personi në fjalë, nëse ekstradohet, përballët me një rrezik real të nënshtrimit ndaj torturës apo trajtimit ç’njerëzor apo poshtërues, ose ndëshkimit në vendin kërkues. Përcaktimi i një përgjegjësie të tillë në mënyrë të pashmangshme përfshin analizën e kushteve në vendin kërkues kundrejt standardeve të Nenit 3 të Konventës. Gjithsesi, nuk vihet në diskutim ngarkimi ose përgjegjësia e një vendi pritës qoftë në bazë të të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, apo në bazë të Konventës. Përderisa ka apo mund të përftohen përgjegjësi në bazë të Konventës, është përgjegjësi që përftohet nga Shteti Kontraktues ekstradues dhe e vlerësuar nga hapat që ai ndërmerr, të cilat kanë pasojë të drejtpërdrejtë si një lidhje shkakësore ndaj ekspozimit të një individi kundrejt një keqtrajtimi të paligjshëm⁷². Sipas mendimit të Gjykatës, duke qënë se kushtet në lidhje me pritjen e vdekjes në radhë në Virxhinia cenuan standardet e Nenit 3, Mbretëria e Bashkuar rrjedhimisht nuk mund të ekstradonte Z. Soering në bazë të juridiksionit të saj nëse do të krijohej një rrezik real në ato kushte.*

Këto interpretime të Nenit 3 janë të përshtatshme këtu, pasi shtrihen të njëjtat parime për çështjet në të cilat pretendohet se një ekstradim i qëllimshëm do të rezultojë në një shkelje të së drejtës për jetën. Mund të përmendet specifikisht se në çështjen McCann

⁷² Vendimi tek *Soering*, para. 90. Shih paragrafët 85 – 90 për një arsyetim të plotë.

Gjykata përdori arsyetim të ngjashëm për rëndësinë e Nenit 2, siç është përdorur në citimin e mësipërm në lidhje me Nenin 3 të KEDNJ.

Këto dy dispozita duhet gjithmonë të vendosen në të njëjtin nivel të lartë, si dispozita që jo vetëm mbrojnë të drejtën për jetën, por edhe që parashtrojnë rrethanat *kur mund të justifikohet një privim legjitim i jetës*. Neni 2 radhitet si një nga dispozitat më themelore në Konventë, si një dispozitë që në kohë paqeje nuk pranon asnjë derogim bazuar në Nenin 15. Së bashku (Neni 2 dhe 3 të Konventës), mishërojnë një nga vlerat bazë të shoqërive demokratike e cila përbën dhe gurin themeltar të Këshillit të Evropës⁷³. Kështu, një person nuk mund dhe nuk duhet të ekstradohet apo dëbohet nga një vend, nëse ekzistojnë “*motive substantive*” për të besuar se ai mund të përballet me një “rrezik real” dhe se mund t’i nënshtrohet një trajtimi të tillë që bie në kundërshtim me Nenin 2, pra, nëse personi do të përballej me një “rrezik real” të vdekjes në vendin pritës, pra me qartë, nuk mund të ekstradohet në një vend i cili ka akoma në fuqi dënimin me vdekje. Në raste specifike, çështjet që trajtohen në bazë të Neneve 2 dhe 3 shpesh mbivendosen dhe duhet të renditet shqyrtimi i çështjes në bazë të Nenit 2 nën Nenin 3, ose të përcaktohet se nuk lindin për shqyrtim “çështje të marra veçmas” në lidhje me Nenin 2. Çështja e Ahmed kundër Austrisë⁷⁴ kishte të bënte me një somalez, Z. Ahmed, të cilit i ishte dhënë statusi i refugjatit në Austri pasi, si pjesëtar i një grupi luftues në konfliktin somalez, ai ishte në rrezik persekutimi dhe vrasjeje nëse kthehej në vendin e lindjes. Megjithatë, pasi u dënua për një vepër penale, autoritetet donin ta kthenin në Somali, në bazë të një ligji austriak që

⁷³ *Vendimi i Dhomës së Madhe tek McCann*, paragrafi 147, që i referohet hapur paragrafit 88 të vendimit në *Soering*, në të cilën Gjykata trajtoi po në të njëjtin kontekst çështjen në lidhje me Nenin 3.

⁷⁴ *Ahmed kundër Austrisë*, vendimi i 27 nëntorit 1996.

parashikon një dëbim të tillë në raste të veprave të rënda penale. Autoritetet përfshinë Nenin 33 të Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, që parashikon se: a) Asnjë Shtet Kontraktues nuk duhet të dëbojë apo kthejë (“*refouler*”) një refugjat në asnjë lloj mënyre, në kufijtë e territoreve, ku jeta apo liria mund të kërcënohet për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror, apo të mendimit politik. b) Refugjati, për të cilin ka dyshime të arsyeshme për ta konsideruar si rrezik për sigurinë e një vendi në të cilin ai, pasi është dënuar me anë të një vendimi përfundimtar për një krim veçanërisht të rëndë, përbën rrezik për komunitetin e atij vendi, nuk mund të ngrejë pretendime duke përfitur nga kjo dispozitë. Megjithëse në procedurat vendase kërkuesi kishte argumentuar specifikisht se dëbimi i tij do t’i rrezikonte jetën⁷⁵, dhe megjithëse ai e ripërsëriti këtë pretendim përpara Gjykatës⁷⁶, përpara kësaj të fundit ai nuk përfshiu Nenin 2, duke u mbështetur në vend të kësaj baze ligjore në Nenin 3 të KEDNJ, dhe Gjykata gjithashtu e trajtoi çështjen në bazë të po këtij neni. Gjykata përsëriti se ndërsa Shtetet në përgjithësi kanë të drejtën për të kontrolluar hyrjen, banimin dhe dëbimin e të huajve, si manifestim i parimit të sovranitetit, njëkohësisht, Neni 3 i ndalon ata, në bazë të obligimeve që rrjedhin në zbatim të Konventës, të dëbojnë një person në një vend tjetër, nëse ka “motive substantive” për të besuar se ky person do të përballet me një “rrezik real” të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues në vendin pritës. Vlen të ritheksohet se Neni 3 ndalon torturën apo trajtimin çnjerëzor e poshtërues ose ndëshkimin në terma absolute, pavarësisht nga sjellja e viktimës dhe shtohet se parimi i mësipërm është njësoj i vlefshëm kur lindin për trajtim çështje të dëbimit në bazë të Nenit 3, ku,

⁷⁵ Shih për shembull, vendimin tek *Ahmed*, paragrafi 21.

⁷⁶ Po Aty, paragrafi. 35, fjalia e fundit.

përkatësisht, veprimtaritë e individit në fjalë, pavarësisht sa të padëshirueshme apo të rrezikshme kanë qenë, nuk mund të trajtohen nga pikëpamja materiale. Mbrojtja e siguar nga Neni 3 është pra me e gjerë sesa parashikohet në Nenin 33 të Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe prevalon në zbatim (neni 3 KEDNJ) ndaj këtij të fundit⁷⁷.

Në rastin në fjalë, duke përsëritur precedentë të mëparshëm në lidhje me faktin se, për të analizuar rrezikun me të cilin mund të përballlet një kërkues, “*çështja të trajtohet në bazë të precedentit të Gjykatës*”⁷⁸, Gjykata pranoi konstatimin e Komisionit se “*nuk ka asnjë tregues që të provojë se rreziqet ndaj të cilave ishte ekspozuar kërkuesi në vitin 1992, në kohën kur iu dha azili, nuk ekzistonin më, apo se një autoritet publik do të ishte në gjendje ta mbronte atë në vendin e vet.*”⁷⁹ Kështu dëbimi i kërkuesit në raste të ngjashme, do të përbënte shkelje të Nenit 3 të KEDNJ.

Vendimi është i një interesi të veçantë për shumë arsye. Se pari, siç u vu re tashmë, arsyetimi në vendim duke u bazuar në Nenin 3, gjen zbatim njësoj dhe në bazë të Nenit 2⁸⁰. Nën këtë të fundit gjithashtu, *veprimtaritë e individit në fjalë, pavarësisht se sa të padëshirueshme apo të rrezikshëm të ishin, nuk mund të merren në shqyrtim nga pikëpamja materiale* për marrjen e vendimit nga ana e një Shteti për ta ekstraduar apo dëbuar atë person, ose mund të thuhet edhe për të marrë pjesë apo jo në të ashtuquajturin kthim prapa të personit. Nëse evidentohet, apo duhej të evidentohej, ekzistenca e një rreziku real se

⁷⁷ Vendimi *Ahmed*, paragrafi. 41.

⁷⁸ Po Aty, paragrafi 43.

⁷⁹ Po Aty, paragrafi 44.

⁸⁰ Çështja e *Said kundër Holandës*, vendimi i 5 korrikut 2005, në të cilën kërkuesi përfshiu në trajtim të dy nenet, ku Gjykata vendosi se “*ishte me e përshtatshme të trajtohej globalisht ankesa në bazë të Nenit 2, kur u shqyrtua ankesa në lidhje me këtë rast në bazë të Nenit 3*” (para. 37), dhe ku Gjykata u shpreh se, kur të konstatohej se dëbimi binte në kundërshtim me nenin e fundit, nuk do të lindte për trajtim “*asnjë çështje*” në bazë të nenit të parë të përmendur më sipër, paragrafi 56.

personi do të vritet në vendin pritës në mënyra apo rrethana që do të cenojnë Nenin 2 të Konventës, nëse vrasja do të ndodhë në një Shtet Palë të Konventës, personi nuk duhet të ekstradohet apo dëbohet.

Së dyti, çështja e bën të qartë se kjo gjë zbatohet edhe nëse kërcënimi për jetën vjen nga Shtetet që nuk janë palë e Konventës, kundrejt të cilëve autoritetet publike në atë vend realisht nuk mund dhe nuk do të mbrojnë viktimën e mundshme.

Dhe së treti, çështja pohon precedentin e mëparshëm në kuptimin që, nëse një çështje paraqitet përpara Gjykatës në Strasburg, me kërkues një person që njëkohësisht është dëbuar, ekzistenca e rrezikut duhet të shqyrtohet kryesisht duke iu referuar atyre fakteve për të cilat Shteti Kontraktues ishte në dijeni, apo duhet të kishte qenë në dijeni në kohën e dëbimit, por nëse kërkuesi nuk është dëbuar ende, koha materiale për të analizuar rrezikun në një çështje të caktuar, është koha kur Gjykatës i kërkohet të gjykojë atë.

Sa më sipër gjen zbatim edhe në lidhje me kërcënimet që lindin nga mungesa e trajtimit mjekësor në vendin pritës, sic duket qartë nga çështja e *D. kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Çështja kishte të bënte me një të ri nga St. Kitts (një ishull në Karaibe) i cili ishte arrestuar me të mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar, pasi posedonte një sasi të konsiderueshme droge. Ndërsa vuante dënimin në burg në Mbretërinë e Bashkuar, ai u diagnostikua se kishte SIDA. Ai mori mjekim duke i lehtësuar kështu gjendjen dhe duke e mbrojtur nga infeksione të mundshme. Me përfundimin e dënimit autoritetet britanike donin që D. të kthehej në St Kitts. Ai fillimisht u mbajt në masë ndalimi në një vendqëndrim emigrantësh pas lirimit nga burgu, në pritje të dëbimit, por u lirua me kusht pas raportit të Komisionit për çështjen dhe u lejua të banonte në një strehë që sigurohej nga një organizatë bamirësie që punonte për të pastrehët, si dhe për pacientët me SIDA.

Akomodimi, ushqimi dhe shërbimet u siguruan pa pagesë për kërkuesin, si dhe mbështetje psikologjike dhe asistencë nga një vullnetar i trajnuar, i siguar nga Terrence Higgins Trust, organizata kryesore bamirëse që merrej me HIV/ AIDS-in në Mbretërinë e Bashkuar. Kërkuesi theksoi se në St. Kitts ai do të ishte i pastrehë dhe pa ndonjë formë mbështetjeje morale, shoqërore apo familjare në fazat përfundimtare të sëmundjes së tij, i privuar nga trajtimi mjekësor dhe i ekspozuar ndaj infeksioneve, gjë që si Komisioni, edhe Gjykata e pranuan. Kjo situatë do të reduktonte më tej jetëgjatësinë e tij dhe do t'i shkaktonte atij dhimbje të rënda dhe vuajtje mendore. Gjykata u shpreh se duhej të tregohej elastike për të trajtuar zbatimin e Nenit 3 në kontekste të ndryshme. Kështu, shqyrtimi i një pretendimi të kërkuesit në bazë të Nenit 3 kryhet dhe nuk ndalohej kur burimi i rrezikut të trajtimit të paligjshëm në vendin pritës kufizohet nga faktorë që nuk mund të përfshijnë as drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tërthortë përgjegjësinë e autoriteteve publike të atij vendi, apo që, të marra më vete, nuk cenojnë në vetvete standardet e atij Neni. Kufizimi i zbatimit të Nenit 3 do të përbënte në vetvete dhe minimin e karakterit absolut të mbrojtjes së ofruar prej tij. Në cilindo kontekst të mare, gjithsesi, duhet që rrethanat e çështjes të analizohen me kujdes, veçanërisht duke marrë parasysh situatën personale të kërkuesit në Shtetin ku dëbohet.

Gjykata, në çështjen që përmendëm më lart, nxori përfundimet, pasi shqyrtoi me kujdes faktet e veçanta të çështjes dhe në veçanti gjendjen shëndetësore në kohën e shqyrtimit, në lidhje me Nenin 3. Dhe përse nuk mund të thuhet se kushtet me të cilat do të përballej ai në vendin pritës përbëjnë në vetvete shkelje të standardeve të Nenit 3, *zhvendosja e tij për në vendin e lindjes do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku real të vdekjes nën rrethana dëshpëruese dhe kështu, do të rezultonte në trajtim çnjerëzor.*

Pikërisht në rrethanat e veçanta të çështjes dhe duke pasur parasysh se ndihma humanitare e domosdoshme kishte rrezik që të mos ofrohej më, zhvendosja e D për në St Kitts do të përbënte shkelje të Nenit 3⁸¹.

Gjykata përsëri e lidhi pretendimin e kërkuesit që ishte bazuar nga ky i fundit në Nenin 2 me çështjet që trajtohen në bazë të Nenit 3. Të dy këto ne zbatim janë çështje “të pandashme” dhe kështu nuk është e nevojshme që ankesa e kërkuesit të shqyrtohet duke u bazuar vetëm në Nenin 2⁸².

Së fundmi, duhet vërejtur se masat e ndërmjetme janë të një rëndësie të veçantë në kontekstin e çështjeve të zhvendosjes nga juridiksioni i një Shteti Palë e Konventës në një vend të tretë, kur përbën ky transferim kërcënim për personat. Prandaj, në çështjen e *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë*⁸³, Qeveria e paditur nuk kishte përmbushur një kërkesë nga Gjykata, kërkesë për të mos ekstraduar kërkuesit në Uzbekistan, për shkak të përdorimit të torturës gjerësisht në atë vend⁸⁴.

Ajo (qeveria turke në atë kohë) pretendoi se detyrimet e saj në bazë të traktatit të ekstradimit me Uzbekistanin kishin përparësi ndaj detyrimeve të saj në bazë të Konventës. Ky pretendim, me të drejtë u hodh poshtë nga Gjykata, pasi ekstradimi kishte “reduktuar përgjithmonë” nivelin e mbrojtjes që mund të siguronte Gjykata.⁸⁵ Gjykata vijoi duke shqyrtuar faktin nëse veprimet e qeverisë turke kishin shkelur detyrimet e saj sipas Nenit 34 të Konventës “*për të mos penguar në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të së drejtës të*

⁸¹ *Vendimi D. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 54.

⁸² Po aty, paragrafi 59.

⁸³ *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe të 4 shkurtit 2005. Vëreni se vendimi i Dhomës në këtë çështje të 6 shkurtit 2003 përmendet si *Mamatkulov dhe Abdurasolovic*.

⁸⁴ Po Aty, paragrafët 24 – 27.

⁸⁵ Po Aty, vendimi, paragrafi 108.

Gjykatës për të marre dhe gjykuar në lidhje me kërkesat individuale’’. Në ndryshim të pozicionimit, përpara hyrjes në fuqi të Protokollit 11, mospërmbushja e masave të përkohshme nga një Shtet Kontraktues, kur haset një fakt i tillë, duhet konsideruar se e pengon shqyrtimin në mënyrë efektive nga ana e Gjykatës, të ankesës së kërkuarit dhe pengon ushtrimin efektiv të të drejtave të tij apo të saj, dhe përkatësisht, përbën shkelje të Nenit 34 të Konventës⁸⁶.

Turqia rrjedhimisht ka shkelur Nenin 34 në rastin në fjalë⁸⁷. Mjaft qartë Gjykata u shpreh edhe se kjo përbënte më shumë një shkelje të të drejtave të kërkuarëve, sesa thjesht një rast procedural, dhe se për këtë duhet dhënë një “shpërblim i drejtë”⁸⁸.

1.5.6.1. Çështja Rrapo kundër Shqipërisë si e vetmja çështje kundër Shqipërisë në kuadër të nenit 2 KEDNJ

Shtetasi A. Rrapo me shtetësi shqiptare dhe amerikane iu drejtua Gjykatës në 11 Tetor 2010, me një kërkesë Nr. 58555/ bazuar në nenin 34 të KEDNJ-së. Ankuesi pretendonte se kishte ndodhur një shkelje e Neneve 2, 3 dhe 34 të Konventës si rezultat i ekstradimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetasi Rrapo bëri kërkesë pranë

⁸⁶ Vendimi *Mamatkulov dhe Askarov*, paragrafi 128. Për pozicionin përpara Protokollit 11, shih për shembull, *Cruz Varas dhe të Tjerë kundër Suedisë*, vendimi i 20 marsit 1991, dhe vendimin mbi pranueshmërinë i 13 marsit 2001 në *Çonka dhe të Tjerë kundër Belgjikës*. Në adoptimin e përqasjes së re, Gjykata iu referua parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, dhe këndvështrimeve të shprehura që atëherë në lidhje me subjektin nga organe të tjera ndërkombëtare duke përfshirë Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, Komitetin për të Drejtat e Njeriut të krijuar nën Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Komisionin Ndër-Amerikan dhe Gjykatën e të Drejtave të Njeriut si dhe Komitetin kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara, edhe për faktin se ndërsa më parë e drejta për zbatim individual kishte qenë jo e detyrueshme, “*individët tani gëzojnë në nivel ndërkombëtar një të drejtë reale të ndërmarrjes së hapave për të vlerësuar të drejtat dhe liritë për të cilat ata kanë drejtpërdrejtë të drejtë në bazë të Konventës*”.

⁸⁷ Po Aty, paragrafi. 129.

⁸⁸ Po Aty, paragrafi. 135.

Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për të rinovuar pasaportën amerikane, kërkesë se cila e çojë në arrestimin e tij në të nesërmen. Kjo e fundit ma anë të shkresës Nr.55 kërkoj arrestimin e këtij shtetasi në mënyrë të parakohshme që të kishin mundësi ekstradimi drejt Amerikës. Sipas shënimit diplomatik, më 28 Maj 2010, nga një Gjykatë e Shteteve të Bashkuara ishte lëshuar një urdhër arresti për ankuesin⁸⁹.

Prokurori kërkoi konfirmimin e ndalimit paraprak të ankuesit me synim ekstradimin e tij drejt Shteteve të Bashkuara. dhe si Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit vendosën në favor të ekstradimit të ankuesit. Ankuesi pretendoi se bazuar mbi dokumentat e autoriteteve amerikane ekzistonte mundësia e dënimit me vdekje duke pretenduar që gjykatat nacionale kanë gabuar më marrjen e vendimit të ekstradimit. Gjykata nuk i kërkoj asnjë garanci shtetit amerikane që shtetasi Almir Rrapo nuk do të dënohej me vdekje. Ankuesi i konsumoj shkallët e gjyqësorit në nivel kombëtarë he iu drejtuar më një kërkesë GJEDNJ-së. GJEDNJ ka konstatuar se ekstradimi i ankuesit në SHBA nuk përbën shkelje të Neneve 2, 3 dhe 1 të Protokollit nr. 13 të Konventës në lidhje me rrezikun e vendosjes së dënimit me vdekje, kjo për faktin sepse ambasada e SHBA, me anë të një note diplomatike, u shpreh se “dënimi me vdekje nuk do të kërkohet ose vendoset kundër ankuesit kur të ekstradohej në SHBA”, ndër të tjera argumentoi se këto garanci të dhëna nga qeveria e SHBA ishin specifike, të qarta dhe jo ekuivoqe. GJEDNJ-ka ka vendosur se është shkelur

⁸⁹ Më 30 Gusht 2010, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme, shënimin diplomatik nr. 071, duke i kërkuar ekstradimin e ankuesit. Sipas shënimit diplomatik, ankuesi ishte akuzuar, së bashku me të pandehur të tjerë, me tetë akuzat e mëposhtme: 1) antarësi në një organizatë kriminale e përfshirë në vrasje, rrëmbim personi, shpërndarje droge, zjarrvënie të qëllimshme, vjedhje, grabitje dhe transportimi brenda përbrenda shtetit të mallrave të vjedhura; 2) komplot për të përfshirë në një organizatë kriminale; 3) komplot për të shpërndarë dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e 100 kilogramëve dhe më shumë marihuanë; 4) komplot për shpërndarjen dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e subsatncave të ndaluar; 5) komplotim për të bërë një grabitje; 6) zotërimin, përdorimin, mbajtjen dhe kërcënimin me armë zjarri.

neni 34 i Konventës sepse nga ana e autoriteteve vendase të masës së sigurimit, në mungesë të një justifikimi objektiv. Në dhënien e vendimit të rastit në fjalë Gjykata nuk pranon argumentet që jep qeveria shqiptare që do të cenonte detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, duke iu referuar Traktatit të Ekstradimit të vitit 1935,⁹⁰ nëse nuk do të realizonte ekstradimin. Dhe sipas Gjykatës mungonte baza ligjore për ekstradimin e ankuesit pas vendimit të Gjykatës së Lartë më 26 Nëntor 2010. Në këto rrethana, Gjykata del në përfundimin se mospërbushja e masës së përkohshme nga ana e autoriteteve vendase, në mungesë të një justifikimi objektiv, përbën dhunim të Nenit 34 të Konventës⁹¹.

⁹⁰ Shih ceshtjen *Al-Saadoon dhe Mufdhi*.

⁹¹ Shih nenin 34 të KEDNJ-së ku përcaktohet se “Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”.

KAPITULLI III: DETYRIMET POZITIVE PËR TË MBROJTUR JETËN SIPAS NENIT 2 KEDNJ. PËRPUTHSHMËRIA ME KUSHTET SUBSTANTIVE

3.1. Përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës

Për të përcaktuar shtrirjen dhe rendësin e detyrimeve të Shteteve, organet e kontrollit ndjekin rrugë të ndryshme por Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut i ka ndare detyrimet e Shteteve në :

- detyrime negative
- detyrime pozitive.

Detyrime negative i kërkojnë kryesisht Shteteve mos ndërhyrjen në ushtrimin e të drejtave dhe për këtë arsye janë konsideruar gjithmonë si të pandara nga instrumenti evropian. Në rastin e detyrimeve pozitive kërkohet e kundërta, pra ndërhyrja e shtetit në ushtrimin e të drejtave. Kryesisht gjatë dekadave të fundit, GJEDNJ-ja, nisur he nga dinamikat individuale të çështjeve të ndryshme ka mundur të zgjeroj numrin e detyrimeve pozitive. Përdorimi i nocionit “detyrime pozitive” i ka dhënë mundësi Gjykatës të përforcoje e, ndonjëherë, të zgjeroje kërkesat me karakter thelbësor të tekstit evropian si dhe t’ia bashkëngjisë detyrimeve me karakter procedural, të cilat janë të pavarura nga nenet 6 dhe 13, dhe u shtohen detyrimeve që parashikojnë këto nene⁹². Qëllimi është t’i garantoje personave gëzimin e efektshëm të drejtave të njohura. Sipas GJEDNJ-së detyrimet pozitive karakterizohen nga fakti që autoritetet vendase, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme

⁹² Shih nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

për mbrojtjen e një të drejte⁹³ ose më saktë, të miratojnë, me anë të legjislativit, masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave të individit⁹⁴. Këto masa mund të jenë më natyrë juridike⁹⁵, çka do të thotë që Shteti duhet që të miratojë sanksione ndaj individëve që shkelin Konventën, të vendosë një regjim juridik për një lloj aktiviteti ose për një kategori njerëzish. Zonjës Airey e cila kërkoji ndarje në gjykatë nga burri për shkak të dhunës fizike sistematike që ai ushtronte ndaj saj. Znj. Airey nuk kishte mundësi financiare që të bënte një ndarje me marrëveshje, për shkak se i mungonte ndihma ekonomike për të marrë një avokatë, për këtë arsye ajo kërkoj ndarje në gjykatë duke u vetë përfaqësuar. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur që, Znj. Airey i është shkelur e drejta për të marrë pjesë në gjykatë duke u shkelur të drejtat e saj civile të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së. Sipas Gjykatës mjetet juridike duhet të jene efektive dhe të zbatueshme për individët dhe konstatoj dhe shkelje në nenit 8⁹⁶ të KEDNJ-së. Mundësia e përfaqësimit nga ana e bashkëshortit në Gjykatë dhe jo edhe nga ana e saj është konsideruar si shkalje e nenit 8. Gjykata më tej përcaktohet e drejta për respektimin e jetës familjare mund të sjellë detyrime pozitive për krijimin e mekanizmave mbrojtës në lidhje me jetën familjare, në këtë rast, aftësinë efektive për të bërë një petition për ndarje gjyqësore⁹⁷. Po kështu duhet të merren masa në disa raste nga autoritetet e burgut për të parandaluar vetëvrasjen e një të burgosuri ose për të ndaluar që të burgosurit të kryejnë veprime në kundërshtim me instrumentin europian ndaj një të burgosuri tjetër. Të dy llojet e masave juridike e praktike mund të jenë të nevojshme në të njëjtën kohë. Kjo varet nga rrethanat.

⁹³ Vendimi *Hokkamen kundër Finlandës*, 24 gusht 1994.

⁹⁴ Vendimi te *Lopez-Ostra*, 9 dhjetor 1994.

⁹⁵ *Shën. Vgt Verein Gegen Tierfabriken kundër Zvicrës*, 28 shtator 2001. Gjykata përmend “detyrimin për të dekretuar një legjislacion të brendshëm”.

⁹⁶ Shih nenin 8 të KEDNJ.

⁹⁷ Vendimi *Airey kundër Irlandës*, 11 shtator 1979, paragrafi 26.

Duke pasur parasysh se detyrimet pozitive kanë për efekt, në të shumtën e rasteve, zgjerimin e detyrimeve që duhet të përmbushin Shtetet, çështja e bazës së tyre juridike është e një rëndësie të veçantë. Si rrjedhojë e parimit të përgjithshëm të dhënies së attributeve, për të cilin rezulton se Gjykata nuk ka kompetencë në mbrojtjen e disa të drejtave që nuk bazohen tek Konventa, gjykatësit europianë⁹⁸ janë përpjekur të lidhin çdo detyrim pozitiv me një klauzolë të Konventës. Nga ky këndvështrim, jurisprudenca është zhvilluar. Në fillim mund të dallonim nëse detyrimi në fjalë ka një karakter thelbësor ose procedural. Në rastin e parë, detyrimet pozitive duhet të rrjedhin nga vetë dispozita që formulon një të drejtë me karakter thelbësor. Sigurisht, ndodh me të vërtetë kështu nëse detyrimi në fjalë është i përcaktuar si i tillë në një dispozitë të caktuar. Kështu për shembull, neni 2, paragrafi i parë, fjalë e parë parashikon një ndërhyrje juridike pozitive nga ana e Shtetit, që duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e të drejtës për jetë (*“e drejta për jetë e çdo personi mbrohet me ligj”*). Këtij rasti i duhet shtuar pa dyshim situata që haset më shpesh kur, edhe pse ajo nuk është e qartë, një dispozitë e caktuar e Konventës do të interpretohet sikur imponon një detyrim pozitiv. Është pikërisht rasti i nenit 8, në të cilin gjykatësi europian arsyeton mbi faktin se ky nen përshkruan “respektimin” e jetës private, familjare, të vendbanimit dhe të korrespondencës⁹⁹.

Në një kuptim më të gjerë, do të ishte logjikisht kështu për të gjitha dispozitat e tjera të Konventës sa herë që do të kemi të bëjmë me një detyrim me karakter thelbësor, të pandarë nga norma e Konventës për të cilën duhet siguruar respektimi. Perspektiva për detyrimet pozitive procedurale dukej e ndryshme, më saktë për detyrimet që Gjykata kishte

⁹⁸ Për shembull, Vendimi *Johnston dhe të tjerë kundër Anglisë*, 27 shtator 1986.

⁹⁹ Jurisprudenca e GJEDNJ mbetet në këtë rast e pandryshueshme.

nxjerrë si interpretim përfundimtar logjik të neneve 2 (e drejta për jetë), nenit 3 (ndalimi i keqtrajtimeve), ose i nenit 4 (*ndalimi i skllavërisë, robërisë dhe punës së detyruar*).

Ashtu siç është përcaktuar në mënyrë të përsëritur në jurisprudencë, këto dispozita mund të vendosin detyrime të tilla¹⁰⁰ vetëm nëse kombinohen me nenin 1 të Konventës. Këto detyrime janë rrjedhojë e zbatimit të detyrës kryesore të Shteteve për “t’i njohur çdo individ që ndodhet nën juridiksionin e tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara” detyrë e cila kërkon nga Shtetet anëtare që të përgjigjen për të gjitha shkeljet e të drejtave dhe lirive të mbrojtura ndaj individëve që ndodhen nën juridiksionin e tyre, domethënë në kompetencat e tyre në momentin e shkeljes¹⁰¹. Kështu mund të flasim për një përgjithësim të teorisë së detyrimeve pozitive. Kjo teori mund të zbatohet, në anën e saj procedurale, për të gjitha dispozitat veçanërisht për të gjithë dispozitat normative të Konventës.

Vërejmë një tendencë të re në jurisprudencën e sotme sipas së cilës duhet që gjykatësi europian të bazohet, sistematikisht, *për detyrimet pozitive që precedenti i Gjykatës ka formuluar, qofshin këto procedurale apo dhe me karakter thelbësor*, në një kombinim të dispozitave normative të tekstit europian me nenin e tij të parë. Kështu, detyrimi për të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e lirisë së fjalës është nxjerrë nga neni 10 i kombinuar me këtë të fundit¹⁰², detyrimi për mbrojtjen e pronës është një kombinim gjithmonë i nenit 1 me nenin e parë të Protokollit 11¹⁰³. Duket qartë se ka një ndryshim drejtimi, i cili është i lidhur me rivlerësimin e ekonomisë së përgjithshme së Konventës, siç mund ta konstatojmë në disa vendime të fundit. Mund të përmendim

¹⁰⁰ Përsa i përket nenit 3 shih gjithashtu në çështjen *Assenov kundër Bullgarisë*, 28 tetor i 1998.

¹⁰¹ Shih Vendimin *Assanidzé kundër Gjeorgjisë*, 8 prill 2004.

¹⁰² Shih Vendimin për *Vgt Verein Gegen Tierfabriken kundër Zvicrës*, 28 shtator 2001.

¹⁰³ Duhet shënuar se, në të kundërt, detyrimi për t’u mbrojtur ndaj keqtrajtimeve vazhdon të bazohet vetëm në nenin 3 të KEDNJ. Shih Vendimin e *Farbuths kundër Letonisë*, 2 dhjetor 2004.

vendimet *Assanidzé kundër Gjeorgji*¹⁰⁴ dhe *Ilaşcu e të tjerë kundër Moldavisë dhe Rusisë*. Duke u nisur nga këto vendime, duket se neni i parë i Konventës, përbën, më tepër së kurrë, gurin themeltar të sistemit të Konventës deri në atë pikë sa ai bëhet për Shtetet një burim i pavarur detyrimesh të përgjithshme që janë gjithashtu detyrime pozitive. Kështu, në vendimin e *Assanidzé*, Gjykata vlerësoi se neni i parë implikon dhe kërkon vënien në veprim të një sistemi shtetëror të tillë që të garantojë sistemin e Konventës në të gjithë territorin që ai mbulon dhe për çdo individ. Në vendimin *Ilaşcu*, Gjykata ka vlerësuar se edhe në rastin kur një pjesë e territorit të një shteti, për shkak të ekzistencës së një regjimi separatist, del jashtë kontrollit dhe autoritetit të tij, ky Shtet vazhdon, kundrejt popullatës që jeton në territorin e saj, të marrë përsipër detyrimet pozitive që i ngarkon neni i parë. Ai duhet të marrë masat e nevojshme, nga njëra anë për të vendosur kontrollin e tij në këtë hapësirë, e nga ana tjetër për të mbrojtur personat që ndodhen në të. Këto detyrime të përgjithshme mund t'i quajmë pothuajse të pavarura. Ato janë të pavarura duke pasur parasysh se ato bëhen të detyrueshme vetëm në bazë të nenit të parë të Konventës. Megjithatë, ato nuk janë plotësisht të pavarura sepse kontrolli i respektimit të tyre bëhet vetëm në rastin e një kërkesë që i referohet shkeljes së njëres nga të drejtat më karakter thelbësor që njihen nga teksti evropian. Ata paraqiten kështu të lidhura me një kontekst përderisa ato duhet të vlerësohen detyrimisht nën prizmin e një norme të veçantë¹⁰⁵. Pra, nga ky këndvështrim, neni i parë duhet të lidhet sistematikisht me dispozitat normative. Duhet përmendur një tendencë edhe më e re e jurisprudencës që nuk është veçse nxjerrja e detyrimeve pozitive nga kombinimi i dispozitave normative me parimin e përgjithshëm të

¹⁰⁴ Vendimi i 8 prillit 2004.

¹⁰⁵ Shih mënyrën e të shprthurit të Gjykatës në rastin e vendimit të Broniowski, e lartpërmendur.

“përparësisë të së drejtës” ose “Shtetit të së drejtës” të cilin Gjykata e konsideron si një nga “parimet themelore të një shoqërie demokratike dhe si të pandarë nga të gjitha nenet e Konventës¹⁰⁶. Duke pasur parasysh pohimin i mësipërm se parimi në fjalë është i pandarë nga nenet e Konventës, veçanërisht për detyrimet me karakter procedural, mund të shtrojmë pyetjen se a nuk po shkojmë drejt një autonomie të çdo dispozite për sa i përket kushteve të garantimit të tyre të brendshëm?

Detyrimet pozitive, pavarësisht nga fakti se mund të bazohen në një dispozitë normative të veçantë, në një interpretim të kësaj dispozite *nën hijen* e nenit të parë të Konventës apo në parime të përgjithshme të së drejtës europiane, ato ndjekin të gjitha të njëjtin qëllim, zbatimin me efektshmëri të instrumentit europian dhe efektshmërinë e të drejtave që ky i fundit përcakton. Vendimi *Airey* 24 mbetet edhe sot një ilustrim i përsosur i këtij pohimi. Paditësja e cila kërkonte të arrinte *séparation de corps*, kishte zgjedhur për këtë rrugën gjyqësore në bazë të ligjit irlandez. Për shkak të gjendjes së saj ekonomike, të ardhurave të saj të pakta dhe faktit se Irlanda nuk e njihte, në atë kohë, sistemin e ndihmës në fushën e juridiksionit, paditëses iu desh të hiqte dorë nga kjo kërkesë. Në fakt, duke pasur parasysh procedurën e ndërlikuar, ajo gjykoi se nuk mund të mbrohej pa asistencën e një këshille juridike. Ajo parashtronte përpara Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut veçanërisht se Shteti kishte shkelur nenin 6, paragrafi i parë, duke mos i vënë në dispozicion një ndihmë efektive. Juridiksioni europian i pranoi më në fund ankesat e saj. Megjithatë, e rëndësishme për këtë rast është të vihen në pah vlerësimet mbi bazën e të cilave vendosi Gjykata. Ajo theksoi fillimisht me anë të një formule që u bë e famshme, se

¹⁰⁶ *Matheus kundër Francës*, 31 maj 2005, në veçanti fq. 70, dhe për mënyrën e veprimit, shih vendimin Broniowski të lartpërmendur.

Konventa ka për qëllim të mbrojë të drejta konkrete dhe efektive dhe jo teorike. Nuk mjafton vetëm të ekzistojë vetëm parashikimi i procesit gjyqësor, por duhet që ai të mund të realizohet në mënyrë të dobishme. Sipas Gjykatës, kjo gjë kërkon që t'i njihet individit që gjykohet, një e drejtë ekonomike dhe sociale, në këtë rast, e drejta për ndihmë juridike falas sepse, nëse KEDNJ formulon kryesisht disa të drejta civile dhe politike, një pjesë e tyre shtrihet edhe në fushën sociale ose ekonomike". Për rrjedhojë, nuk mund të ketë "asnjë ndarje" midis sferës të së drejtave ekonomike dhe sociale dhe fushës së veprimit të Konventës.

Ky veprim i detyrimeve pozitive paraqitet me një stabilitet të veçantë. Gjykata nuk rresht së nënvizuari këtë gjë në vendimet e saj¹⁰⁷. Si rezultat, detyrimet pozitive kanë kryesisht tendencë për të siguruar kushtet materiale dhe juridike konkrete për gëzimin e të drejtave që mbron Konventa. Por, një pyetje që me të drejtë ngrihet është, se a përjashtojnë njëra-tjetrën detyrimet pozitive dhe negative?

Nga vetë konceptimi i tyre, detyrimet pozitive u bashkëngjiten detyrimeve negative. Por a mund të themi se vetëm këto të dyja mbulojnë tërësinë e fushës së veprimit të Konventës? Përgjigjja do të ishte negative nëse do t'i referoheshim vendimit *Pla dhe Puncernau kundër Andora*¹⁰⁸. Në fakt, ky vendim të bën të mendosh se mund të kishte edhe një rrugë të tretë. Objekti i kësaj çështjeje ishte përgjegjësia e Shtetit të Andorës në lidhje me nenin 8 për sa i përket interpretimit të juridiksionit ku u gjykua se e drejta e aplikuar nga juridiksioni vendas ishte, në të gjitha pikat, në përputhje me kërkesat e këtij neni. Për

¹⁰⁷ Për shembuj të kohëve të fundit, shih Yneryildiz, 18 qershor 2002, si dhe *Ouranio dhe të tjerët kundër Greqisë*, 20 i tetorit 2005.

¹⁰⁸ Vendim i 27 korrikut 2004.

Gjykatën, nuk do të ishte e mundur të qortoheshin autoritetet e Andorës për ndonjë ndërhyrje në jetën private e familjare të paditësve apo për mosrespektim të mundshëm të detyrimeve pozitive nga ana e Shtetit të Andorës për ta bërë më të efektshëm respektimin e jetës familjare. Paditësit, vazhdon ajo, vetëm kundërshtojnë një vendim gjyqësor. Zgjidhja është e çuditshme, megjithëse ajo duhet të lidhet me rëndësinë që i jep Gjykata pavarësisë së gjyqësorit (parim i përcaktuar në nenin 6 të Konventës). Sidoqoftë, ajo duket se përbën një tip të përgjithshëm shkeljeje të Konventës që nuk do të analizohej me mosnjohje të njëjës prej formave të detyrimeve të njohura. Sidoqoftë, kjo analizë nuk është bindëse. Çdo shkelje e Konventës mund të rezultojë vetëm nga mosrespektimi nga ana e Shtetit i një detyrimi të marrë përsipër prej tij i cili mund të jetë vetëm pozitiv ose negativ. Duke u rikthyer, pra, tek kjo dyanshmëri thelbësore, shtrohet pyetja se si pozicionohet një element në krahasim me tjetrin. Duke pasur si pikënisje jurisprudencën, mund të ngremë dy propozime: a) të dy llojet e detyrimeve janë të ndryshme për nga natyra, a) megjithatë ato bashkohen ndonjëherë për sa i përket implikimit të tyre.

Gjithsesi, këto detyrime janë të ndryshme për nga natyra. Mund të shtrojmë pyetjen mbi fajësinë e Shtetit. Nëse nuk kemi një të tillë, është e pakuptueshme përgjegjësia në bazë të të drejtës ndërkombëtare të Shtetit. Është e qartë se në këtë çështje, dënimi i Shteti u bazua mbi faktin se shkelja ishte kryer nga një prej organeve të tij. Nga ky moment, Gjykata mund ta kishte vlerësuar këtë shkelje sipas paragrafit 2 të nenit 8, pa mohuar pavarësinë e gjykatësve. Këtu kemi të bëjmë me efektin e kundërt, atë të shtrirjes së teorisë së detyrimeve pozitive në marrëdhëniet midis organeve të shtetit dhe individëve, vetëm nëse konsiderojmë se dallimin detyrim pozitiv/negativ do ta gjejmë përsëri në hipotezën sipas së cilës shkelja e Konventës vjen si pasojë e abstenimit të gjykatësit, madje dhe e

mohimit të drejtësisë ose të një akti gjyqësor. Ajo që i dallon detyrimet pozitive nga ato negative është se të parat kërkojnë një ndërhyrje pozitive nga Shteti ndërsa të dytat kërkojnë që ai të mos ndërhyjë. Shkelja e Konventës në rastin e parë do të rezultonte nga mosveprimi i autoriteteve vendase, nga qëndrimi pasiv i tyre, dhe, në rastin e dytë, nga fakti se ato kanë penguar ose kufizuar ushtrimin e të drejtës me anë të një akti pozitiv.

Në praktikë, ky ndryshim është ndonjëherë i qartë. Këtë mund ta ilustrojmë në këtë mënyrë. Të supozojmë se Zoti X. ka marrë pjesë në një grumbullim të paautorizuar në rrugë dhe aty gjen vdekjen. Të supozojmë se vdekja i erdhi si rezultat i goditjeve e plagëve të shkaktuara nga policët e ngarkuar për të shpërndarë manifestuesit. Çështja e respektimit të Konventës do të lidhet me fushën e nenit 11 (*liria e mbledhjes*) ose me atë të nenit 2 (*e drejta për jetë*) duke pasur parasysh respektimin e detyrimit të mosndërhyrjes në ushtrimin e këtyre të drejtave. Shteti do të ngarkohet me përgjegjësi për vdekjen e individit për arsye të një akti pozitiv sepse ai ndërhyri nëpërmjet agjentëve të tij (*në mënyrë jo proporcionale*) aty ku Konventa i kërkon të mos veprojë. Të supozojmë se Zoti X. është rrahur për vdekje nga disa anti-manifestues dhe kjo përpara forcave policore të cilët kanë qëndruar pasiv. Nëse do të pranojmë se neni 2 dhe 11 vendosin vetëm detyrime negative, nuk do kishte në asnjë rast shkelje të Konventës pasi policët nuk ndërhyjnë. Në të kundërt, nëse Konventa përcakton si detyrë, në përputhje me jurisprudencën, mbrojtjen e jetës së Zotit X. me anë të një ndërhyrje pozitive, pasiviteti i policëve do ta bënte Shtetin përgjegjës. Për të ritheksuar thëniet e Gjykatës, nëse të afërmit e viktimës do të protestonin kundër vdekjes së Zotit X., “nuk do të ankoreshin ndaj një akti por ndaj mosveprimit të Shtetit”¹⁰⁹.

¹⁰⁹ Vendimi *Gaskin kundër Anglisë*, 23 qershor 1989, fq.41.

Megjithatë, ka situata ku ky ndryshim nuk del vetvetiu, ku kufiri midis detyrimeve pozitive dhe negative shuhet ndjeshëm megjithëse nuk zhduket asnjëherë plotësisht.

3.2. Mbrojtja e jetës dhe integritetit të personave

Disa nga të drejtat themelore, të cilat shërbejnë si një terren i privilegjuar për zhvillimin e detyrimeve pozitive, janë e drejta për jetë, e drejta për integritet të personave është sigurisht si dhe e drejta për jetë private dhe familjare. Nëse e drejta për jetë është objekt i një neni të përcaktuar në nenin 2 të Konventës, e drejta për integritet është pjesë e dispozitave të ndryshme. Neni 3 mbron ndaj torturave, keqtrajttimeve apo mundimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Në këtë fushe, ajo është dispozita kryesore. Megjithatë, nuk duhet lënë pas dore neni 4. Ky nen ndalon skllavërinë, robërinë dhe punën e detyruar të cilat janë një formë e veçantë e cenimit të integritetit të individit. Duhet të përmendim edhe nenin 8 i cili, megjithëse mbron të drejtën për jetë private dhe familjare, është interpretuar nga Gjykata, veçanërisht në dimensionin “jetë private”, si një nen që mbron ndaj disa formave të cenimit të së drejtës për integritet fizik, si për shembull përdhunimi. Këto tre nene përbëjnë për Shtetet anëtare bazën e detyrimeve pozitive, me karakter thelbësor dhe me karakter procedural.

3.2.1. Detyrimet me karakter thelbësor

Përgjegjësia lidhur me të drejtën për të jetuar nuk kufizohet vetëm në këto detyrime negative. E drejta për të jetuar krijon gjithashtu edhe detyrime pozitive për Shtetin. Paragrafi i i nenit 2 përcakton se “*e drejta e çdo individi për jetë mbrohet me ligj*” duke detyruar Shtetin jo vetëm të mos provokojë me dashje dhe në mënyrë të paligjshme vdekjen

e individëve, por edhe të marrë masat e duhura për mbrojtjen e jetës së individëve që ndodhen nën juridiksionin e tij. Në çështjen *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar Gjykata* arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 2, sepse nuk u arrit të krijohet asnjë lidhje shkakësore midis ekspozimit të babai, i cili shërbente në ushtri gjatë testeve bërthamore, midis vuajtjes së një fëmije të pa konceptuar ende¹¹⁰.

Në veçanti, duhet të ndërmerren hapat e duhur për të siguruar jetën e personave që jetojnë në territorin e një shteti, brenda juridiksionit të tij.¹¹¹ Kjo mund të përfshijë parashikimin e një dispozite që jep informacion të një rreziku potencial për jetën, që mund të shkaktohet nga veprime të Shtetit¹¹², ky detyrim mund të shtrihet edhe për të dekurajuar individët që venë në rrezik shëndetin e tyre¹¹³.

Ky urdhërim përfshin detyrimin që Shteti të sigurojë një regjim administrativ që mbron jetën në mënyrë efektive. Shteti ka për detyrë të sigurojë një kuadër ligjor dhe administrativ të përshtatshëm që përcakton rrethanat e kufizuara në të cilat agjentë të Shtetit mund të përdorin forcën vdekjeprurëse, përfshirë edhe përdorimin e armëve të zjarrit,¹¹⁴ operacionet e arrestimit, teknika të kufizimit të veprimtarisë së agjentëve shtetërorë, etj. Një çështje e përsëritur në Gjykatë është ajo e përdorimit të armëve të zjarrit nga zyrtarët e Shtetit¹¹⁵. Për shembull, Gjykata gjeti shkelje në një rast, për shkak të një kuadri ligjor të papërshtatshëm, që kishte të bënte me vrasjen e një rekruti ndërsa ishte duke u përpjekur t'i shpëtonte shërbimit ushtarak¹¹⁶.

¹¹⁰ Vendimi *LCB kundër Anglisë* i 9 qershorit 1998, paragrafi 36.

¹¹¹ Po Aty.

¹¹² Po aty.

¹¹³ Shih vendimin *Barret v UK; Onerylidiz v Turqisë*.

¹¹⁴ Shih çështjen *Giuliani dhe Gaggio v Italisë*.

¹¹⁵ Shih p.sh., *Atiman v Turqisë*.

¹¹⁶ Shih çështjen *Putintseva v Rusisë*.

Shteti duhet të bëjë trajnime dhe të jap udhëzim të përshtatshëm të agjentëve të shtetit lidhur me përdorimin e forcës, dhe konceptet e duhura në lidhje me të drejtën për të jetuar, duke përfshirë konceptet si 'nevojë absolute', proporcionalitet, dhe epërsia e të drejtës së jetës si një e drejtë themelore. Në çështjen *Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë* Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së sepse policia besonte në mirëbesim, duke marrë parasysh informatat dhe udhëzimet që kishte marrë, se personat ishin të armatosur dhe më rrezikshmëri të lartë. Në përputhje me udhëzimet e eprorëve të tyre, policia për këtë arsye ka përdorur forcë vdekjeprurëse duke e vlerësuar si absolutisht e nevojshme¹¹⁷.

Shteti duhet të krijojë sisteme të përshtatshme të punës dhe me punonjës mjaft të aftë për të mbrojtur jetën, p.sh. në spitale. Spitalet duhet të marrin masa për mbrojtjen e jetës së pacientëve,¹¹⁸ të mos mohojnë vënien në dispozicion të kujdesit shëndetësor (t'ju sigurojnë kujdes shëndetësor),¹¹⁹ dhe duhet t'u sigurojnë ilaçet e duhura (e përshtatshme)¹²⁰.

Gjykata gjeti shkelje të Nenit 2 në çështjen *Bilbija dhe Blažević kundër Kroacisë*, ku në 13 shkurt 2001 nëna e ankuesve vdiq për shkak të disa problemeve me frymëmarrjen në spital publik. Nga autopsia rezultoi se shkak i vdekjes ishte pamjaftueshmëria e frymëmarrjes që çon në komplikacione kardiake¹²¹. Ankuesi pretendoi se shteti duhet të siguronte jetën e nënës së saj duke krijuar spitale me të sigurta e duke përgatitur stafin mjekësor në mënyrën e duhur. Po kështu në çështjen *Lopes De Sousa Fernandes kundër*

¹¹⁷ Shih çështjen *Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë*.

¹¹⁸ Shih çështjen *Vo v Francës*.

¹¹⁹ Shih çështjen *Qipro v Turqisë*.

¹²⁰ Shih çështjen *Panaitecu v Rumanisë*.

¹²¹ Shih çështjen *Bilbija dhe Blažević kundër Kroacisë*.

Portugalisë¹²², ku ankuesja pretendoi se bashkëshorti i saj kishte humbur jetën nga neglizhenca mjekësore Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së në aspektin substancial sepse burri i aplikuesit ishte privuar nga mundësia për të pasur kujdesin e duhur emergjente dhe kjo ishte e mjaftueshme për të përcaktuar se shteti ka dështuar në detyrën e tij për të mbrojtur integritetin fizik të pacientit.

Keqfunksionimi flagrant i departamenteve të spitalit, që solli mungesën e kujdesit mjekësor urgjent, kur shkatohet vdekja, përbën shkelje¹²³. Fusha të tjera ku ky detyrim mund të jetë i dobishëm për t'u zbatuar përfshin ndërtimin e faqeve anësore, sigurinë rrugore, dhe shkollat. (Manual SLYNN, 2016:99) Veç kësaj, Shteti duhet të garantojë ekzistencën e një sistemi gjyqësor që¹²⁴ heton me iniciativën e tij rastet e vdekjeve, aty ku ka ndonjë provë që janë përfshirë palë të treta, edhe pse nuk është vënë në diskutim kryerja e ndonjë shkelje nga agjentët e Shtetit¹²⁵, që ka aftësinë të vërtetojë faktet dhe shkakun e vdekjes, të verë përpara përgjegjësisë ata që janë në faj, dhe t'i sigurojë viktimës dëmshpërblim të përshtatshëm dhe që mund të përcaktojë përgjegjësinë civile për vdekjet, përfshirë edhe rastet që nuk kanë të bëjnë me fajësinë e Shtetit, p.sh. vdekjet e shkaktuara nga neglizhenca mjekësore apo nga aksidentet rrugore. Më tej, detyrimi pozitiv ndaj të drejtës për të jetuar kërkon që ligji, në mënyrë të përshtatshme, të ndalojë dhe të dënojë vrasjet, dhe vrasja e paligjshme duhet t'i nënshtrohet sanksioneve penale, pavarësisht se kush i kryen vrasjet. Ky është rasti edhe kur një zyrtar i Shtetit është përgjegjës për marrjen e jetës, kur përdorimi i forcës vdekjeprurëse nuk mund të justifikohet dhe nuk ka qenë

¹²² Shih çështjen *Lopes De Sousa Fernandes kundër Portugalisë*.

¹²³ Shih çështjen *Mehmet Şentürk dhe Bekir Şentürk v Turqisë*.

¹²⁴ Shih çështjet *Ciechonska v Polonisë*; *Railean v Moldavisë*; *Dodov v Bullgarisë*.

¹²⁵ Shih çështjen *Rantsev v Qipros*.

absolutisht i domosdoshëm. Të gjitha vdekjet duhet të hetohen në mënyrë të përshtatshme, dhe ligji duhet të zbatohet në mënyrë të efektshme. Kjo kryhet më mirë nga një gjykim penal: siç është përcaktuar nga Gjykata ‘në rrjedhën normale të ngjarjeve, një gjykim penal, me një procedurë kontradiktore përpara një gjykatësi të pavarur dhe të paanshëm, konsiderohet se jep garanci më të forta për një procedurë efektive për gjetjen e fakteve dhe përcaktimin e fajtorit’¹²⁶.

3.2.2. Mbrojtja e jetës me ligj

Në nenin 2 të KEDNJ-së përcaktohet se “*jeta e çdo kujt do të mbrohet me ligj*”, dhe në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se ‘*çdo përdorim i forcës vdekjeprurëse duhet të jetë absolutisht i domosdoshëm*’. Ai vijon se ligji në një Shtet Palë i Konventës duhet të mbrojë individin nga cenimi i jetës së tij, përveç kur kjo e fundit është “*absolutisht e domosdoshme*”. Por pjesa më e madhe e legjislacioneve nuk e ka të përcaktuar qartë në legjislacionet e tyre të brendshme kuptimin e termit “*absolutisht e domosdoshme*”. Kështu përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga ushtarët e SAS në çështjen e McCann Gjykata konstatoi se në legjislacionin e brendshëm anglez mungonte kuadri ligjor i brendshëm për përdorimin e forcës vdekjeprurëse, dhe në këto kushte, falë kësaj mungese mund të konsiderohej që kishte shkelje të nenin 2 të Konventës.

Në çështjen e Matzarakis kundër Greqisë¹²⁷, Gjykata analizoi kualifikimin e udhëzimeve të dhëna për zbatuesit e ligjit në këtë kontekst. Çështja konsistonte në ndjekjen e kryer nga policia, të një makine, pasi ishte konstatuar shkelje të rregullave të qarkullimit

¹²⁶ Shih çështjen *Gurtekin v Qipros e cituar*.

¹²⁷ Vendimi i 20 dhjetorit 2004 i Dhomës së Madhe në çështjen *Matzarakis kundër Greqisë*.

rrugor. Policia gjatë operacionit hapi zjarr me shumë të shtëna në drejtim të automjetit dhe plagosi rëndë (por nuk e vrau) z. Matzarakis. Në këtë rast Gjykata konstatoi zhvillimin e parregullt dhe jo brenda standarteve të pranueshëm të operacionit policor, duke e konsideruar kaotike mënyrën me të cilën u përdorën aktualisht armët e zjarrit nga policia në këtë çështje.

Gjatë kësaj kohe përdorimi i armëve të zjarrit në Greqi rregullohej nga një ligj i vjetër dhe i paplotë i Luftës së Dytë Botërore, i cili rendiste një gamë të gjerë situatash në të cilat një oficer policie mund të përdorte armët e zjarrit pa qenë përgjegjës për pasojat. Gjatë vlerësimit të kuadri ligjor të kësaj çështjeje Gjykata u shpreh se aktet e parregullta dhe arbitrare të kryera nga punonjësit e shtetit janë në mospërputhje në lidhje me respektimin efektiv të të drejtave të njeriut dhe oficerët e policisë nuk duhet të lihen në një vakum kur ushtrojnë detyrat e tyre, qoftë në kontekstin e një operacioni të përgatitur, apo një ndjekjeje spontane të një personi që mendohet se është i rrezikshëm. Duhet donosdoshmërisht ekzistenca dhe zbatimi i një kuadri ligjor që të përcaktojë rrethanat e posaçme në të cilat oficerët e ruajtjes dhe zbatimit të rendit mund të lejohen të përdorin forcën dhe armët e zjarrit duke respektuar me rigorozitet standartet ndërkombëtare që janë zhvilluar në këtë kuadër¹²⁸. Sistemi ekzistues nuk parashikonte udhëzues dhe kritere të qarta për punonjësit e

¹²⁸ Vendimi i Dhomes së Madhe tek *Matzarakis*, paragrafët 58-59, duke iu referuar çështjes *Hilda Hafsteinsdottir kundër Islandës*, të 8 qershorit 2004 ndaj Komentit të Përgjithshëm Nr.6 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut ICCPR, dhe “Parimeve për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit” të Kombeve të Bashkuara (titulli i plotë: Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Punonjësit e Ruajtjes së Rendit, miratuar më 7 shtator 1990 nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të Ligjit). *Hafsteinsdottir* është një çështje sipas Nenit 5 që theksoi fortë nevojën për mbrojtjen kundrejt kompetencave të përdorura në mënyrë arbitrare nga policia në lidhje me arrestimet. Referenca e Gjykatës për atë çështje bën të qartë se po ajo nevojë lind në bazë të Nenit 2 kundrejt përdorimit arbitrar të armëve të zjarrit nga ana e policisë. Këto dy referenca të fundit përsëri theksojnë vullnetin gjithnjë e më të madh të Gjykatës për të zbatuar Konventën në të njëjtën linjë me standartet e gjera ndërkombëtare.

policisë për përdorimin e forcës në kohë paqeje. Kështu, ishte e pashmangshme që oficerët e policisë që po kryenin ndjekjen dhe që në vijim arrestuan kërkuesin, gëzonin një autonomi më të gjerë veprimi dhe ishin në gjendje të ndërmerrenin iniciativa të pakujdesshme, iniciativa që ndoshta nuk do ti kishin ndërmarrë nëse do të kishin përfituar nga një kualifikim dhe udhëzim i duhur¹²⁹. Gjykata në vendimin e saj qartëson se mangësitë e thella në kuadrin rregullator dhe mungesa e “kualifikimit dhe udhëzimeve të duhura” në përdorimin e armëve të zjarrit nga policia mund që edhe në vetvete të përbëjnë shkelje të detyrimeve në bazë të Nenit 2 të Konventës për të mbrojtur të drejtën për jetën “me ligj”. Në çështjen Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë u konstatua ekzistenca e legjislacionit ku parashikohej se nëse sulmi i përdoru ka pasur si qëllim shpatsien e një sulm të paligjshëm kundër tyre atëherë ose është në proporcion me sulmin nuk do të dënohet për tij akt. Pra legjislacioni i brendshëm autorizonte policinë për të përdorur armët e zjarrit gjatë kryerjes së detyrave të tyre, sipas rasteve të parashikuara nga ligji kombëtar për këtë qëllim, por gjithsesi qeveria në këtë çështje është shprehur në lidhje me përdorimin e armëve se përpara së të realizohet sulmi duhet që nga ana e autoriteteve policore të qëllohet në shenj paralajmëruese tre herë në ajër, ose duhet të qëllojnë nga përpara këmbëve të individëve me qëllim zbrapjen e tyre dhe në rastin e tretë dhe përdorimi i armëve të zjarrit do të lejohet vetëm në qoftë se nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të kontrolluar situatën.

¹²⁹ Vendimi i Dhomës së Madhe tek *Matzarakis*, paragrafi 70, hiqen referenca të ndërsjella me paragrafët e mëparshëm.

3.2.3. Mbrojtja që imponohet në kuadrin e veprimeve të organeve shtetërore

Në parim, nëse një person vritet nga agjentët e Shtetit veçanërisht gjatë një operacioni të policisë ose të forcave të sigurisë, Shteti është përgjegjës për moskryerjen e detyrimit të tij për mos cenim të kësaj të drejte. Këtij detyrimi negativ, jurisprudenca i shtoi një detyrim pozitiv që kishte të bënte kryesisht me inkuadrimin e veprimeve të këtij lloji. Duhet shënuar se ky detyrim nuk mund të konceptohet i vetëm, por ai ndërhyr në kuadrin e një kontrolli të domosdoshëm që duhet të ushtrojë gjykatësi në rrethana të veçanta. Pikësëpari Shteti duhet të parashikojë me anë të rregullatorit ligjor rendin e tij të brendshëm juridik në mënyrë që të përcaktojë me saktësi veprimtarinë operationale, dhe jo vetëm, të forcave të rendit dhe të mundësojë kontrollin e tyre të efektshëm (Ridola, P., 2007:133).

Kështu në çështjen Treskavica kundër Kroacisë Gjykata nuk gjeti shkelje në nenit 2 TË Konventës. Gjatë 1991 dhe 1992 forcat paraushtarake serbe morën kontrollin e rreth 1/3 të territorit të Kroacisë dhe e shpallën "Rajon Autonom Serb të Krajinës". Në fillim të gushtit të vitit 1995, autoritetet kroate njoftuan ndërmarrjen e veprimeve ushtarake me qëllim të rimarrjes e kontrollit të kësaj zone. Operacioni i organizuar është koduar si "Stuhia" dhe përfshiu periudhën nga 4 deri në 7 gusht 1995, por përpara ndërmarrjes së këtyre veprimeve ushtarake, pjesa më e madhe e popullsisë së Krajina u larguan nga Kroacia. Ankuesit jetonin në Knin, i cili ndodhej brenda territorit të Krajinës. Gjatë Operacionit Stuhia qyteti i Kninit është sulmuar nga ushtria kroate aplikantët janë fshehur në bodrumin e shtëpisë së tyre ndërsa shtetasi J.T. është gjetur i vdekur në afërsi të një pike karburanti në Knin, pas këtyre sulmeve. Gjatë procesit të zhvarrosjes së trupave ankuesja kërkoji në polici zhvarrosjen e trupit të bashkëshortit të saj duke kërkuar ekzaminimin e trupit të tij. Nga ekspertiza mjeko-ligjore u konstatua se shtetasi J.T nuk ishte vrarë nga

ndonjë predhë siç pretendonte ankuesja por shkak i vdekjes se tij ka qenë goditja me armë zjarri në qafë.

Në vitin 2007 prokuroria autorizoi hapjen e hetimeve për ngjarjen e ndodhur në bazë të pretendimeve që ankuesja kishte se bashkëshorti i saj ishte vrarë nga ushtria kroate sepse i përkiste pakicës etnike serbe. Më 19 shkurt 2008 Departamenti i Policisë Kriminale intervistoi shtetasin I.M., një fqinj i familjes Treskavica i cila deklaroi se J.T nuk kishte qenë anëtar i ushtrisë apo policisë të Republikës së Krajinës Serbe dhe se ajo kurrë nuk e kishte parë atë të veshur me një uniformë ushtarake. Në 26 shkurt 2007, ankuesit paraqitën pranë zyrave të prokurorit të shtetit kërkesën për dëmshpërblim, e cila u refuzua. Refuzimi i kërkesës bëri që ankuesit t'i drejtoheshin Gjykatës Komunale Knin duke kërkuar dëmshpërblim në lidhje me vdekjen e J.T. Në 17 dhjetor 2008, Gjykata Komunale hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin se nuk kishte "asnjë provë se vdekja JT kishte qenë rezultat i terrorit apo dhunës për qëllim të rendit publik, vendim i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë. Ligji për përgjegjësinë nga ana e shtetit për dëmet që rrjedhin nga aktet terroriste dhe demonstratat publike hyri në fuqi më 31 korrik të vitit 2003 dhe për rrjedhojë nuk mund të mbahej përgjegjësi në rastin në fjalë. Gjykata theksoi se nga ana e Qeverisë ishin bërë njoftimet e duhura që gjatë ditëve në të cilën ndodhi ngjarja, do të kishte sulme në zonë. Në çështjen Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë ku Reshat Çiçek, u vra gjatë një operacioni ushtarak nisur nga njësia e operacioneve speciale të Xhandarmërisë Juksekova, Gjykata vendosi unanimisht se ka pasur një shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural të pretenduar nga palët ankuese. Nga autopsia rezultoi se Resat Çiçek u godit nga plumbat e pushkëve në kokë, gjoks dhe bark, dhe predha kishte arritur organet vitale veç e veç: të trurit, zemra, mushkëritë dhe të mëlçisë. Autopsia zbuloi gjithashtu praninë e

tre plagë nga plumbat e kalibrit apo eksplozive breshëri, pesë prej të cilave kanë pasur ndikime të veçanta dhe menjëherë fatale. Ankuesit akuzuan forcat e sigurisë për vrasjen e të dashurit të tyre. Në këtë çështje Qeveria argumentoi se në bazë të legjislacionit të brendshëm, legjitimohej përdorimi i sulmit me qëllim zbrapsien e një sulm të paligjshëm kundër tyre dhe nëse është në zbrapsia është në proporcion me sulmin nuk do të dënohet për këtë akt.

Pra në bazë të kësaj ligji, policia autorizohet që të përdorte armët e zjarrit gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Por pavarësisht kësaj Qeveria nuk arriti të vërtetonte që përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga policia ishte absolutisht e nevojshme, pavarësisht se nga ana e policisë u konsiderua si i tillë. Për Gjykatën, *mungesa e një kuadrit ligjor dhe mos përcaktimi i rregullave të qarta në lidhje me lirinë e veprimit deri në arbitraritet të agjentëve të Shtetit nuk janë në përputhje me parimin e respektimit të efektshëm të të drejtave të njeriut si ato mbrohet nga Konventa.*

Kjo do të nënkuptonte më vonë, se operacionet e forcave policore, përveçse duhet të jenë të autorizuar nga e drejta vendase, duhet të jenë të përcaktuara qartë nga kjo e drejtë në kuadrin e një sistemi garantues adekuat dhe të efektshëm, që ofron mbrojtje ndaj arbitraritetit dhe abuzimit me forcën e mekanizmave shtetërorë, madje edhe ndaj aksidenteve të paevitueshme. Këto parime janë afirmuar plotësisht nga Dhoma e Madhe e çështjen Nachova. Gjykatësit europian shkuan me tej duke zgjeruar të themi me anë të interpretimit, detyrimet nga dispozitat e Konventës, duke konfirmuar detyrimin për një formim adekuat të forcave policore dhe të sigurisë. Me të drejtë duhet që këto forca të formohen për të qenë në gjendje të vlerësojnë nëse është absolutisht e nevojshme ose jo përdorimi i armëve të zjarrit, dhe jo vetëm duke ndjekur me përpikëri rregullat pertinente,

por edhe duke pasur siç duhet parasysh përparësinë e respektimit të jetës së njeriut si një vlerë themelore¹³⁰. Zhvillimi i operacioneve të forcave policore kërkon, që paraprakisht këto të hartohen e të përgatiten dhe të observohen, në mënyrë që të arrihet dhe të sigurohet, reduktimi në minimum për aq sa është e mundur, përdorimi i forcës vdekjeprurëse¹³¹. Kjo kërkesë, tashmë, bën që gjykatësi europian dhe ai i juridiksionit të brendshëm, të shqyrtojnë mënyrë jashtëzakonisht të kujdesshme dhe korrekte kontekstin e përgjithshëm të operacioneve të kësaj natyre, mekanizmin si dhe masat e marra, urdhrat e dhëna dhe informatat e dhëna nga agjentët në terren dhe nga një këndvështrim më i gjerë, lidhjet e këtyre të fundit me hierarkinë, drejtimin e operacioneve etj. Në identifikim të mangësive, duhet të arrihet në përfundimin e pashmangshëm se nuk kemi të bëjmë, sipas paragrafi të 2 të nenit 2 të Konventës, me një *domosdoshmëri absolute* të përdorimit të forcës dhe se, për rrjedhojë, kemi të bëjmë me një shkelje të kësaj dispozite¹³².

3.2.4. Mbrojtja nga rreziqet që lindin si pasojë e veprimit të pushtetit publik

Shteti mund të jetë gjithashtu përgjegjës për mosparandalim e një rreziku të lindur si rezultat i aktivitetit të pushteteve shtetërore ose në kuadrin e zbatimit të një politike shtetërore. Janë konstatuar shumë raste të tilla. Vendimet *L.C.B. kundër Anglisë* dhe *Öneryildiz kundër Turqisë* janë ilustrime të hipotezës ku pushteti shtetëror drejton drejtpërdrejt një aktivitet të rrezikshëm. Çështja e parë në të cilën është provuar zbatueshmëria e Konventës për raste të kësaj natyre, është dhe ajo e eksperimenteve bërthamore të kryera nga qeveria britanike. Paditësja, vajza e një ushtari që kishte kryer

¹³⁰ Arsyetim i vendimit shih në paragrafin 34.

¹³¹ Shih çështjen *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 14.

¹³² Shih këtu *Ergi kundër Turqisë*, i 28 korrikut 1998, si dhe *Nachova dhe Makaratzis*, të lartpërmendur.

shërbimin në ishullin Christmas në periudhën e provave bërthamore, kërkonte të konfirmohej përgjegjësia e Anglisë për mosinformim të babait të saj mbi dozën e rrezatimit që ai kishte marrë në atë periudhë si dhe për pasojat e parashikuara, gjë që do të kishte bërë të mundur diagnostikimin me të shpejtë të sëmundjes së tij dhe kurimin e saj. Në një çështje tjetër u shqyrtuan pasojat vdekjeprurëse të një shpërthimi në një *landfield* që administrohej nga bashkia. Në rrethana të tilla, kur autoritetet shtetërore zhvillojnë veprimtari të ligjshme por me rrezikshmëri të lartë, ato duhet të respektojnë, disa detyrime që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë (pa anashkaluar detyrimet për mbrojtje të mjedisit, faunës etj, por që në këtë tezë nuk mund të zgjerojmë dhe temën e saj prandaj dhe do të mjaftohem te e drejta për jetën). Së pari, duhet përcaktuar një kuadër rregullator, psh., me miratimin e një rregulloreje e cila të përcaktojë qartë kushtet për lejimin dhe ngritjen e këtij aktiviteti, shfrytëzimin, sigurinë dhe kontrollin e tij dhe që bën të detyrueshëm për secilin individ që operon në këtë fushë, miratimin e masave praktike të domosdoshme¹³³. Gjithashtu duhet informuar publiku për rreziqet që mund t'i kanosen. Megjithatë, në të dyja rastet Shteti do të ngarkohej, me përgjegjësi, kur kemi të bëjmë veçanërisht me detyrimin e informimit, vetëm nëse autoritetet i njihnin ose duhet të ishin të informuar për rreziqet dhe nuk vepruan në kohë.

Në çështjen *Öneryildiz*, ky kusht u përmbush. Atëherë, gjykatësi evropian vlerësoi se nuk ishte e logjikshme që qeveria turke të pretendonte fajësi-përgjegjësi të viktimes dhe aq më tepër kur kemi të bëjmë dhe me një interes legjitim, atë për respektimin e vendbanimit dhe të jetës së personave. Në çështjen *Mastromatteo kundër Italisë* u shqyrtua

¹³³ Vendimi *Öneryildiz kundër Turqisë*, paragrafi 90.

lidhur me politikën e riintegritit të personave të burgosur. Paditësi pretendoi, dhe e ngriti si akuzë, se kjo politikë shkaktoi vdekjen e djalit të tij. Ky i fundit ishte vrarë nga persona të cilët ishin dënuar me burgim për krime, por ishin lënë të lirë pasi gjykatësi i zbatimit të dënimeve kishte vendosur për lirim të tyre me kusht. Kjo padi shtronte pyetjen nëse vetë zbatimi i politikave të riintegritit shoqëror të personave të dënuar me burgim mund të bënte përgjegjës një Shtet anëtar. Përgjigjia e Gjykatës ishte pozitive por me një arsyetim dhe argumentim të paqartë për dhe vetë lexuesin. Ajo shqyrtoi kuadrin ligjor italian të kësaj fushe para se të arrinte në përfundimin se nuk kishte të bënte me një mosnjohje të kërkesave të Konventës. Megjithatë, edhe pse gjykatësi nuk e shpreh qartë, duket se Shtetet kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë fushë. Një pyetje tjetër kishte të bënte me faktin nëse neglizhencat ose pakujdesia në zbatimin e vendimeve për liridaljen ose të zbatimit të një sistemi gjysëm-lirie të të dënuarve me burgim mund të konsideroheshin në raste të vecanta, se binin në kundërshtim me nenin 2 të Konventës? Edhe këtu përgjigja ishte pozitive. Autoritet vendase duhet, në një rast të tillë, të bëjnë gjithçka të mundur, brenda pritshmërive të arsyeshme nga keto autoritete, për të penguar materializimin e një rreziku, real dhe të menjëhershëm për jetën për të cilin (rrezikun) ato janë ose duhej të ishin informuar. Ato duhet të kryejnë *devoir de diligence* që, sipas Gjykatës, nuk ishte shkelur në këtë rast, dhe kjo sepse nuk kishte asnjë tregues për të parashikuar nëse të burgosurit në fjalë do të kryenin krime sapo të dilnin nga burgu, dhe që në veçanti, do të cënonin jetën e djalit të paditësit. Hipoteza e fundit, e njohur nga Gjykata, ka të bëjë me politikën shëndetsore. Në vendimet *Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë* dhe *Vo kundër Francës*, Gjykata ka nënvizuar, veçanërisht se parimet e nxjerra nga vendimi *L.C.B.* do të zbatoheshin edhe në fushën shëndetësore dhe, këtu, ato bëjnë të detyrueshme ndërhyrjen

juridike të Shtetit për *hartimin dhe miratimin e një rregulloreje* që detyron spitalet, qofshin këto shtetërore apo private, të miratojnë dhe vetë këto të fundit, masa për të siguruar jetën dhe mbrojtjen e të pacientëve të tyre. Vërejmë se me këto vendime rreshqasim në mënyrë progressive nga përgjegjësia për gjenerim të rrezikut drejt një përgjegjësie më të gjerë për shkak të veprimit të të tretëve.

3.2.5. Mbrojtja ndaj të tretëve

Një detyrim pozitiv ndaj të drejtës për të jetuar është dhe ndalimi dhe dënimi i vrasjeve pavarësisht nga cili person ose organ është kryer. Të gjitha vdekjet duhet të hetohen në mënyrë të përshtatshme, dhe ligji duhet të zbatohet në mënyrë të efektshme. Kjo kryhet më mirë nga një gjykim penal: siç është përcaktuar nga Gjykata ‘në rrjedhën normale të ngjarjeve, një gjykim penal, me një procedurë kontradiktore përpara një gjykatësi të pavarur dhe të paanshëm, konsiderohet se jep garanci më të forta për një procedurë efektive për gjetjen e fakteve dhe përcaktimin e fajtorit (Manual SLYNN, 2016:99). Në një sërë çështjesh në të cilat të afërmit e personave të vrarë nga persona të tjerë civilë dhe të personave që akti i vrasjes kishte ngelur në tentativë, është pretenduar se Shteti kishte si detyrim ligjor në bazë të Konventës t’i mbronte viktimat, por që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Në këto çështje gjithashtu është trajtuar në thelb si e drejta materiale, ashtu dhe procedura e marrjes dhe vlerësimit të provave, të themelit dhe procedurës. Në çështjen *Civek kundër Turqisë* ankuesit u ankuan në lidhje me dështimin e mbrojtjes nga ana e autoriteteve për të mbrojtur jetën e viktimës nga dhuna në familje. Nëna e ankuesve ka qenë viktimë e dhunës në familje. Në 2009 ajo ka jetuar me tre fëmijët e saj në një qendër për gratë e dhunuara dhe në 15 tetorit 2010, pas ankesës së tij, babai i aplikantëve u

ndalua nën akuzën e ushtrimit të dhunës në familje ndaj gruas së tij. Në datën 12 nëntor 2010 kjo e fundit e tërhoqi ankesën e saj dhe ai u lirua duk u vendosur vetëm detyrim paraqitje në polici si masë ndaluese. Atij iu ndalua kategorikisht ushtrimi përsëri i dhunës ndaj viktimës, u vendos dëbimi i tij nga banesa martesore, si duhet të qëndronte për një periudhë tre mujore larg nga viktimja. Ndaj viktimës vijuan kërcënimet për vdekje deri sa në 4 janar 2011, nëna e ankuesve u vra nga bashkëshorti i saj në rrugë duke e goditur me 22 herë me thikë. Bashkëshorti i viktimës u dënua me burgim të përjetshëm.

Dhuna në familje është një fenomen që mund të marrë forma të ndryshme si dhuna fizike, dhuna psikologjike, fyerjet etj. Ky sot është një problem i përgjithshëm i përbashkët për të gjithë Shtetet Anëtare dhe është një shqetësim i veçantë në shoqëritë evropiane. Dhuna shfaqet në forma të ndryshme dhe nuk shfaqet gjithmonë hapur, sepse ajo bënë pjesë në kontekstin e marrëdhënieve personale apo qarqe të vogla. Subjekte të dhunës mund të jenë si femrat dhe meshkujt. Në vlerësimin e kësaj çështjeje Gjykata mori në konsideratë seriozitetin e këtij problemi, kjo edhe për faktin se dhuna në rastin në fjalë ishte e njohur tashme dhe policia ishte e informuar për mundësinë e vrasjes nga ankesat e shumta të nënës e ankuesve dhe nga dëshmia e aplikantët. Pra autoritetet e dinin ose duhet ta ketë ditur se vrasja e viktimës nga ana e bashkëshortit ishte e mundshme dhe nuk i janë përgjigjur dhe nuk kanë marrë masat për parandalimin e saj. Policia nuk ka marrë ndonjë veprim shtesë ndaj burrit të saj edhe pse ishte në dijeni të kërcënimeve më jetë të bëra ndaj viktimës. Nga ana e prokurorisë nuk janë marrë masa për të parandaluar vrasjen e viktimës. Në këto kushte Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 sepse në bazë të legjislacionit të brendshëm duhet të ishin marrë masa konkrete për mbrojtjen e viktimës, dhe se shteti ka dështuar në detyrën e tij për të mbrojtur jetën e individëve të ndodhur nën kërcënimin e jetës.

Në çështjen e Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar¹³⁴ e cila konsistonte në vrasjen e dy personave, babë e bir, ky i fundit nxënës shkolle, nga një mësues që ishte afeksionuar pas djalit. Mësuesi, z. Paget-Leëis, kishte historik të c'rregullimeve mendore. Kishin ndodhur një sërë incidentesh që progresivisht rëndoheshin për të cilat mësuesi ishte pezulluar nga shkolla pas një vlerësimi psikiatrik. Pas vrasjeve ai u gjykua dhe u shpall fajtor si person i përgjegjshëm në çastin e aktit kriminal duke u dënuar me izolim në një spital të sigurisë së lartë për pacientë me c'rregullime mendore të diagnostikuara si të përhershme.

Gjykata e trajtoi çështjen në kuadrin e detyrimit që kishte shteti për të mbrojtur jetën e të dy viktimave me anë të veprimeve ë duhet të ndërmernte. Ankuesit që janë djali dhe nëna e tij akuzonin autoritetet se policia ishte në dijeni të të gjitha fakteve dhe historikun e dhunshëm të agresorit dhe kishte premtuar se do të ofronte mbrojtjen e domosdoshme të viktimave, por në vazhdimësi, nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Policia e mohoi se kishte bërë një premtim të tillë dhe pretendoi se asnjëherë nuk kishin pasur prova të mjaftueshme kundër mësuesit (agresorit) që të bënin të mundur arrestimin e ligjshëm të tij, duke i paraprirë kështu akteve të tij kriminale që sollën vdekjen e dy personave. Znj. Osman dhe Ahmeti ngritën padi civile kundër policisë për mosmarrjen e hapave të duhur nga ana e kësaj të fundit, për të mbrojtur Ahmetin (djalin) dhe të atin e tij (bashkëshortin e saj), por procedura gjyqësore u pezullua nga gjykatat britanike, të cilat vendosën, (duke iu referuar

¹³⁴ Shih çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998.

precedentëve ligjorë), se për shkak të interesit publik, policia përjashtohet nga përgjegjësia për neglizhencë në hetim dhe në efikasitet të reduktimit të krimit¹³⁵.

Komisioni, duke kërkuar vetë nxjerrjen në dritë të fakteve, arriti në përfundimin se policia ishte njoftuar për rrjedhën e ngjarjeve dhe për shqetësimet e djalit në lidhje me mësuesin e tij, por dhe se pretendimi që policia kishte premtuar mbrojtje për familjet e viktimave nuk ishte i verifikueshëm¹³⁶. Në fund, Komisioni u shpreh se nuk ishte provuar se policia mund apo duhet të kishte pasur parasysh rëndësinë e kërcënimit të prejardhur nga mësuesi, dhe se rrjedhimisht nuk konstatohet për këtë pretendim të kërkuesve, shkelje e Nenit 2 të Konventës¹³⁷.

Gjithsesi, ai u shpreh se shkelje të Nenit 6 evidentohet në faktin që kërkuesve u ishte mohuar akses në gjykatë në lidhje me shqyrtimin e akuzave të tyre në bazë të ligjit dhe se policia nuk mund të gjykohej për neglizhencë në kryerjen e detyrave të saj. Gjykata (në një vendim të Dhomës së Madhe) pohoi në thelb mendimin e Komisionit. Detyrimet pozitive që rrjedhin nga Neni 2 i Konventës, në kontekstin e policimit, duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të mos imponojnë një barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet. Kur ngrihen akuza se autoritetet kanë shkelur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën për jetën në kontekstin e detyrimit të tyre të sipërpërmendur për të parandaluar dhe reduktuar krimet kundër jetës dhe shëndetit të personit, duhet përcaktuar përmbushja e kushtit që nuk është tjetër veçse dijenia apo

¹³⁵ Vendimi i Dhomës së Madhe tek *Osman*, paragrafët 63-66. Qeveria argumentoi se rregulli që e përjashtonte policinë nga përgjegjësia ("rregulli përjashtimor") nuk ishte absolut, por Gjykata nuk e pranoi argumentin (para. 152). Gjykata gjithashtu nuk pranoi faktin se ekzistonin rrugë alternative nëpërmjet të cilave kërkuesit mund të kishin siguruar kompensim (para. 153).

¹³⁶ Po Aty, paragrafët 68, 70 -71.

¹³⁷ Shih paragrafi 111 i vendimit të Dhomës së Madhe tek *Osman*.

detyrimi për të parashikuar në atë kohë, ekzistencën e një rreziku real apo të menjëhershëm për jetën e një individi apo individëve nga aktet kriminale të një pale të tretë dhe gjithashtu të përcaktohet fakti se nëse autoritetet nuk kishin marrë masat e duhura brenda kompetencave të tyre, që sipas një gjykimi të arsyeshëm, mund të pritej që të shmangnin në atë kohë rrezikun. Nuk mund të pranohet këndvështrimi se dështimi për të perceptuar rrezikun për jetën në rrethanat e njohura në kohën e zhvillimit të ngjarjes kriminale, apo mos iniciativa për të ndërmarrë masa parandaluese për të shmangur rrezikun, mund t'i atribuohen neglizhencës së madhe apo mos konsiderimit të vullnetshëm për realizimin e detyrimit për të mbrojtur jetën. Një standard i tillë i ngurtë duhet të konsiderohet si i papajtueshëm me kushtet e Nenit 1 të Konventës dhe me detyrimet e Shteteve Kontraktuese në bazë të atij Neni për të siguruar mbrojtjen praktike dhe efektive të të drejtave dhe lirive të parashtruara aty, duke përfshirë Nenin 2.

Në lidhje me pyetjen se duke marrë parasysh natyrën e së drejtës që mbrohet nga Neni 2, si një e drejtë themelore në skemën e Konventës, është e mjaftueshme për një kërkues që të provojë se autoritetet nuk bënë të gjitha ato që në mënyrë të arsyeshme pritet që të bëjnë për të shmangur një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën, për të cilin kanë, apo duhet të kishin dijeni Gjykata u shpreh se kërkuesit nuk kishin mundur të provonin se autoritetet ishin në dijeni apo duhet të kishin qenë në dijeni se jeta e familjes Osman ishte në një rrezik real dhe të menjëhershëm nga Paget Leëis, apo që të kishin prova të mjaftueshme ose për ta akuzuar atë, ose për ta izoluar në një spital psikiatrik. Ato (autoritetet shtetërore) nuk mund të kritikohen se pse janë mbështetur në prezumimin e pafajësisë, apo se nuk kanë përdorur instrumentin ligjor të arrestimit dhe ndalimit nga

momenti kur provat u konsideruan si të pamjaftueshme. Kështu, nuk mund të evidentohet shkelje e Nenit 2¹³⁸, apo e Nenit 8¹³⁹.

Në çështjen e Menson kundër Mbretërisë së Bashkuar¹⁴⁰ Michael Menson ishte një angloafrikan me c'rregullime mendore i cili ishte qëlluar dhe i ishte vënë zjarri nga një bandë të rinjsh të bardhë në një sulm racist në Londër në janar 1997. Ai vdiq në spital dy javë më vonë. Policia fillimisht i injoroi shenjat që tregonin se ai kishte qenë viktimë e një sulmi kriminal racist dhe supozoi se i kishte kryer vetëvrasje. Ata nuk ndërmorën masat e duhura pas incidentit për të siguruar provat dhe nuk morën nga ai deklaratë për ngjarjen kur ishte në spital, megjithëse ai kishte qenë në gjendje që t'ia shpjegonte në detaj sulmin të afërmeve të tij. Kërkuesit, të gjithë vëllezër e motra të të ndjerit, pretenduan se hetimet ishin ndikuar nga racizmi brenda Shërbimit Policor Metropolitan të Londrës. Ata u ankuan në Autoritetin e Ankesave të Policisë i cili, pasi hetoi për çështjen, pohoi se kishte pasur prova të pavarura për të mbështetur akuzat e kërkuesve. Dosja përfundimisht i kaloi për shqyrtim Shërbimit të Prokurorisë, por nuk ishte marrë ndonjë vendim për të përcaktuar nëse duheshin ngritur akuza kundër policëve individualisht për veprat penale në lidhje me hetimin në kohën kur Gjykata po trajtonte ankesën e kërkuesve në vitin 2003¹⁴¹. Kërkuesit në kërkesën e tyre pretenduan për shkelje të Neneve 2, 6, 8, 13 dhe 14 të Konventës. Gjykata deklaroi se çështja ishte “e pabazuar” dhe rrjedhimisht e papranueshme nga të gjitha aspektet, kryesisht sepse në fund të fundit, personat që kryen krimin ishin gjykuar

¹³⁸ Vendimi i Dhomës së Madhe *Osman*, paragrafët 121-122.

¹³⁹ Po Aty, paragrafët 128-129.

¹⁴⁰ *Alex Menson dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 47916/99, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 6 majit 2003.

¹⁴¹ Për detaje shih paragrafët 1-9 të vendimit në *Menson*. Pak pas vendimit të Gjykatës, Shërbimi i Procedimit Ligjor të Kurorës vendosi që nuk kishte prova të mjaftueshme për të akuzuar ndonjë nga oficerët e policisë, megjithëse ishin duke u marrë nën shqyrtim ende akuzat disiplinore: *BBC News*, e premte, 16 maj 2003.

dhe dënuar dhe për më shumë ishin ndëshkuar ashpër¹⁴². Megjithatë, paraprakisht Gjykata qartësoi edhe marrëdhënien midis Nenit 6 dhe kushteve procedurale të Nenit 2, si dhe parimet në bazë të nenit të përmendur së fundmi në lidhje me detyrimin për të hetuar për vrasjet e kryera. Në lidhje me të parën, Çështjet e llogaridhënies dhe të përgjegjësisë civile (ose, në juridiksione të tjera, përgjegjësi administrative) të policisë për racizmin që ndikon në cilësinë e një hetimi për vrasje dhe disponueshmëria e një zgjidhjeje efektive, pra e “aksesit në gjykatë” duhet të shqyrtohet të paktën në bazë të Nenit 6. Ndryshe nga sa më sipër, Neni 2 lidhet kryesisht me vlerësimin e përputhshmërisë së një Shteti Kontraktues me detyrimet e tij substantive dhe procedurale për të mbrojtur të drejtën për jetën”¹⁴³. Kur ekziston një arsye për të besuar së një individ ka marrë plagë kërcënuese për jetën në rrethana të dyshimta, duhet kryer “një formë hetimi zyrtar efektiv” “që të përcaktojë shkakun e plagëve dhe identifikimin e personave që janë përgjegjës dhe këta të fundit të dërgohen përpara drejtësisë”. Megjithëse kushti është një nga mjetet, jo rezultati, kjo gjë nuk çon domosdoshmërisht në dënimin e personave që kanë kryer krimin, përse kohë që të jenë marrë të gjitha masat e arsyeshme për t’i identifikuar dhe ndëshkuar ata. Hetimi duhet të jetë i menjëhershëm dhe duhet të kryhet me vetë iniciativën e autoriteteve¹⁴⁴. E gjithë kjo sigurisht që thjesht përsërit kushtet e paraqitura në çështje të tjera në lidhje me vrasjet e qëllimshme nga ana e agjentëve të Shtetit, vdekjet gjatë mbajtjes nën arrestim, apo vrasjet në të cilat përfshirja, apo bashkëpunimi i Shtetit ka mbetur i pazgjidhur¹⁴⁵.

¹⁴² Shih në veçanti fq.14 të vendimit *Menson*.

¹⁴³ Po Aty, fq.14.

¹⁴⁴ Po Aty, fq. 12-14.

¹⁴⁵ Përmbledhje e kushteve në përmbajtje të vendimit tek *Kelly* dhe cituar në pjesën mbi “nevojën për të filluar një hetim *ex post facto*: ‘gjymtyra procedurale’ e Nenit 2 të KEDNJ.

Në çështjen *Menson*, Gjykata qartësoi së këto kushte kërkohet të zbatohen edhe për vrasjet e individëve nga civilë duke shtuar se kur ndodh një sulm me motiv urrejtje racore, është veçanërisht e rëndësishme që hetimi të ndiqet me dinamizëm dhe paanshmëri, duke marrë në konsideratë nevojën për të rivlerësuar vazhdimisht dënimin që i jep shoqëria racizmit dhe për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e autoriteteve për të mbrojtur pakicat nga kërcënimi i dhunës raciale¹⁴⁶.

Shteti gjithashtu ka përgjegjësi të posaçme për të mbrojtur personat që janë nën mbikëqyrjen e tij ndaj sulmeve nga individë të tjerë civilë. Këto përgjegjësi të posaçme lindin edhe në kuadër të përmbushjes së kushteve substantive të Nenit 2, dhe në kuadër të përputhmërisë me kushtet e tij procedurale. Ato gjithashtu ngarkohen me përgjegjësitë përkatëse për vdekjet e pashpjeguara që kanë ndodhur kur personat kanë qenë të burgosur, apo vdekjet për të cilat akuzohen se i kanë shkaktuar vetë agjentët e Shtetit, gjë që u trajtua në kapitullin e mëparshëm.

Çështja e Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar¹⁴⁷ kishte të bënte me një kazus si më poshtë: Christopher Edëards (i biri i Paul dhe Audrey Edëards), ishte arrestuar në nëntor 1994 se ngacmonte gratë në rrugë. Pas një seance dëgjimore përpara një gjyqtari, ai u mbajt nën arrest në një qeli burgu. Më vonë po atë ditë, një tjetër burrë, i cili ishte diagnostikuar më parë me probleme mendore, Richard Linford, u burgos gjithashtu në të njëjtin burg. Megjithëse ata fillimisht u mbajtën në qeli secili më vete, më vonë po atë ditë i futën në të njëjtën qeli së bashku. Natën, Richard Linford sulmoi dhe vrau

¹⁴⁶ Vendimi *Menson*, paragrafet 12-14.

¹⁴⁷ Vendimi në çështjen *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* i 14 marsit 2002.

Christopher Edwards¹⁴⁸. Në prill 1995, Richard Linford pasi pranoi se ishte fajtor për akuzën e vrasjes së një personi, u dërgua në një spital sigurie për persona me c'rregullime mendore, ku u diagnostikua se vuante nga *skizofrenia paranoide*. Për shkak të pranimi të fajit, faktet e çështjes u shqyrtuan vetëm në mënyrë sipërfaqësore në gjyq. Pas gjyqit, hetimi që ishte hapur formalisht, por që u shty dhe u pezullua për shkak të procesit penal, u mbyll pa bërë ndonjë vlerësim të detajuar të rrethanave në të cilat u krye vrasja¹⁴⁹.

Në korrik 1995, filloi një hetim privat, jostatusor nga tre agjensi shtetërore për Christopher Edwards, nga Shërbimi i Burgut, Këshilli Bashkiak lokal dhe Autoriteti Shëndetësor lokal. Raporti prej 388 faqesh i hetimit, i botuar tre vjet më vonë në qershor 1988, nxori përfundimin se do të kishte qenë më e arsyeshme si teorikisht ashtu dhe praktikisht që Christopher Edwards dhe Richard Linford të mos mbaheshin në të njëjtën qeli. Aty u konstatua një kolaps i sistemit të mekanizmit mbrojtës që duhet të kishte funksionuar për të mbrojtur këtë të burgosur. Ai (Raporti) identifikoi një sërë mangësish, duke përfshirë mbajtjen jo siç duhet të regjistrimeve, komunikimin e papërshtatshëm dhe bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet agjencive, si dhe një sërë mundësish të humbura që do të mund të kishin parandaluar vdekjen e Christopher Edwards¹⁵⁰.

Raporti ishte një dokument i plotë për të cilin Gjykata nuk kishte asnjë hezitim për tu mbështetur në vlerësimin e fakteve dhe problematikave për zgjidhje në këtë çështje¹⁵¹. Megjithatë, kërkuesit u këshilluan që, pavarësisht nga mangësitë e përcaktuara, ata përsëri nuk kishin ndonjë mundësi reale për të paditur në gjyq autoritetet për shkaktim dëmi sipas

¹⁴⁸ Shih paragrafët 9-21 të vendimit tek *Edwards* për detaje.

¹⁴⁹ Vendimi në çështjen *Edwards*, paragrafët 22 – 23.

¹⁵⁰ Po Aty, paragrafi 32. Për listimin e gabimeve të evidentuara shih paragrafin 33.

¹⁵¹ Po Aty, paragrafi 76.

të drejtës civile, për mënyrën se si kishin trajtuar të birin e tyre, apo në lidhje me dëmshpërblimin për dhimbjen apo vuajtjen që ai mund të kishte kaluar¹⁵². Me anë të letrës së 25 nëntorit 1998, Shërbimi i Prokurorisë qëndroi përsëri në vendimin e tij të mëparshëm, se kishte prova të pamjaftueshme për të vijuar me akuzat penale kundër cilitdo në Shërbimin e Burgut apo të policisë. Avokati i kërkuesve i këshilloi këta të fundit në 10 dhjetor 1998 se, pavarësisht nga shumë mangësitë e evidentuara, kishte materiale të pamjaftueshme për të konstatuar një akuzë penale për shpërdorim detyre si pasojë e një neglizhence të patolerueshme kundrejt cilitdo individ apo agjencie¹⁵³.

Gjykata u shpreh se historiku i sëmundjes së Richard Linfordit dhe rrezikshmëria e tij njiheshin nga autoritetet dhe se kjo dijeni duhet të ishte sjellë në vëmendjen e autoriteteve të burgut, dhe në veçanti, të personave që ishin përgjegjës për të vendosur në lidhje me dërgimin e tij në një qendër të përkujdesit shëndetësor të burgut, apo në qeli me të burgosurit e tjerë¹⁵⁴.

Megjithatë, nuk u shpreh se kishte pasur një sërë mangësish në transmetimin e informacionit¹⁵⁵. Kjo gjë ndikoi në procesin e kontrollit në burg, që gjithsesi ishte mjaft sipërfaqësor: Gjykata vlerësoi se është e vetë-provuar që procesi i kontrollit së të ardhurve të rinj në burg duhet të shërbejë për të identifikuar në mënyrë efektive ata të burgosur që, për mirëqenien e vetë atyre apo të të burgosurve të tjerë, duhet t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor. Mangësitë në informacionin e dhënë personelit të pranimi në burgje u kombinuan në këtë rast me natyrën e shpejtë e sipërfaqësore të ekzaminimit të kryer nga një

¹⁵² Vendimi në çështjen *Edwards*, paragrafi 34.

¹⁵³ Po Aty, paragrafi 35.

¹⁵⁴ Po Aty, paragrafi 61.

¹⁵⁵ Po Aty.

punonjës i kontrollit shëndetësor i cili u konstatua nga hetimi se nuk ishte trajnuar si duhet, dhe se vepronte në mungesë të një doktori për të cilin mund të kërkohej ekzaminim i mëtejshëm në rast vështirësie apo dyshimi¹⁵⁶.

Rrjedhimisht Gjykata konsideroi se në bazë të informacionit që ishte në dispozicion të autoriteteve, Richard Linford nuk duhej të ishte vënë pikë së pari në një qeli me Christopher Edwards. Gjykata nxjori përfundimin se moskalimi i informacionit për Richard Linford tek autoritetet e burgut nga ana e agjencive të përfshira në këtë çështje (mjekët, policët, avokatët dhe gjykata) dhe mënyra e papërshtatshme e kryerjes së procesit të kontrollimit me mbërritjen e Richard Linfordit në burg, nxjerr në pah një shkelje të detyrimit të Shtetit për të mbrojtur jetën e Christopher Edwards. Kështu, themelohet shkelje e Nenit 2 të Konventës në këtë kuadër¹⁵⁷.

3.2.6. Mbrojtja nga vdekjet e personave që ndodhen në masën e arrestit

Detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën, në rrethana të caktuara mund të kërkojë që Shteti të mbrojë jetën e individëve të caktuar nga kërcënime të identifikuara. Ky detyrim pozitiv është veçanërisht i mprehtë përsa i përket të personave që mbahen në paraburgim. Ata janë në një pozicion delikat dhe Shteti ka detyrë t'i mbrojë. Ky detyrim lind atëherë kur autoriteti 'dinte, ose duhet të kishte ditur në atë kohë për ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm ndaj jetës së një individi të caktuar nga një palë e tretë apo nga vetvetja dhe që ata dështuan të merrnin masa sipas kompetencave të tyre, nga të cilët, në mënyrë të

¹⁵⁶ Vendimi në çështjen *Edwards*, paragrafi 62.

¹⁵⁷ Po Aty, paragrafët 63-64.

arsyeshme, pritej që të shmangnin një rrezik të tillë'.¹⁵⁸ Legjislacioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtarë përcaktojnë se autoritetet shtetërore janë të detyruara të mbrojnë personat që janë nën mbikëqyrjen e tyre nën masën e arrestit, për shkak të pozicionit delikat në të cilën ata ndodhen. Në këto raste të vdekjeve të personave nën masën e arrestit përgjegjësia për të dhënë një shpjegim bindës, për plagët ose dëmtimet e tjera që i janë shkaktuar një individ i cili është nën masën e arrestit, pra i izoluar, që fillimisht ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore, dhe është konstatuar pas lirimit të tij, se është dëmtuar, duke konsistuar ky shpjegim për mënyrën se si janë shkaktuar këto plagë, i takon shtetit¹⁵⁹. Kjo përgjegjësi në lidhje me trajtimin e një individ nën masën e arrestit, është absolute dhe e detyrueshme dhe barra e provës në raste të tilla për të dhënë një shpjegim të argumentuar dhe bindës bie mbi autoritetet¹⁶⁰.

Në çështjen *Karpylenko kundër Ukrainës* ankuesi pretendoi se djali i saj ishte keqtrajtuar në paraburgim dhe se ai nuk ishte i pajisur me kujdes adekuat mjekësor në paraburgim dhe fajësoi autoritetet për vdekjen e tij. Së fundi, ankuesi u ankua se ka pasur asnjë zgjidhje efektive të brendshme nga ana e shtetit. Në 26 dhjetor 2009 i biri njëzet e pesë vjeçare i aplikantit, Karpylenko është arrestuar nga Departamenti i Policisë së Qarkut Kiev i dyshuar për grabitje dhe një ditë më vonë iu nënshtrua një ekzaminim mjekësor, nga i cili nuk ka rezultuar të jetë plagosur. Gjykata e Rrethit Shevchenkivskyy vendosi lënien në paraburgim në pritje të gjykit. Në këto kushte në 30 dhjetor 2009 K. ishte vendosur në Qendrën e Kiev Paraburgimit "*The Sizo*" dhe në mars të 2010, ai paraqiti një ankesë në

¹⁵⁸ Shih çështjen *Keenan kundër MB*.

¹⁵⁹ Shih çështjen *Salman kundër Turqisë*, vendimi i 27 qershorit 2000, paragrafi 99, duke iu referuar Selmouni kundër Francës, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 korrikut 1999, para. 87.

¹⁶⁰ Po Aty, paragrafët 99 – 100.

gjykatë duke pretenduar që ndaj tij ishte ushtruar presion fizik dhe psikologjik në mënyrë që të bëjë atë të rrëfejë për një krim që nuk e kishte kryer. Në 10 prill 2010 K. u paraqit në Spitalin e Emergjencave të qytetit Kiev, ku u diagnostikua me një dëmtim të mbyllur të barkut, këputje të shpretkës, hematoma retroperitoneale, dëmtim të mbyllur në gjoks, këputje e indeve të mushkërive, pneumonia majtë njëanshëm, anemia post-traumatike dhe hemorragji shok e cila kishte sjell humbjen e gjakut mbi 40%. Në 10 dhe 12 prill 2010 K. iu nënshtrua 2 operacioneve në lidhje me dëmtimet e lartpërmendura dhe iu hoq shpretkja. Në këto kushte ankuesi u ankua të autoritetet e ndjekjes penale se djali i saj ishte sulmuar fizikisht në ambientet e paraburgimit *The Sizo*. Prokuroria Shevchenkivskyy refuzoi të ngrite procedim penale kundër oficerëve të policisë në lidhje me keqtrajtimin e K. për shkak të mungesës së *corpus delicti* në lidhje me veprimet e tyre dhe sepse Departamenti i Policisë të qytetit të Kievit pasi përfundoi hetimin e brendshëm të ankesës së aplikantit lidhur me keqtrajtimin e pretenduar të djalit të saj dhe e gjeti atë të pa bazë. Ankuesi e refuzoi vendimin e prokurorisë duke kërkuar përsëri të behej një hetim penal dhe të realizohej marrja në pyetje e agjentëve që e kishin keqtrajtuar. Prokuroria e Shevchenkivskyy refuzoi ngritjen e një procedimi penal kundër punonjësve të policisë në fjalë, pasi nuk gjeti prova të sjelljes kriminale. K vdiq në ambientet e paraburgimit dhe nga autopsia e lëshuar më 10 nëntor 2011 doli shkaqet e drejtpërdrejtë të vdekjes kanë qenë një dëmtim tumor të trurit, mushkërive dhe zemrës. Raporti gjithashtu vuri në dukje se K kishte pësuar dëmtime në shumë pjesë të organizmit nga dhuna e ushtruar ndaj tij në ambientet e paraburgimit. Në këto kushte ankuesja akuzoi autoritetet e ndjekjes penale në lidhje me vdekjen e parakohshme e birit të saj dhe kërkoi një hetim. Gjykata konstatoi se autoritet kishin dështuar në marrjen e masave për të siguruar djalin nën kujdesin e duhur mjekësor

dhe që hetimi i bërë nuk ishte i mjaftueshëm dhe efikas dhe për këtë arsye jo vendosi se ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv në rrethanat e vdekjes së K.-së, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me keqtrajtimin K. në paraburgim dhe ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv në pretendimin e keqtrajtimit K.-së. Po kështu në çështjen Salman, shtetasi Agit Salman, u arrestuar dhe u dërgua në një rajon policie ku humbi jetën në izolim pa mbushur 24 në izolim. Ekspertët mjekësorë turq u shprehën se shkak i vdekjes ishte një arrest kardiak dhe konstatuan gjithashtu mavijosje në krahë dhe një sternum të dëmtuar, të shkaktuar nga përpjekjet e stafit mjekësor për ta sjellë në jetë. Komisioni me kërkesë të paditësve caktoi ekspertë të tjerë të cilët, dhe pas analizës së trupit të viktimës, me konkluzionet e tyre përfundimtare e hodhën poshtë ekspertizën e parë duke zbuluar se plagët ishin pasojë e dëmtimeve nga dhuna e ushtruar para se viktimë të ndërronte jetë. Komisioni nxori përfundimin se Agit Salman i ishte nënshtruar torturës gjatë procedurës së marrjes në pyetje, e cila dhe kishte provokuar arrestin kardiak dhe rrjedhimisht, vdekjen e tij¹⁶¹. Gjykata u pajtua me konstatimin e Komisionit, ndërsa theksoi se në çështje të tilla përgjegjësia i takon shtetit për të provuar se viktimë nuk ka vdekur si rezultat i torturës. Kur Agit Salman u arrestua gëzonte shëndet të mirë. Gjithsesi, gjatë procesit të provës, shteti turk nuk mundi të provojë ose të shpjegojë me argumenta bindës se dëmtimet e konstatuara për së dyti ishin shkaktuar gjatë përpjekjeve të forcave të sigurisë për të arrestuar viktimën (pala e paditur pretendoi se dëmtimet trupore ishin shkaktuar dhe gjatë arrestimit të tij). Kështu, Gjykata vlerësoi se jemi para rastit të përgjegjësisë së shtetit për vdekjen e

¹⁶¹ Vendimi *Salman*, para. 32. Për një përshkrim të detajuar të zbulimeve të Komisionit në lidhje me faktet, shih paragrafët 8 – 32.

viktimës, i cili ishte atëherë në statusin e të arrestuarit¹⁶². Ajo vijoi duke u shprehur se në këtë kuadër ka pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës¹⁶³.

Përsa i përket kushteve procedurale të Nenit 2 në çështjet e vdekjeve të individëve që janë nën masën e arrestit parashtrojmë se detyrimi për një hetim të rregullt dhe brenda standarteve, për të përcaktuar faktet dhe për të siguruar përgjegjësinë e shtetit për vdekjen e individëve nën masën e arrestit. Në të gjitha rastet, autoritetet e një shteti kanë për detyrim të kryejnë hetime kur raportohet vdekja e një personi ndërsa nën arrest¹⁶⁴ të kryejnë një autopsi që do të sigurojë një provë të plotë e të saktë shkencore për të përcaktuar shkakun e vdekjes. Nëse nuk do të ndiqet procedura e duhur hetimore atëherë procesi hetimor konsiderohet i dështuar dhe i paligjshëm, në interpretim të nenit 2 të Konventës. Në rastin e Karpulyenko kundër Ukrainës Gjykata doli në përfundimin se autoritetet nuk kanë kryer një hetim efektiv për të zbardhur rrethanat e vdekjes se Karpulyenko pasi vetëm pas dy raporteve mjeko-ligjore u bë e mundur identifikimi i shkaqeve të vdekjes së viktimës. Në të gjitha çështjet e kësaj natyre, aspekti procedural i Nenit 2 është i rëndësishëm. Në çështjen e Kashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë¹⁶⁵, ku kërkuarit konstatuan pas kthimit Grozny, se

¹⁶² Gjykata i'u referua konstatimeve të nxjerra nga Komiteti për Ndalimin e Torturës të themeluar nën Konventën Evropiane për Ndalimin e Torturës, në vitin 1992, "praktika e torturës dhe e formave të tjera të keqtrajtimit të rëndë e personave që ndodhen nën arresti policor mbetet e përhapur kudo në Turqi", dhe se, edhe në vitin 1996, "përdorimi i torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit të rëndë mbetet një trajtim i zakonshëm në rajonet e *policisë në Turqi*." (paragrafët 70 dhe 71). Gjykata vërejtë edhe Raportin e Formularit të Autopsisë, të përfshirë në "Manualin për Ndalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve të Paligjshme, Arbitrare dhe në Masë" të miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1991 (paragrafi. 73). Këto referenca përsëri tregojnë se si precedenti i Gjykatës është pjesë e një kuadri më të gjerë të instrumenteve ndërkombëtare dhe të procedurave që plotësojnë njëra tjetrën.

¹⁶³ Vendimi *Salman*, paragrafët 102 – 103. Vëreni gjithashtu rëndësinë e bashkëngjitur nga Komisioni dhe Gjykata për gabimet në regjistrat e arrestimit dhe ndalimit: paragrafët 271 – 278 (të përmendura në para. 16 të vendimit).

¹⁶⁴ Vendimi *Salman*, para. 105. Parashtrimi i Gjykatës për çështjen *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 1 prillit 2001, para. 91, ku mirëpritet ngritja e menjëhershme e një hetimi për të gjitha rastet e vdekjesh që kanë ndodhur nën mbikëqyrjen e policisë nën arrest në Mbretërinë e Bashkuar.

¹⁶⁵ Shih çështjen *Kashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, vendimi i 24 shkurtit 2005.

disa nga të afërmit e tyre ishin vrarë. Paditësit mundën të sigurojnë dhe të paraqesin prova ku vërtetohej fakti i arrestimit të njërit nga të afërmit e kërkuesve. Kjo ishte parë nga dëshmitarë të cilët gjithashtu pohuan se mbi viktimën ishin kryer akte torture dhe më pas kësaj ishte ekzekutuar nga ushtarët. Ata akuzuan qeverinë ruse si përgjegjëse për dy akuza, atë të vrasjes të të afërmeve të tyre dhe për moskryerjen në mënyrën e duhur të hetimeve mbi këto vrasje. Qeveria kundërshtoi me argument supozimin se rrethanat e vdekjeve ishin të paqarta dhe sugjeroi se të afërmit e kërkuesve mund të ishin vrarë nga luftëtarët çeçen apo nga grabitës, dhe me shumë gjasa mund të kishin marrë pjesë vetë në rezistencën e armatosur dhe ishin vrarë në luftime e sipër. Gjykata i kërkoi qeverisë, që në mbështetje kundërshtimet dhe të paraqiste një kopje të të gjithë dosjes se hetimit penal për këtë çështje, por kjo e fundit paraqiti vetëm rreth dy të tretat e dosjes duke justifikuar se pjesa tjetër e dokumenteve nuk kishte të bënte me çështjen. Gjykata konsideron se përgjegjësia që të sigurojë dhënien e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me hetimet i takon shtetit. Sipas Gjykatës, hetimi penal u bazua në supozimin se vrasjet u realizuan nga ushtarët rusë dhe në fakt rrethina Staropromyslovskiy e Grozny-t kishte qenë nën kontrollin e rreptë të forcave ruse, se vetëm ushtarët e këtyre forcave mund të kishin kryer kontrolle identifikimi dhe se të afërmit e kërkuesve ishin vrarë gjatë një kontrolli identifikimi¹⁶⁶. Përgjegjësia për vdekjet e të afërmeve të kërkuesve pra i atribuohet shtetit të paditur. Në këtë u evidentua se ka pasur shkelje të kushteve substantive të Nenit 2¹⁶⁷.

¹⁶⁶ Për viktimat e tjera që u gjetën më vonë Gjykata u shpreh se prezumohej se ishin vrarë në rrethana të njëjta. Gjykata konstatoi se ishte provuar tashmë përtej cdo dyshimi se të afërmit e kërkuesve ishin vrarë nga ushtarët rusë dhe se vdekja e tyre mund ti atribuohet shtetit, i cili nuk kishte dhënë asnjë shpjegim apo justifikim për vrasjet.

¹⁶⁷ Shih *Vendimin Kashiyev dhe Akayeva*, paragrafi 147.

Në lidhje me momentin e fillimit të hetimeve dhe kohëzgjatjes së tyre Gjykata konstatoi parregullsi dhe mangësi të shumta, vonesë e pajustificuar prej tre muajsh para se të hapej procedura e hetimit penal. Nuk u hartua asnjë skicë që të tregonte vendndodhjen e trupave, nuk u bë asnjë përpjekje për të identifikuar dhe përcaktuar banorët që qëndruan në Grozny në dimrin e vitit 1999 – 2000, disa nga trupat as nuk që iu nënshtruan ekzaminimit mjeko-ligjor. Hetimet u shtynë, u pezulluan dhe rifilluan, dhe dosja u transferua shumë herë nga një prokurori tek tjetra për të paktën katër herë pa dhënë një shpjegim të qartë dhe pa njoftuar kërkuesit paraprakisht. Në këto rrethana, përfundimisht, autoritetet shtetërore konsiderohet se kanë dështuar në kryerjen e një hetimi efektiv penal për të zbardhur rrethanat e vrasjeve, duke shkelur kështu kushtin procedural të Nenit 2 të Konventës.

3.2.7. Mbrojtja nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse në konfliktet ndërkombëtare të armatosura

Gjatë trajtimit të rasteve të privimit të të drejtës së jetës GEDNJ-ja kryesisht ka trajtuar çështje me karakter kombëtarë, pra në kuptimin që privimi ka ardhur ose si mungesë e rregullimit të brendshëm ligjorë, ose nga agjentët e shtetit, nga mungesa e kujdesit të shtetit për të parandaluar situata ku merret jeta e individëve, por gjithmonë në kontekst kombëtarë.

Në lidhje me trajtimin e rasteve të privimit të jetës në situatat ndërkombëtare të armatosura, trajtimi i nenit 2 të Konventës do të trajtohet në dy çështje :

1. çështja e zbatueshmërisë së Nenit 2 për këto situata;
2. çështja e synimit territorial të Konventës (Watkin., 2004:98).

Përsa i përket çështjes së parë në nenin 15 paragrafi 2 të Konventës thuhet se”*edhe në kohë luftërash, nuk ka derogim nga Neni 2, përveç përsa i përket vdekjeve që rezultojnë nga aktet e paligjshme të luftës*”. Referenca për “*vdekjet që rezultojnë nga aktet e paligjshme të luftës*” është një referencë e drejtpërdrejtë për normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Kjo nënkupton se aktet që rezultojnë në humbje të jetës, të kryera gjatë kohërave të luftërave, të cilat bien në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare humanitare, përbëjnë gjithashtu *ipso facto* shkelje të Nenit 2. Në të kundërtën, vrasjet në kohë lufte, që janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare *nuk* cenojnë Konventën. Konventa dhe standardet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare humanitare pra, në këtë kuadër, harmonizohen tërësisht. Ky nuk është vendi për të diskutuar rreth së drejtës ndërkombëtare humanitare në detaj në fakt.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është shprehur se parimet themelore që janë në përmbajtje të dokumenteve, të cilat përbëjnë fabrikën e së drejtës humanitare janë :

- i. Mbrojtja e popullsisë civile dhe e objekteve civile dhe përkufizimi dhe dallimi midis luftuesve dhe jo-luftuesve.
- ii. Shtetet asnjëherë nuk duhet t'i identifikojnë civilët me një objekt sulmi ose shënjestër ushtarake.

Në bazë të parimit të dytë, ndalohet shkaktimi i vuajtjeve të panevojshme për luftuesit, po kështu, ndalohet përdorimi i armëve që u shkaktojnë luftuesve një dëm të tillë, apo që rëndojnë pa dobi vuajtjet e tyre dhe shtetet nuk duhet të kenë liri të pakufizuar për të zgjedhur mjetet luftarake, armët që ata përdorin¹⁶⁸. Pavarësisht se nuk ka pasur një

¹⁶⁸ Mendimi Këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i 8 korrikut 1996 mbi ligjshmërinë e armëve bërthamore, para. 78. Shih edhe referencat tek “Klauzola Martens” në paragrafin 79.

precedent specifik për t'u referuar, këto parime harmonizohen mirë me parimet e përgjithshme të përkufizuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjet e konfliktit të brendshëm të armatosur që trajtohet më sipër. Specifikisht, mund të rikujtohet se Gjykata ka vendosur që përdorimi i armëve të rrezikshme, si për shembull bombave të rënda me rënie të lirë dhe shpërthim të lartë, me avion në një zonë të populluar, “*jashtë kohës së luftës*” dhe pa evakuim paraprak të civilëve, “*është e pamundur që të pajtohet me shkallën e kujdesit që pritet të tregojnë organet zbatuese të ligjit në një shoqëri demokratike*”, dhe se në situatat e konflikteve të armatosura (të brendshme), duhen marrë masat e duhura për evakuimin e civilëve dhe veçanërisht për personat që këtë gjë e kanë të pamundur, duke krijuar rrugë të sigurt largimi dhe duke njoftuar popullsinë civile për këto masa, kurdo të jetë e mundur; dhe se kur ka civilë në zonën e konfliktit, autoritetet duhet të ushtrojnë “*kujdes të jashtëzakonshëm*” në përdorimin e forcës vdekjeprurëse¹⁶⁹. Këto parime pasqyrojnë të drejtën ndërkombëtare humanitare, po aq sa edhe të drejtën komunitare. Çdokush mund të nxjerrë përfundimin, nëse ndoshta edhe duke hezituar, se, në shkallën që Konventa në realitet zbatohet në situatat e konfliktit të armatosur në nivel ndërkombëtar, këto parime e ruajnë forcën e tyre dhe mund të zbatohen nga Gjykata. Megjithatë, pyetja e dytë mbetet, përse i përket zbatimit territorial të Konventës. Jurisprudenca në këtë kuadër ende nuk është përcaktuar plotësisht. Ajo është qendra e dispozitës në Nenin 1 të Konventës, duke u shprehur se: *Palët Kontraktuese do t'i sigurojnë gjithsecilit që ndodhet brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Pjesën I, pra Nenet 2 – 18 të kësaj Konvente.*

¹⁶⁹ Shih në pjesën për “*Analizën e përputhshmërisë me kushtet substantive të Nenit 2*” më sipër.

Në çështjet e Loizidou kundër Turqisë¹⁷⁰ dhe Qipro kundër Turqisë¹⁷¹, Gjykata u shpreh se, si pasojë e ndërhyrjes ushtarake në Qipron veriore dhe krijimin e një administrimi të varur prej saj në vend, popullsia u vendos brenda “juridiksionit” të Turqisë dhe rrjedhimisht Turqia ishte përgjegjëse sipas Konventës, si për veprimet e ndërmarra prej saj në Qipron veriore, edhe për ato të atij administrimi. Megjithatë, Gjykata cilësoi këtë përjasje në çështjen e Banković kundër 17 vendeve të NATO-s¹⁷². Çështja kishte të bënte me bombardimet nga ana e avionëve të NATO-s në stacionin e Radios dhe Televizionit Serb në Beograd në vitin 1999, që shkaktoi vdekjen e 16 civilëve dhe plagosjen e 16 të tjerëve. Bombardimet u kryen në kuadrin e aksionit luftarak të vendeve të NATO-s, që ata deklaruan se synonte sigurimin e përmbushjes së kushteve të komunitetit ndërkombëtar nga ana e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), siç ishte atëherë, në lidhje me trajtimin e shqiptarëve të Kosovës së RFJ-së. Në atë kohë, RFJ nuk ishte palë e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por ishin ama të gjitha vendet anëtare të NATO-s të përfshira në çështje. Këtu Gjykata u shpreh se nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare publike, kompetenca juridiksionale e një shteti është së pari territoriale. Gjykata ka pikëpamje se rrjedhimisht duhet marrë në konsideratë Neni 1 i Konventës për të reflektuar mbi këtë nocion të zakonshëm e në thelb territorial të juridiksionit, ku bazat e tjera të juridiksionit trajtohen për raste të jashtëzakonshme e për to kërkohet justifikim i veçantë në rrethanat

¹⁷⁰ Shih çështjen *Loizidou kundër Turqisë (Kundërshtimet Paraprake)*, vendimi i 23 shkurtit 1995.

¹⁷¹ Shih çështjen *Qipro kundër Turqisë*, vendimi i 10 majit 2001.

¹⁷² *Vendimi për Pranueshmërinë i Dhomës së Madhe të 12 dhjetorit 2001 për Kërkesën Nr. 52207/99 nga Vlastimir dhe Borka Banković dhe të Tjerë kundër Belgjikës, Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Spanjës, Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.*

specifike të çdo çështjeje¹⁷³. Për zbatimin “në raste të jashtëzakonshme” të Konventës, në çështjen e Loizidou dhe atë të Qipro kundër Turqisë, ka qenë kryesor fakti që në këto çështje. Shteti i paditur, nëpërmjet kontrollit efektiv të territorit përkatës dhe të banorëve të tij që largoheshin jashtë shtetit si pasojë e pushtimit ushtarak apo nëpërmjet pranimi, ftesës apo dijeninë e qeverisë të atij territori, ushtron të gjitha apo disa nga kompetencat publike që zakonisht ushtroheshin nga ajo qeveri¹⁷⁴.

Gjithashtu: Konventa është një traktat shumëpalësh që funksionon në baza të Nenit 56 të Konventës¹⁷⁵, të kontekstit kryesisht rajonal dhe mjaft dukshëm, në hapësirën ligjore (*espace juridique*) të Shteteve Kontraktuese. RFJ është e qartë se nuk hyn në këtë hapësirë ligjore. Konventa nuk është hartuar për tu zbatuar nëpër të gjithë botën nga Shtetet Kontraktuese. Kështu, vullneti për të shmangur një hapësirë apo vakum në mbrojtjen e të drejtave të njeriut deri tani është mbështetur nga Gjykata në favor të krijimit të juridiksionit vetëm, kur territori në fjalë ishte i tillë që në rrethana specifike mund të garantohet normalisht nga Konventa¹⁷⁶. Pra Konventa mund të zbatohet për akte jashtë-territoriale që kryhen nga një Shtet Anëtar, nëse akte të tilla ndodhin në një zonë për të cilën Shteti Palë ndërmerr “kontroll efektiv”, për shembull, si rezultat i nje akti ushtarak, në veçanti kur territori në fjalë është mbuluar tashmë nga Konventa përpara marrjes së këtij “kontrolli efektiv” nga Shteti Palë që sapo u përmend, d.m.th., nëse një Shtet Anëtar i Këshillit të Evropës ushtron kontroll efektiv ndaj një pjese territori që më parë kontrollohej nga një Shtet tjetër Anëtar.

¹⁷³ Shih çështjen *Banković*, Vendimi mbi Pranueshmërinë, paragrafët 60 – 61. Gjykata ishte e mendimit se ky këndvështrim mbështetej nga praktika e shtetit dhe nga *travaux preparatoire*: shih paragrafët 62 – 63.

¹⁷⁴ Po Aty, para. 71.

¹⁷⁵ Neni 56 § 1 mundëson një Shtet Kontraktues që të deklarojë se Konventa shtrihet për të gjithë apo cilindo nga territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ky Shtet është përgjegjës. [shënimet origjinale]

¹⁷⁶ Shih çështjen *Banković*, Vendimi mbi Pranueshmërinë, para. 80.

Sulmet nga ajri për territore që janë jashtë zonës së Këshillit të Evropës/Konventës, nuk i përkasin kësaj kategorie. Por vendimi është i papërcaktuar qartë në lidhje me zbatueshmërinë e Konventës për situata në të cilat një Shtet Palë ndërmerr “kontroll efektiv” në një zonë që nuk i përket *espace juridique* (hapësirës juridike) të Konventës. Gjykata shprehet se Konventa është *në thelb* rajonale dhe funksionon “*veçanërisht*” në këtë *espace juridique*, dhe vëren se “*deri tani*” ajo është mbështetur vetëm në çështje në të cilat territori në fjalë është mbuluar më parë nga Konventa. Por këto *cilësime* i lanë qartësisht Gjykatës lirinë për të shtrirë zbatimin e Konventës përsëri nëse e mendonte se do të kishte një tjetër “*bazë përjashtimore të juridiksionit*” dhe nëse do të kishte më tej një “*justifikim të veçantë në rrethana të veçanta*” të çështjes. Disa vendime të kohëve të fundit sugjerojnë se Gjykata në fakt ka vullnetin që në disa çështje specifike të shtrijë zbatimin territorial të Konventës për aktet e ndërmarra nga Shtetet Palë jashtë *espace juridique* (hapësirës juridike) evropiane.

Në çështjen e Issa dhe të Tjerë kundër Turqisë¹⁷⁷ shtatë barinj ishin vrarë nga ushtria turke që operonte në kufirin e saj në Irakun Verior. Këtu Gjykata vendosi, pa shprehur specifikisht nocionin e *espace juridique* se: Në bazë të parimeve përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, përgjegjësia e një Shteti mund të përfshihet kur, si pasojë e një akti ushtarak, qoftë i ligjshëm apo i paligjshëm, ai Shtet në praktikë ushtron kontroll efektiv ndaj një zone që ndodhet jashtë territorit të tij kombëtar. Detyrimi për të siguruar në një zonë të tillë të drejtat dhe liritë e parashtuara në Konventë rrjedh nga fakti i një kontrolli të tillë, edhe nëse ushtrohet drejtpërdrejtë nëpërmjet forcave të tij të armatosura, apo nëpërmjet një administrimi lokal të varur prej tij. Nuk është e nevojshme të përcaktohet

¹⁷⁷Shih çështjen *Issa dhe të Tjerë kundër Turqisë*, vendimi i 16 nëntorit 2004.

nëse një Palë Kontraktuese ushtron aktualisht kontroll të detajuar ndaj politikave dhe akteve të autoriteteve në zonën që ndodhet jashtë territorit të saj kombëtar, pasi edhe kontrolli i përgjithshëm mbi zonën në fjalë mund të përfshijë përgjegjësinë e kësaj Pale Kontraktuese. Gjithashtu, një Shtet mund të konsiderohet përgjegjës edhe për cënim të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa për personat që ndodhen në territorin e një Shteti tjetër, por që gjenden nën autoritetin dhe kontrollin e të parit (Shtetit) nëpërmjet agjentëve të tij që operojnë qoftë në mënyrë të ligjshme, qoftë të paligjshme, në këtë të fundit (Shtetin) . Përgjegjshmëria në situata të tilla lind nga fakti se Neni 1 i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të lejojë një Shtet palë të kryejë shkelje të Konventës në territorin e një Shteti tjetër, gjë që ai Shtet nuk mund ta bëjë në territorin e vet¹⁷⁸.

Është e qartë se Gjykata, në paragrafin e fundit të cituar më sipër, i referohet shprehimisht, jo vetëm për disa nga precedentët e saj, por edhe për çështjen e *Coard et al.* kundër Shteteve të Bashkuara¹⁷⁹, Komisionit Ndër-Amerikan, edhe për disa mendime të adoptuara nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut në çështjet e *Lopez Burgos* kundër Uruguait dhe *Celeberti de Casariego* kundër Uruguait¹⁸⁰ pasi këto të gjitha tentojnë të krijojnë një këndvështrim më të gjerë të qëllimit territorial të instrumenteve përkatëse, sesa ajo që duket se bëri Gjykata në çështjen *Banković*. Në Issa, Gjykata konstatoi se provat ishin të pamjaftueshme për të përcaktuar se trupat turke kishin qenë përgjegjëse për vdekjet e të afërmeve të kërkuesve. Gjithsesi, nga pikëpamja ligjore në lidhje me çështjen e “juridiksionit”, Gjykata vendosi hapur se hapat e ndërmarra në kuadrin e akteve ushtarake

¹⁷⁸ Vendimi tek *Issa*, paragrafët 69 – 71.

¹⁷⁹ Shih çështjen *Coard et al. kundër Shteteve të Bashkuara*, Komisioni Ndër-Amerikan i të Drejtave të Njeriut, vendimi i 29 shtatorit 1999.

¹⁸⁰ Shih çështjen *Lopez Burgos kundër. Uruguait dhe Celiberti de Casariego kundër Uruguait*, HR Ctee nr. 52/1979 dhe 56/1979.

përtej hapësirës juridike evropiane përfshijnë në fakt përgjegjësinë e shtetit përkatës nëse ky shtet ushtron “*përkohësisht kontroll të përgjithshëm efektiv*” të një zone specifike jashtë asaj hapësire.

3.2.8. Parandalimi i vetëvrasjes

Neni 2 i Konventës në parim nuk trajton të drejtën për t’i dhënë fund jetës. Por në rastet kur kemi të bëjmë me persona që janë nën mbikëqyrjen ose nën autoritetin e pushtetit, si në rastin e personave që janë në paraburgim ose janë të burgosur¹⁸¹ atëherë neni 2 i Konventës do të gjejë zbatim sepse në këto raste shteti i ka vendosur këta individë në një situatë vulnerable për tu mbrojtur. Në rastet e personave të burgosur, Gjykata ka arritur në përfundimin se nuk ka shkelje të nenit 2 nëse nga ana e autoriteteve përkatëse arrihet të vërtetohet se janë kryer të gjitha kontrollet e hollësishme për të parandaluar vetëvrasjen e të burgosurit. Por nuk ka të dhënë të njëjtin arsyetim Gjykata në rastin e trajtimin të çështjes Isenc kundër Francës, ku autoritetet franceze dështuan në detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur e drejta për jetën e një të burgosuri i cili vari veten në burg Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi unanimisht se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti ka të bëjë me vetëvrasje në burg të djalit të aplikantit dymbëdhjetë ditë pas burgosjes së tij. Aplikanti, Bedrettin Isenc, është babai i M., që vdiq nga vetëvrasje në burg. M. u arrestua në nëntor të vitit 2008 dhe u vendos në paraburgim në burgun e Bordeaux-Gradignan në qeli me dy të burgosur të tjerë. Në pasditen e 6 dhjetorit 2008, M vari veten në qelin e tij. Nga ana e administratës së burgut

¹⁸¹ Vendimi *Tanribilit kundër Turqisë* i 16 nëntorit 2000, Vendimi *Keenan kundër Anglisë* i 3 prillit 2001 si dhe Vendimi *Akdogu kundër Turqisë* i 18 tetorit 2005.

ishte bërë e mundur vendosja në një qeli m persona të tjerë ë M, me synimin që të mund të integrohej por nisur nga fakti që m ishte një person me ndjeshmëri shume t lartë dhe kjo ishte eksperiencia e parë e burgosjes bene që viktima të mos e përballonte do. Gjykata konsideron se një ishte e domosdoshme një ekzaminim mjekësor në momentin e pranimit si një masë paraprake minimale¹⁸².

Në mungesë të provave të një takimi me shërbimin mjekësor të burgut, Gjykata konstatoi se autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës së birit të aplikanti. Gjykata ka theksuar se bashkëpunimi me shërbimin mjekësorë për të vëzhguar të burgosurit parashikohet sipas ligjit kombëtar në formën e një marrëveshje bashkëpunimi mes burgut dhe shërbimeve mjekësore në monitorimin e të paraburgosurve me qellim parandalimin e vetëvrasjes. Në këto kushte Gjykata ka konstatuar se ka shkelje të nenit 2 të Konventës.

Gjykata ka konstatuar shkelje në çështjen *Kilinç kundër Turqisë, ku trajtohet rasti i vetëvrasjes*.

Gjykata bazuar në këto raste ka vendosur si pjesë të jurisprudencën e saj të cilën shtetet duhet ta plotësojnë marrjen e masave

1. Shteti duhet jo vetëm “të përcaktojë një kuadër legjislativ dhe administrativ që ka për qellim parandalimin e efektshëm”, por dhe të miratojë një “rregullore të përshtatshme sipas nivelit të rrezikut për jetën që lind si pasojë e natyrës së disa aktiviteteve dhe misionëve ushtarake, por edhe të elementit njerëzor në rastin kur shteti mobilizon qytetarë të thjeshtë”.

¹⁸² Shih çështjen *Isenc kundër Francës*.

2. ai duhet t'u parashkruaje ushtarakeve që të miratojnë “masa praktike për mbrojtjen e efektshme të personave të mobilizuar të cilët mund të përballen me rreziqet e jetës ushtarake dhe të parashikojnë procedurat e përshtatshme për të përcaktuar dobësitë dhe gabimet që mund të bëhen në këtë fushë nga individë përgjegjës në shkallë të ndryshme”.

Në këto masa duhet të përfshihet edhe një rregullore për institucionet shëndetësore që janë ngarkuar me ndjekjen nga ana shëndetësore e personave të mobilizuar. Gjykata do të kryejë kontrollin e saj për sa i përket masës së njohjes të rrezikut nga ana e Shtetit dhe masat parandaluese që ai ka mare. Çështja e vetë-dëmtimit është trajtuar në rastin *Fanzyeva v Rusisë* në të cilën u gjet shkelje e detyrimit pozitiv nga Shteti për shkak se një grua, e cila ndërkohë që ishte e ndaluar nga policia, duke qenë se u la e pambikëqyrur në tualet, u hodh nga një dritare e hapur dhe vdiq¹⁸³.

Ky detyrim pozitiv shtrihet përtej fushës së ndalimit penal, dhe në kontekste të ndryshme Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 2, si psh. në rastin e një vetvrasjeje të kryer si kundërpërgjigje ndaj bullizmit (ngacmimit/talljes),¹⁸⁴ apo dështimi për të mbrojtur invalidët në shtëpitë e përkujdesjes për shkak të mungesës së ushqimit apo ngrohjes,¹⁸⁵ apo trajtimi i një burri rom i cili ishte HIV pozitiv, i paaftë mendërisht, që vdiq në një spital psikiatrik për shkak të keq ushqyerjes, mungesës së mjekimit dhe degradimit psikologjik¹⁸⁶.

¹⁸³ Shih çështjen *Fanzyeva v Rusisë*.

¹⁸⁴ Shih çështjen *Pervedentsevy v Rusisë*.

¹⁸⁵ Shih çështjen *Nencheva v Bullgarisë*.

¹⁸⁶ Qendra e Burimeve Ligjore në emër të *Valentin Câmpeanu v Rumanisë*.

3.2.9. Përdorimi i forcës me efekt vdekjeprurës nga agjentët e shtetit

Në rast se pretendohet se humbja e jetës është shkaktuar nga një agjent i Shtetit, GJEDNJ ka përcaktuar se ky fakt duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm,¹⁸⁷ i cili mund të vijë si rrjedhojë e konkluzioneve arsyetuara qartë dhe të provuara'.¹⁸⁸ Megjithatë, kur një individ vdes në burg dhe Shteti dështon të japë një shkak të besueshëm për vdekjen e tij, në mungesë të provave të tjera, konkluzioni mund të jetë që vdekja është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve shtetërore. Gjykata ka trajtuar në mënyrë specifike çështjen e përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e autoriteteve shtetërore. Sipas gjykatës shtetet duhet të kenë përcaktuar dhe miratuar një kuadër ligjor të përshtatshëm dhe administrativ që përcakton, në përputhje me standartet kryesore ndërkombëtare, rrethanat e kufizuara në të cilat oficerëve të zbatimit të ligjit (policëve) u lejohej të përdorin forcën dhe armët e zjarrit¹⁸⁹.

Gjykata ka pranuar Parimet Bazë të OKB mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit,¹⁹⁰ që kërkon *inter alia se* lejohet përdorimi i armëve të zjarrit vetëm në rast se përdorimi i mjeteve më të buta është i pamjaftueshëm për të arritur qëllimin e kërkuar, dhe kur është e jashtëzakonisht e paevitueshme mbrojtja e jetës¹⁹¹.

Në çështjen Elena Apostol dhe të tjerët kundër Romanike që lidhet me çështjen e vrasjes së disa personave gjatë protestave të viti 1989, prokurorët ushtarakë të Bukureshtit, hapën në vitin 1990 një hetim për përdorimin e forcës dhe të heqjes së paligjshme të lirisë

¹⁸⁷ Shih çështjen *Yasa v Turqisë*.

¹⁸⁸ Shih çështjen *Tssechoyev v Rusisë*.

¹⁸⁹ Shih çështjen *Giuliani dhe Gaggio v Italisë*

¹⁹⁰ OKB Doc. A/CONF.144/28/Rev.1

¹⁹¹ Para.9. Shih *Nanchova v Bullgarisë*.

së pjesëmarrësve në demonstratat në ditët e fundit të dhjetorit 1989 kundër regjimit të Causeshikut. Gjykata në vendimin e saj u shpreh se qeveria ka ushtuar në sigurimin e provave që tregojnë se përdorimi i forcës agentët e shtetit ka qenë absolutisht i nevojshëm dhe i pashmangshëm. Hetimi nuk ka pasur një ekzaminimi të plotë, të paanshëm dhe të kujdesshëm të rrethanave vrasjet, e cila është e aftë të çojnë përjashtimin e përgjegjësisë së agentëve të shtetit. Autoritetet duhet të kishin marrë hapa të arsyeshëm për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin në kohe.

Në çështjen Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë, ankuese pretendoi se i afërmi i tyre ishte vrarë nga agentët e shtetit. Më 3 shtator 2008 deri 22 h 15, Z. Reshat Çiçek, u vra gjatë një operacioni ushtarak nisur nga njësia e operacioneve speciale të Xhandarmërisë Juksekova. Në 4 shtator, 2008 u hap hetimi penal në lidhje me çështje dhe sipas raporteve të datës 4 shtator 2008 nga ana e njësive policore të policisë gjyqësore, komandat e xhandarmërisë ishin paralajmëruar se një numër i vogël i PKK (Partia e Punëtorëve të Kurdistanit, një organizatë ilegale të armatosur - e " PKK "), duke përfshirë Diyar, do të kryejë një sulm dhe kishin zënë pritë përgjatë rrugës që lidh fshatin me fshatin Suüstü Büyükçiftlik. Sipas raporteve policore, oficerët e policisë , të cilët ishin pozicionuar poshtë urës në fshatin Suüstü, kishte konstatuar nga fenerët e një makine siluetat e tre njerëzve që kalojnë urën në këmbë. Nga ana e xhandarëve janë dhënë sinjale ndaluese edhe duke i folur personave që të ndalojnë, por ata nuk ndaluan dhe hapën zjarr ndaj policisë. Një nga tre persona raportohet se ka vdekur në vend dhe dy të tjerë thuhet se u larguan drejtimin nga lumë. Ankuesit parashtruan se i afërmi i tyre ishte një bari i thjeshtë dhe ai kurrë nuk e ka ndihmuar militantët e PKK.

Ky pretendim i hodh poshtë nga Qeveria e cila argumentoi se Resat Çiçek ishte pjesë e një grup militantësh të armatosur të PKK të cilët i janë përgjigjur thirrjes së zjarrit hapjes të policisë dhe se ata e qëlluan në vetëmbrojtje.

Gjatë hetimeve dhe nga autopsia ka rezultuar se Resat Çiçek u godit nga plumbat e pushkëve në kokë, gjoks dhe bark, dhe predha kishte arritur organet vitale veç e veç: të trurit, zemra, mushkëritë dhe të mëlçisë. Autopsia zbuloi gjithashtu praninë e tre plagë nga plumbat e kalibrit apo eksplozive breshëri, pesë prej të cilave kanë pasur ndikime të veçanta dhe menjëherë fatale. Ankuesit u ankuan për vrasjen e të dashurit të tyre nga ana e forcave të sigurisë dhe gjithashtu akuzuan autoritetet për dështimin për të kryer një hetim efektiv për vdekjen e saj.

Në lidhje këtë çështje Qeveria argumentoi se në bazë të legjislacionit të brendshëm parashikohej, se nëse sulmi i përdorur ka pasur si qëllim shpatsien e një sulm të paligjshëm kundër tyre atëherë ose është në proporcion me sulmin nuk do të dënohet për tij akt. Pra Ligji autorizon policinë për të përdorur armët e zjarrit gjatë kryerjes së detyrave të tyre, sipas rasteve të parashikuara nga ligji kombëtar për këtë qëllim. Gjithsesi në çdo rast, në bazë të të njëjtit nen, përdorimi i një arme zjarri përfshin tri faza të njëpasnjëshme:

1. agjent i forcave të sigurisë duhet të qëllojnë në shenj paralajmëruese tre herë në ajër,
2. duhet të qëllojnë nga përpara këmbëve të individëve me qëllim zbrapien e tyre dhe në rastin e tretë
3. zjarri do të lejohet vetëm në qoftë se nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të kontrolluar situatën.

Në lidhje me pretendimin e ankuesve se i afërmi i tyre ka qenë viktimë e një sulmi të jashtë ligjshëm Gjykata thekson nevojën për të pasur dëshmi bindëse për gjetjen e një

ekzekutim jashtëligjor dhe jo të bazuar thjesht në hipoteza. Nga ana e ankuesve nuk arrihet të shpjegohet prezenca e të viktimës në natën e ngjarjes në vendin e ngjarjes, nëse ai nuk do të ishte pjesë e sulmit. Për këtë arsye, përpara këtyre dëshmive dhe në mungesë të dëshmive, Gjykata e konsideron si spekulim pretendimin se viktima ka qenë viktimë e një ekzekutim jashtëligjor nga agjentët e qeverisë. Ankuesit u ankuan për një dështim të hetimit të kryer nga prokurorët. Ata argumentojnë në këtë drejtim se autopsia e trupit të afërm të tyre nuk ishte i plotë dhe se disa dëshmitarë shtesë nuk janë dëgjuar. Ky pretendim u kundërshtua nga qeveria me argumentin se prokuroria ka kryer një hetim të plotë dhe të detajuar për vërtetimin e fakteve. Gjykata pranoi se policia besonte në mirëbesim, duke marrë parasysh informatat dhe udhëzimet që kishte marrë, se personat ishin të armatosur dhe më rrezikshmëri të lartë. Në përputhje me udhëzimet e eprorëve të tyre, policia për këtë arsye ka përdorur forcë vdekjeprurëse duke e vlerësuar si absolutisht e nevojshme. Në këto kushte Gjykata vendosi unanimisht se ka pasur një shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural por nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës dhe as të nenit 14 të pretenduar nga palët ankuese.

Një tjetër çështje në të cilën është konstatuar vrasja nga agjentët e shtetit por në të cilin Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 2 sepse agjenti i shtetit nuk ishte në detyrë në momentin e realizimit të krimit, dhe për rrjedhojë i dyshuar IS u dorëzua në polici duke dhënë dhe dëshminë e tij për rastin në fjalë nga ku më vonë u mbajt në dhomat e paraburgimit. Ndaj punonjësit IS filloj një procedim penalë i cili e gjeti fajtor, në bazë dhe të dëshmive të marrë gjatë procesit, për vrasjen e MN-së duke e dënuar me 14 vjet burgim.

Shteti duhet të argumentoi në momentin që disa nga agjentët e tij janë të përfshirë në rastin e vdekjes së një individi që ka vepruar në proporcion me rëndësinë e shkeljes dhe

për arritjen e një qëllimi të ligjshëm¹⁹². Në çështjen Dalakov kundër Rusisë ku u vra z Apti Dalakov nga ana e disa oficerët e Departamentit të Shërbimit të Sigurimit Federal, shteti nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se vrasja e kryer nga agjentët nuk ishte në proporcion më normat e legjislacionit të brendshëm. Gjatë hetimit janë mbledhur informacione kontradiktore dhe autoritetet vendase, duke përfshirë komitetin hetues, departamentin e hetimeve ushtarake dhe Gjykatën e Rrethit Karabulak, nuk arritën të demonstrojnë një përgjigje e duhur ndaj akuzave të përdorimit të papërshtatshëm të forcës vdekjeprurëse nga agjentët e shtetit. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin proceduralë të tij. Nga dokumentet e dorëzuara nga Qeveria duket se nuk janë marrë masat e duhura nga agjentët e shtetit me qëllim të ruajtjes së jetës së z Apti Dalakov. Në përfundim Gjykata konstaton dhe mungesën e kujdesit të shfaqet në menjëherë pas incidentit, ku agjentët e FSB bënë rezistencë duke mos u dhënë shpjegime punonjësve të policisë, dhe duke provokuar një përleshje e cila degradoi në përdorimin e forcës fizike kundër tyre. Sa më sipër Gjykata arrin në përfundimin se veprimet e autoriteteve në lidhje me planifikimin, kontrollin dhe realizimin e operacionit nuk ishin të mjaftueshme për të mbrojtur jetën e z Apti Dalakov. Autoritetet nuk mori masa të arsyeshme në dispozicion të tyre për të parandaluar vdekjen e nipit të aplikantit.

Në një çështje tjetër të gjykuar nga GJEDNJ-ja është konstatuar dhuna dhe privimi i jetës së një individi të realizuar nga agjentët e shtetit. Në çështjen Khachukayevy kundër Rusisë ankuesit pretenduan se i afërmi i tyre ishte rrëmbyer dhe vrarë nga ushtarakët Shtetit në Çeçeni. Z. Islami Deniyev me miqtë e tij Mr sayd-Akhmed S. dhe Z. Khizir A. U

¹⁹² Shih çështjen *Nanchova v Bullgarisë*, par. 5.

ndaluan në 24 nëntor 2000 nga forcat ushtarake kur po udhëtonin me makinën e tyre Toyota në një nga postblloqe e krijuara nga ushtria në autorstrasde dhe u dërguan në selinë e njësisë ushtarak në fshatin Tangi-Chu. Gjykata konfirmon se pasi është vërtetuar se zoti Islami Deniyev u arrestua nga agjentët e shtetit, pa bazë ligjore shprehet se kjo përbën një shkelje të veçantë të rëndë të së drejtës së lirisë dhe sigurisë së personit mishëruar në nenin 5 të Konventës¹⁹³.

Në këto kushte Gjykata ka konstatuar se zoti Islami Deniyev u vra pas ndalimit të tij nga ana e ushtarakëve të shtetit dhe se vdekja e tij mund t'i atribuohet shtetit. Në mungesë të ndonjë arsytim të paraqitur nga Qeveria, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin material.

3.2.10. Detyrimi për të mbrojtur jetën në rrethana të tjera (*mbrojtja kundrejt rreziqeve mjedisore*)

Detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën, në rrethana të caktuara mund të kërkojë që Shteti të mbrojë jetën e individëve të caktuar nga kërcënime të identifikuar. Në përditshmëri, këto kërcënime mund të vijnë nga individë të tjerë, rreziqe mjedisore¹⁹⁴ apo madje edhe nga vetvetja. Për shembull, në një çështje në lidhje me rreziqet mjedisore që përfshinte asbestin, Gjykata konstatoi se dështimi për të mbrojtur dhe informuar individët lidhur me rrezikun¹⁹⁵ që u kanosej cenoi të drejtën për të jetuar (Kroff, 2006: 88).

¹⁹³ Shih, për shembull, *Imakayeva*, cituar më lart, § 178, *Aslakhanova dhe të tjerë*, cituar më lart, § 134, dhe *Ireziyevy kundër Rusisë*, nr.. [21135/09](#), § 90, 2 prill 2015.

¹⁹⁴ Shih çështjen *LCB v UK; Oneryildiz v Turqisë*.

¹⁹⁵ Shih çështjen *Brincat kundër Maltës*.

Në jurisprudencën e GJEDNJ-së gjejmë disa çështje në lidhje me problemet mjedisore që pretendoheshin se ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale që mbrohen nga Konventa, duke përfshirë të drejtën për jetën. Çështja e parë e rëndësishme ku hyri në veprim shprehimisht e drejta për jetën përpara organeve të Konventës është *Guerra kundër Italisë*¹⁹⁶, ku Komisioni dhe Gjykata kanë pasur këndvështrime të ndryshme në lidhje me nenet që duheshin zbatuar. Kjo çështje trajtonte kërkesat e parashtrua nga një numër kërkuesish që jetonin në Manfredonia, pranë një fabrike që lëshonte sasi të mëdha substancash toksike. Mbetjet e fabrikës shpesh kanalizoheshin drejt banesave të tyre, por edhe për këtë arsye kishte ndodhur një aksident i rënde ku rreth 150 njerëz u detyruan të shtroheshin në spital për shkak të helmimit akut nga arseniku. Komisioni në këtë çështje vendosi të pranoi kërkesën e ankuesve vetëm në lidhje me pretendimet e nenit 10 dhe në bazë të këtij neni, kërkuesit që banonin në një zone me rrezikshmëri të lartë, kishin të drejtën për të marre “*informacion të sakte për çështjet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit të tyre*”¹⁹⁷.

Gjykata ishte i kundër nga ai i Komisionit duke u shprehur se kishte juridiksion për të shqyrtuar çështjen në bazë të Neneve 8 dhe 2 të Konventës, si dhe në baze të Nenit 10. Gjykata u shpreh se Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1087 (1996) është e një rëndësie të veçantë si një dokument i Këshillit të Evropës për çështjen në fjalë sepse ka lidhje me pasojat e fatkeqësisë së Cernobilit. Kjo rezolute u adoptua me 26 prill 1996. Dhe në të

¹⁹⁶ Shih çështjen *Guerra dhe të Tjerë kundër Italisë*, vendimi i 19 shkurtit 1998. Një çështje e hershme, *Lopez Ostra kundër Spanjës*, vendimi i 24 nëntorit 1994, kishte të bënte me shqetësimet e shkaktuara nga një depozitë e trajtimit të mbetjeve që ndodhej pak metra larg shtëpisë së kërkuesit, dhe aty u argumentua dhe u vendos vetëm në bazë të Neneve 8 dhe 3 të Konventës, pa iu referuar Nenit 2 në procedurat në Strasburg (megjithëse e drejta për jetën ishte ngritur për trajtim në procedurat vendase).

¹⁹⁷ *Guerra*, Raporti i Komisionit i 25 qershorit 1996. Dy anëtarët e Komisionit që kundërshtuan menduan se çështja duhej trajtuar në bazë të Nenit 8.

deklarohet se “aksesi publik për informacion te qarte e te plote [për rreziqe te tilla]... duhet te konsiderohet si një e drejte themelore e njeriut”.¹⁹⁸ Neni 2 u përfshi për herë të parë nga Gjykata çështjen L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar¹⁹⁹.

Vajza e një burri i cili kishte qene në Forcat Ajrore Britanike në vitet 1950, dhe gjatë kësaj periudhe ishte ekspozuar ndaj rrezatimit të shkaktuar nga testet bërthamore të kryera në 1957 dhe 1958. Vajza kishte lindur në 1966 u diagnostikua se kishte leucemi në vitit 1970 dhe iu nënshtrua trajtimit intensiv të cilat e rënduan mjaftë jetës e saj²⁰⁰.

Vajza pretendoi se shkaku i sëmundje së saj ishte ekspozimi i të atit ndaj rrezatimeve bërthamore. Ajo pretendo se shteti kishte dështuar në paralajmërimin dhe këshillimin e prindërve të saj për rrezikun e këtyre rrezeve me qëllim monitorimin e shëndetit të saj përpara diagnostikimit me leucemi, dhe në këto kushte kishte shkelje të nenit 2 të Konventës.²⁰¹ Gjykata pasi analizoi çështjen në bazë të këtij neni parashtroi se autoritetet mund të kishin besuar në mënyrë të arsyeshme në atë kohe se i ati i kërkueses nuk ishte dëmtuar në mënyrë të rrezikshme për jetën²⁰², dhe nuk ishte përcaktuar lidhja

¹⁹⁸ Vendimi tek *Guerra*, paragrafi 34.

¹⁹⁹ *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 qershorit 1998. Shih gjithashtu çështjen e *Oneryildiz kundër Turqisë*, të trajtuar në vijim. Vëreni gjithsesi se çështjet mjedisore mund të trajtohen edhe duke u bazuar në nene të ndryshme të Konventës: çështja e *Taskin dhe të Tjerë kundër Turqisë*, vendimi i 10 nëntorit 2004, në të cilën Gjykata konstatoi shkelje të Neneve 8 dhe 6 të Konventës në lidhje me ndotjet e rrezikshme të shkaktuara nga një minierë ari, por në të cilën u shpreh e ishte e “domosdoshme” që çështja të shqyrtohej duke u bazuar në Nenit 2 dhe 13.

²⁰⁰ Shih vendimin *L.C.B.*, paragrafët 12 – 16.

²⁰¹ Vendimi *L.C.B.*, paragrafi 36. Kërkuesi gjithashtu pretendoi shkelje të Nenit 3, por kjo nuk ishte çështja kryesore sipas gjykimit të Gjykatës. Shih paragrafin 24 të vendimit. Gjithashtu, kërkuesi parashtroi se personeli i shërbimit ishte ekspozuar qëllimisht ndaj rrezatimit për qëllime eksperimentimi dhe se ekspozimi i të atit ndaj rrezatimit nuk ishte monitoruar, por Gjykata u shpreh se nuk mund të shqyrtohej këto pretendime për shkak të deklaratave të bëra nga Mbretëria e Bashkuar që kufizoi juridiksionin e përkohshëm të Gjykatës (para. 35; për vetë deklaratat, shih para. 20). Kërkuesi pretendoi edhe se i ishte nënshtruar ngacmimeve dhe mbikëqyrjes në shkelje të Nenit 8, por edhe kjo gjë nuk luajti ndonjë rol në gjykim.

²⁰² Po Aty, paragrafi 37.

midis ekspozimit të një rrezatimit dhe leucemisë në një fëmijë të ngjizur në vijim²⁰³, dhe për rrjedhojë ata nuk mund të njoftnin prindërit e saj për këto çështje me iniciativën e tyre, apo të ndërmerrnin ndonjë hap tjetër të posaçme në lidhje me të²⁰⁴. Për këto arsye nuk ka pasur shkelje të Nenit 2.

Cavit Tinarlioğlu kundër Turqisë ka të bëjë me një aksident detar që i ka ndodhur z Tinarlioğlu gjatë pushimeve në Turqi. Më 4 gusht 1998 ai u godit nga një nga një anije për përdorim nga ana e qendrës turistike, në kohën që ishte duke notuar. Ai u shoqërua menjëherë në spitalin e Bodrumit ku iu nënshtua disa operacioneve dhe nga diagnoza e dhënë nga ana e mjekëve pacientit do ti duheshin deri në 10 muaj minimumi që të rehabilitohej. Në 5 qershor 2000, ankuesi u ekzaminua në spitalin Haydarpasa Numune me qëllim vlerësimin e shkallës së paaftësisë e cila u konsiderua në masën 45%. Një ditë pas aksidentit, përfaqësuesi i aplikantit ka bërë një kërkesë për njohjen e provave në Gjykata e Bodrumit. Në 6 gusht 1998 një ekspert i ngarkuar për të kryer hetimet në Club M, së bashku me avokatët dhe dëshmitarët në vendin e aksidentit. Në raportin e përgatitur nga ai eksperti arriti në përfundimin se ka qenë i pakujdesshëm dhe të pavëmendshëm në kohën e incidentit duke notuar në një zonë që ishte me rrezikshmëri sepse përshkohej pikërisht nga mjete motorike dhe anije për sporte ujore. Në bazë të Direktivës Nr:04/ 386 e 4 shtator 1998 në lidhje me sigurinë dhe funksionimin e mjeteve të sporteve ujore, parashikohet se anijet e përdorura për sportet e ujore mund të lundrojnë brenda jo më afër se 200 m nga bregdeti dhe shpejtësia e lejuar është jo më shumë se 3 nyje. Kërkuesi pretendon se ka shkelje të të drejtës së jetës e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 2 të

²⁰³ Vendimi *L.C.B.*, paragrafi 39.

²⁰⁴ Po Aty, paragrafi 41.

Konventës. Ankuesi argumenton se shtet nuk arriti të marrë të gjitha masat për të garantuar sigurinë e njerëzve në bregdet duke kryer kontrole efektive të aktiviteteve të ujit të kryera atje dhe për këtë arsye është përgjegjës për aksidentin që ndodhi, duke përbërë një rrezik real edhe për personat e tjerë. Sipas aplikantit Club M kishte autorizim për të organizuar turizëm sportiv por duhej që të monitorohej përdorimi i kësaj lejeje nga ana e autoriteteve. Gjykata nga analizimi i të gjitha fakteve të paraqitura konstaton se nuk ka shkelje të nenit 2 të Konventës.

Në çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*²⁰⁵, Gjykata shqyrtoi në mënyrë të ndarë dy aspektet e Nenit 2, thelbin dhe procedurën. Në aspektin e parë e parë, Gjykata i kushtoj rendësi informacionit që i duhej dhënë publikut dhe që ndikon individët në lidhje me rreziqet e mjedisit. Gjykata i vuri theksin konventave dhe rekomandimeve të ndryshme të Këshillit të Evropës në këtë fushë. Çështja u paraqit në Gjykatë nga kreu i një familjeje që kishte jetuar në banesa në zona të varfra pranë një pike grumbullimi të vendosur nga bashkia në Umraniye ne Stamboll²⁰⁶.

Në vitin 1991, një raport ekspertesh konstatuan se vendi ku ndodhej kjo pike grumbullimi binte në kundërshtim me rregulloret përkatëse dhe krijonte një rrezik të madh për shëndetin e banoreve të luginës, veçanërisht të atyre që jetonin në zonat e varfra sepse përbënë rrezik për të marrë sëmundje ngjitëse dhe rrezik shpërthimi metani. Nga ana e Këshilli Bashkiak u kundërshtua kërkesat e kryetarit të bashkise lokale duke kërkuar urdhër

²⁰⁵ Shih çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 30 nëntorit 2004 (vendimi i Dhomës i rishikuar nga Dhoma e Madhe doli në 18 qershor 2002).

²⁰⁶ Fillimisht, çështja u parashtua nga Z. Cinar, por çështja ë këtij të fundit u trajtua vecmas nga çështja e Z. Oneryildiz (vendimi, para. 3). Z. Oneryildiz, teknikisht edhe i vetmi kërkues i mbetur, nuk veproi vetëm në emër të tij, por edhe në emër të të tre djemve të tij që kishin mbijetuar, Husamettin, Ayfin dhe Halef Oneryildiz, që ishin minoren në atë kohë, dhe gjithashtu në emër të të afërmeve të tij të vrarë në aksident të cilët ishin dhe epiqendra e çështjes: gruaja e tij, Gulnaz Oneryildiz, konkubina e tij, Sidika Zorlu, dhe fëmijët e tij, Selahattin, İdris, Mesut, Fatma, Zeynep, Remziye dhe Abdulkерim Oneryildiz.

mbylljeje për piken e grumbullimit të plehrave²⁰⁷. Në 28 prill 1993 ndodhi një shpërthim metani në vend duke shkaktuar rrëshqitje dheu. Pjesa e shkrire e mbetjejeve nga mali mbuloji rreth dhjete banesa të varfra që ndodheshin poshtë tij, duke përfshirë atë të kërkuarit. Nga aksidenti humben jetën 39 veta duke përfshirë edhe gruan e kërkuarit dhe shtate nga dhjete fëmijët e tij²⁰⁸.

Nga hetimi rezultoi se zyrtaret ishin përgjegjës për “*neglizhence në kryerjen e detyrave të tyre*”, dhe jo për vdekje të dënueshme. Kërkuari parashtroi se autoritetet kombëtare ishin përgjegjëse për vdekjet e të afërmeve të tij të ngushte dhe për shkatërrimin e pronës së tij, si rezultat i shpërthimit të metanit në prill 1993 në piken e grumbullimit të plehrave. Gjykata në vendimin e dhënë në lidhje me këtë çështje u shpreh se Neni 2 parashtroi një detyrim pozitiv për Shtetet që të marrin hapat e duhura në mbrojtje të jetës së personave që ndodhen brenda juridiksionit të tyre²⁰⁹.

Gjykata u shpreh se detyrimi pozitiv për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të mbrojtur jetën për qëllimet e Nenit 2 kërkon mbi të gjitha një detyrim kryesor për Shtetin për të krijuar një kuadër legjislativ dhe administrativ me qëllim sigurimin e parandalimit efektiv kundrejt kërcënimeve ndaj të drejtës për jetën.

²⁰⁷ Vendimi i Dhomës së Madhe *Oneryildiz*, para. 16.

²⁰⁸ Po Aty, para. 18.

²⁰⁹ Po Aty, para. 71, duke iu referuar çështjeve të *L.C.B.* (të trajtuar me siper) dhe *Paul dhe Audrey Edwards* (të trajtuar në titullin vijues). Në lidhje me “veprimtaritë e rrezikshme” Gjykata shton një reference, në kllapa, për standardet evropiane që vërejtë me pare, pra.: Rezolutat PACE 587 (1975) në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me shkarkimin e mbetjejeve urbane dhe industriale, dhe 1087 (1996) në lidhje me pasojat e fatkeqesive se Cernobilit, Rekomandimi PACE 1225 (1993) për menaxhimin, trajtimin, riciklimin dhe tregtimin e mbetjejeve, Rekomandimi R, COM (96) 12 për shpërndarjen e kompetencave dhe përgjegjësitë midis autoriteteve qendrore dhe lokale e rajonale përsa i përket mjedisit, Konventa e Luganos e vitit 1993 për Përgjegjësitë Civile në lidhje me Demet që rezultojnë nga Veprimtaritë e Rrezikshme ndaj Mjedisit, Konventa e Strasburgut e vitit 1998 për Mbrojtjen e Mjedisit nepermjet të Drejtës Penale, Vendimi Kuader i Keshillit të Bashkimit Evropian nr. 2003/80 i 27 janarit 2003 dhe propozimi i Komisionit Evropian i 13 marsit 2001, i amenduar me 30 shtator 2002, për një direktivë mbi mbrojtjen e mjedisit nepermjet të drejtës penale (shih paragrafet 59 dhe 60 të vendimit).

Ky detyrim pa dyshim zbatohet në kuadrin e veçantë të veprimtarive të rrezikshme, ku duhet vene një theks i veçante në rregulloret e hartuara për tiparet specifike të veprimtarisë në fjalë, e veçanërisht në lidhje me nivelin e risqeve të mundshme ndaj jetës së njeriut. Ndërmjet këtyre masave parandaluese i duhet vene theks i veçante të drejtës së publikut për informacion, siç është përcaktuar në precedentin e institucioneve të Konventës. Detyra e Gjykatës pra konsiston në rishikimin e faktit se deri në çfarë mase mund të konsiderohen zbulimet e gjykatave në marrjen e vendimeve, dhe nëse i kushtojnë çështjes vëmendjen dhe mbikëqyrjen e duhur siç parashikohet nga Neni 2 i Konventës me qëllim që efekti parandalues i sistemit gjyqësor ekzistues dhe rëndësia e rolit që kërkohet të luajë në parandalimin e shkeljeve të së drejtës për jetën temos minohen²¹⁰. Në lidhje me çështjen Gjykata konstatoi se autoritetet turke në nivele të ndryshme ishin dhe duhet të kishin qenë në dijeni se ekzistonte një rrezik real apo i menjëhershëm për jetën dhe shëndetin e njerëzve që banonin pranë grumbullit të plehrave, por, ose nuk kishin marre masat e duhura, ose madje kishin kundërshtuar adoptimin e masave të nevojshme urgjente²¹¹.

Në përfundimi në këtë çështje se ka shkelje të Nenit 2 të Konventës edhe në aspektin e tij procedural për shkak të mungesës në lidhje me një aksident fatal të provokuar nga punimet në një veprimtari të rrezikshme, të mbrojtjes së duhur “me ligj” për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe për të parandaluar situata të tilla të rrezikshme për jetën në të ardhmen²¹².

²¹⁰ *Vendimi i Dhomes se Madhe Oneryildiz*, paragrafet 94 – 96. Shih edhe paragrafet pararendes. Referencat në kllapa për çështjet e tjera dhe për paragrafet e tjera në vendim hiqen sipas udhëzimeve.

²¹¹ Po Aty, paragrafët 97 – 103.

²¹² Po Aty, paragrafët 117 – 118.

Mos-adoptimi i rregulloreve për çështjet mjedisore, si për shembull, pikat e grumbullimit të plehrave, që të jenë në përputhje me standardet evropiane do të thotë që Shteti në fjale nuk arrin të mbrojë të drejtën për jetën “me ligj” siç parashikohet nga Neni 2.

3.3. Elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës

Elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës janë e drejta për të vdekur dhe e drejta e fetusit për të jetuar. E drejta për të jetuar lidhet edhe me të drejtën për të vdekur dhe eutanazinë, megjithëse Gjykata ka thënë se nuk është e mundur të deduktosh të drejtën për të vdekur nga e drejta për të jetuar.²¹³ Çështja kryesore ku u trajtua kjo gjë është *Pretty v Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i cili u trajtua gjerësisht tek pjesa e eutanazisë.. Aplikantja vuante nga një sëmundje e sistemit nervor motorik dhe ndaj nuk ishte në gjendje t’i jepte fund jetës. Ajo dëshironte që bashkëshorti i saj ta ndihmonte për t’i dhënë fund jetës, gjë që ishte e ndaluar nga ligji anglez. Gjykata nuk gjeti shkelje as të Nenit 2 dhe as të Nenit 3, kur autoritet refuzuan t’i garantonin bashkëshorti të saj mos-fillimin e ndjekjes penale.

Ndërsa në *Lambert v France*, çështja ishte nëse vendimi i mjekut për të hequr trajtimin mjekësor shkelte Nenin 2. Kjo çështje u shtrua nga familja e një tetraplegjiku, që kundërshtonte vendimin e Conseil de-État Francëz (Këshilli i Shtetit Francez) i cili e kishte përcaktuar si të ligjshëm vendimin e mjekut. Për shkak të mungesës së vullnetit të Shtetit për çështjen, Gjykata përcaktoi se është në hapësirën e vlerësimit të Shtetit për të përcaktuar ligje që lejojnë heqjen e trajtimeve që e mbajnë në jetë një person. Në vazhdim, Gjykata gjeti se për shkak të çështjeve komplekse mjekësore, ligjore dhe etike të ngrituara,

²¹³ Shih çështjen *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

ishite fillimisht detyrë e autoriteteve të brendshme të verifikonin nëse vendimi për heqjen e trajtimit ishte apo jo në përputhje me legjislacionin e brendshëm (Kroff,2006: 108).

Gjykata gjeti se si kuadri ligjor që rregullon trajtimin mjekësor në fund të jetës së personit, ashtu edhe procesi specifik i vendimmarrjes, ishin në përputhje me detyrimet pozitive që rrjedhin nga Neni 2. Po ashtu, edhe aborti mund të ngrejë çështje të së drejtës për të jetuar. Gjykata ka kërkuar të shmangë këtë çështje, duke vendosur që ‘nuk është as e dëshirueshme dhe as e mundur t’i përgjigjet pyetjes nëse fetusi është ose jo person në kuptimin e Nenit 2 të Konventës’²¹⁴.

Në thelb, kjo është një çështje që Gjykata ia ka lënë për zgjidhje autoriteteve të kombëtare²¹⁵. Në rastin e fëmijëve të palindur, Gjykata ka vendosur se përcaktimi i momentit se kur fillon jeta, bie në hapësirën e vlerësimit të Shteteve, gjithashtu nuk ka as një pikëpamje të unifikuar në Evropë për mbrojtjen ligjore të tyre, dhe as një përcaktim shkencor dhe ligjor të momentit kur fillon jeta²¹⁶.

E drejta për jetë e fetusit. Para Gjykatës u shtrua pyetja se nga cili moment duhej mbrojtur jeta, nga dispozitat e Konventës, dhe nëse neni 2 i saj, si dhe detyrimet pozitive që lidhen me të, mund të zbatoheshin për fetusin. Kjo çështje u shqyrtua dhe, u zgjidh, në vendimet *Bosco kundër Italisë* dhe *Vo kundër Francës*. Çështja e parë kishte të bënte me ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë sipas nenit 2. E dyta ishte më e ndërlikuar. Shtrohej pyetja atëherë se nëse dispozitat e të drejtës penale franceze që zbatohen në rastin e një gabimi mjekësor i cili ka si pasojë ndërprerjen e padëshiruar të shtatzënisë, ishin në përputhje me kërkesat e Konventës. Si përfundim, Gjykata duhet të shprehej nëse

²¹⁴ Shih çështjen *A,B,C, kundër Irlandës*.

²¹⁵ Shih çështjen *Tysiç kundër Polonisë, R.R. v Polonisë*.

²¹⁶ Shih çështjen *Vo kundër Francës*.

ndërprerja e shtatzënisë, kur kjo imponohet nga rrethanat, mund të konsiderohet si një cenim i së drejtës për jetë të fetusit. Në të dy rastet, ajo refuzoi të dalë në konkluzione duke vlerësuar se përcaktimi i fillimit të jetës ka të bëjë, duke pasur parasysh ndryshimin e koncepteve dhe kulturave juridike që mbizotërojnë në Europë, me hapësirën e vlerësimit të Shteteve, pra të juridiksionit të brendshëm, duke e cilësuar atë si pushtet të gjerë të pakufizuar. E thënë ndryshe, në konditat e sotme të së drejtës, fetusi nuk mund të konsiderohet, sipas Konventës, si një person juridik i mbrojtur dhe për të cilin Shteti do të duhej të merrte përsipër detyrime. Por, është shumë kurioz fakti se ky konstatim nuk e pengoi gjykatësin europian të shqyrtojë paditë për mosrespektim të detyrimeve me karakter procedural që rrjedhin po nga neni 2 i Konventës. Këtu nuk kemi një inkoherencë të jurisprudencës.

KAPITULLI IV: ASPEKTET PROCEDURALE TË NENIT 2 TË KEDNJ

4.1. Aspektet e mbrojtjes procedurale që ofron KEDNJ për mbrojtjen e jetës

E drejta për jetuar është një e drejtë thelbësore dhe e pashmangshme. Pa të drejtën e jetës është e pamundur të gëzohen të drejtat e tjera. Ashtu si mbrojtja nga tortura, e drejta për të jetuar përbën një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike dhe kuptimi i saj duhet përcaktohet duke mbajtur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte. Për rrjedhojë, dispozitat që garantojnë atë duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë dhe strikte. Përparësia së drejtës për të jetuar është rinjohur në mënyrë të vazhdueshme nga agjensitë, gjykatat dhe tribunalet ndërkombëtare. Kjo ka ndodhur veçanërisht në rastin kur agjensitë e zbatimit të ligjit kanë kryer përdorim të tepruar forcës²¹⁷.

Në aspektin procedural të nenit 2 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja kërkon që shtetet të kryejnë një hetim efektiv në lidhje me vdekjet që ndodhin në kundërshtim të legjislacionit vendas. Detyrimi që ligji të mbrojë jetën e të gjithëve përfshin një aspekt procedural përmes së cilit rrethana e heqjes së jetës t'i nënshtrohet një hetimi të pavarur dhe publik.²¹⁸ Vrasja e qëllimshme duhet të jetë objekt i sanksioneve penale, po ashtu edhe vrasjet nga pakujdesia të cilat rezultojnë nga përdorimi i forcës në rrethana që nuk justifikohet përdorimi i tyre. Kur vdekja shkaktohet nga pakujdesia, ajo duhet t'i nënshtrohet sanksioneve penale, që varen pjesërisht nga rrethanat e vdekjes. Për të parandaluar, dënuar dhe për të penguar kryerjen e veprave që privojnë njerëzit nga jeta e tyre duhet të miratohen ligje penale efektive. E drejta e brendshme duhet gjithashtu të rregullojë rastet kur lejohet përdorim i

²¹⁷ Kjo del qartë në çështjen *Guerrero v Kolumbisë* (Komiteti i të Drejtave të Njeriut), që ka të bëjë me përdorimin e tepruar të forcës nga një policia Kolumbiane që solli pasojë vdekjen e shtatë personave për të cilët nuk u provua se kishin lidhje me ndonjë veprë penale të kryer.

²¹⁸ Shih çështjen *McCann v MB*; *Yasa v Turqisë*; *Gulec v Turqisë*; *Ergi v Turqisë*.

forcës vdekjeprurëse nga funksionarët e shtetit. Ligjet përkatëse të projektuara për të mbrojtur jetën duhet të jenë praktikë, efektive dhe duhet të zbatohen, edhe pse autoritet e ndjekjes penale kanë një shkallë diskrecioni për të përcaktuar nëse do të ushtojnë ndjekjen penale. Megjithatë, kjo shkallë diskrecioni nuk duhet të ushqejë kulturën e pandëshkueshmërisë tek zyrtarët e zbatimit të ligjit. Për rrjedhojë një vendim i marrë nga organet shtetërore për të mos ndjekur penalisht ose për të mos kryer një hetim të përshtatshëm, do të ngrejë çështje lidhur me të drejtën për të jetuar;²¹⁹ Në rastin kur vendimi për pafajësinë e një personi është bazuar mbi një mbrojtje ligjore e cila ka qenë jashtë kuadrit të argumenteve të pranuar për përdorimin e forcës vdekjeprurëse, kjo do të përbënte një shkelje të së drejtës për të jetuar;²²⁰ dhe shteti ka detyrimin që të ndëshkojë zyrtarët shtetërorë që vrasin në mënyrë të paligjshme. Një shpërpjesëtim i qartë ndërmjet rrezikshmërisë së sjelljes së paligjshme dhe ndëshkimit të vendosur më pas do të shkelte të drejtën për të jetuar²²¹.

Në aspektin procedural karakterizohet nga disa standarde e bëjnë atë të jetë i besueshëm dhe që mund të konsiderohet si provë në një proces gjyqësorë, dhe këto karakteristika janë:

- a. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik*
- b. Hetimi duhet të jetë i plote dhe rigoroz*
- c. Hetimi duhet të jetë i tillë që të përcaktojë përgjegjësinë e vdekjes*
- d. Shpejtësia e autoriteteve në hetim*
- e. Domosdoshmëria e një hetimi expost*

²¹⁹ Shih çështjen *Jordan v MB; Oneryildiz v Turqisë; Fanziyeva v Rusisë*.

²²⁰ Shih parashikohet në Nenin 2(2) të KEDNJ.

²²¹ Shih çështjen *Bektas kundër Turqisë*.

f. Mundësia e marrjes pjese të të afërmeve në procedure

Detyrimi i hetimit të një vdekje duhet të realizohet edhe kryesisht nga ana e autoriteteve shtetërore pa paraqitjen e një kërkesë formale nga ana e individëve të caktuar, pra edhe thjesht marrja në dijeni nga ana e autoriteteve mbi një vrasje lind detyrimin për të kryer një hetim efektiv.²²² Në rastet kur nga ana e ankuesve pretendohet që është shkelur e drejta e jetës, Gjykata vlerëson rrethanat e çështjes për të vlerësuar efikasitetin e hetimeve. Në vijim do të analizojmë disa nga karakteristikat me karakter procedural që formojnë besueshmërinë e hetimit.

4.1.1. Hetimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur publik

Hetimi i çështjes duhet të realizohet nga një organ publik i pavarur. Është tejet e rëndësishme çështja e pavarësisë së institucioneve publike në procesin e hetimit. Me institucion të pavarur publik nënkuptojmë mungesën e hierarkisë së institucionit përgjegjës për realizimin e hetimeve nga organet më të larta shtetërore. Kjo pavarësi merr një kuptim më të rëndësishëm nëse në çështjen në të cilin po hetohet janë të implikuar vetë institucionet shtetërore. Kështu në çështjen Elena Apostol dhe të tjerët kundër. Romanis, ankuesit, pretendonin se nuk ka pasur hetim efektiv në shtypjen e dhunshme të demonstratave anti-qeveritare në dhjetor të vitit 1989, në të cilën të afërmit e tyre ishin vrarë. Në lidhje me çështjen e vrasjes së disa personave gjatë protestave të viti 1989, prokurorët ushtarakë të Bukureshtit, hapën në vitin 1990 një hetim për përdorimin e forcës dhe të heqjes së paligjshme të lirisë së pjesëmarrësve në demonstratat në ditët e fundit të dhjetorit 1989 kundër regjimit të Causeshikut. Më 18 tetor 2010, zyra e prokurorit ushtarak

²²² Shih çështjen *Ergi kundër Turqisë, Luluyev kundër Rusisë Luluyev*, 9 nëntor 2006, par.90 -101.

në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë vendosi për të mos vazhdimin e një procedimi penale në lidhje me aktet e kryera nga ushtria, duke thënë se kërkesat e ankuesve kanë qenë pjesërisht të pabazuar. Ankuesit u ankuan se hetimet penale të hapur nga ana e autoriteteve në vitin 1990 në ngjarjet e dhjetorit 1989 kishte qenë i paefektshëm. Ata pretenduan se shteti i paditur nuk ishte në përputhje me kërkesat procedurale të nenit 2 të Konventës²²³.

Gjykata në vendimin e saj u shpreh se detyrimi procedural i imponuar nga Neni 2 kërkon një hetim efektiv që duhet të kryhet aty ku përdorimi i forcës, sidomos nga agjentët e shtetit, ka rezultuar në humbjen e jetës njerëzore. Kjo përfshin kryerjen e një ekzaminimi të plotë, të paanshëm dhe të kujdesshëm të rrethanave vrasjet, e cila është e aftë të çojnë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës. Autoritetet duhet të kishin marrë hapa të arsyeshëm për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin në kohe. Gjykata u shpreh se është e domosdoshme që personat përgjegjës që kryejnë hetimet të jenë të pavarura, që do të thotë jo vetëm një mungesë të lidhjes hierarkike apo institucionale, por edhe pavarësisë praktike. Për më tepër, një përgjigje të shpejtë nga ana e autoriteteve është thelbësor në ruajtjen e besimit të publikut në respektimin e tyre ndaj sundimit të ligjit. Pavarësia e institucionit nuk kemi vetëm kur mungon lidhja hierarkike e institucioneve, pavarësi duhet të ketë edhe në aspektin praktik të çështjes. Gjykata thekson se nëse një gjykatë do të konsiderohet e pavarur", duhen plotësuar këto kushte. Së pari, gjykata duhet të jetë subjektive dhe pa paragjytime. Së dyti, ajo duhet të jetë e paanshme nga këndvështrimi objektiv, pra duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt. Gjykata vlerëson arsyetimin e Qeverisë që sistemi i hetimit është i paanshëm, por nga ana

²²³ Shih çështjen *Apostol dhe të tjerët kundër Rumanisë*.

tjetër nuk mund të mos marrë në konsideratë dhe të bazohet te fakti që hetimi ka filluar në vitin 1990 dhe ka zgjatur deri në vitin 2004, ndërkohë që ngjarja ka ndeshur në vitin 1989, dhe që hetimet në ngjarjet e dhjetorit të vitit 1989 janë kryer nga prokurorët ushtarakë të cilët, në bazë të legjislacioni në fuqi në atë kohë, ishin në një marrëdhënie të varësisë në kuadër të hierarkisë ushtarake. Pra Gjykata konstaton një zgjatje të tepruar të hetimeve dhe mungesë të përfshirjes së të afërmeve të viktimave në procedurë, si dhe mungesë të informacionit për publikun në lidhje me ecurinë e hetimeve. Gjykata vëren se të njëjtat mangësi janë dukshëm në rastet e pranishëm.

Në çështjen *Karpylenko kundër Ukrainës* ku ankuesi pretendoi se djali i saj ishte keqtrajtuar në paraburgim dhe se nuk ka pasur hetim efektiv brendshme në këtë çështje dhe fajësoi autoritetet për vdekjen e tij²²⁴.

Në 26 dhjetor 2009 i biri i aplikantit, Karpylenko është arrestuar nga Departamenti i Policisë së Qarkut Kiev i dyshuar për grabitje nga ku një ditë më vonë iu nënshtrua një ekzaminim mjekësor, nga i cili nuk ka rezultuar të jetë plagosur. Gjykata e Rrethit Shevchenkivskyy vendosi lënien në paraburgim në pritje të gjykimit. Në këto kushte në 30 dhjetor 2009 K. ishte vendosur në Qendrën e Kiev Paraburgimit "*The Sizo*" dhe në mars të 2010, ai u paraqiti një ankesë në gjykatë duke pretenduar që ndaj tij ishte ushtruar presion fizik dhe psikologjik në mënyrë që të bëjë atë të rrëfejë për një krim që nuk e kishte kryer. Ankuesi bëri një ankesë në autoritetet e ndjekjes penale në lidhje me vdekjen e parakohshme e birit të saj dhe kërkoi një hetim. Sipas ankuesit autoritet kishin dështuar në marrjen e masave për të siguruar djalin nën kujdesin e duhur mjekësor dhe që hetimi i bere nuk ishte i mjaftueshëm dhe efikas. Kështu Gjykata vendos se ka pasur shkelje të Nenit 2 të

²²⁴ Shih çështjen *Karpylenko kundër Ukrainës*.

Konventës në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv në rrethanat e vdekjes së K.-së, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me keqtrajtimin K. në paraburgim dhe ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv në pretendimin e keqtrajtimit K.-së.

Gjykata konstatoi një mungesë pavarësie nga ana e prokurorit në çështjen *Ergi kundër Turqisë*²²⁵, kjo sepse sipas arsytimit të Gjykatës, provat që kishte prokurori ishin të gjitha prova të administruara nga ana e xhandarmerisë, e cila ishte palë e implikuar në çështjen në fjalë. Në çështjen *Jordani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konstatoi që hetimi për sjelljen e disa forcave policore të Irlandës së Veriut, nuk ishte i pavarur sepse ishte realizuar nga po të njëjtat forca policore, çka e bëri çështjen të kishte një konflikt të pastër interesi dhe në këto kushte të konsiderohej si jo i pavarur. Pra në kontekst i pavarësisë së organeve publik merr një domethënie me të rëndësishme në momentin që në çështjen objekt gjykimi janë vetë këto autoritete të cilat janë të implikuara, si për shembull vrasjet dyshuara se janë realizuara nga agjentët e shtetit. Në trajtimin e çështjes *Neškoska kundër Republikës së Maqedonisë* u konstatua se organet shtetërore nuk ishin të implikuara në vrasjen e shtetasit MN nga ana e oficerit të policisë I.S. Në trajtimin e çështjes *Kalicki kundër Polonisë*²²⁶ gjykata u shpreh se pavarësisht që nuk jemi përpara rastit të një krimi të kryer, hetimi duhet të jetë, ndër të tjera, i plotë, i paanshëm dhe i kujdesshëm. GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se hetimi i realizuar nga autoritetet i përmbush standardet e kërkuara nga jurisprudenca e Gjykatës sepse ishte i plotë, i paanshëm dhe i kujdesshëm dhe nga kjo del se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës. Në trajtimin e çështjes *Dalakov kundër*

²²⁵ Shih çështjen *Ergi kundër Turqisë*.

²²⁶ Shih çështjen *Kalicki kundër Polonisë*.

Rusisë Gjykata konstatim se hetimi nuk kishte qenë i pavarur nisur nga fakti që vepra penale ishte kryer nga agjentët e shtetit. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedurale të tij sepse në dokumentet e dorëzuara nga Qeveria duket se nuk janë marrë masat e duhura nga agjentët e shtetit me qëllim të ruajtjes së jetës së z Apti Dalakov.

4.1.2. Hetimi duhet të jetë i plot dhe rigoroz

Hetimi duhet të jetë i plotë, i menjëhershëm, dhe rigoroz. Kriteri 'i menjëhershëm' është specifik dhe përcaktohet nga faktet e çështjes; vonesa prej 7 ditësh për pyetjen e të dyshuarve kryesorë mund të shkelë të drejtën për të jetuar,²²⁷ gjithashtu edhe një vonesë 3 vjeçare për të përmbyllur hetimin mund të përbëjë shkelje.²²⁸ Nëse hetimi nuk është i plotë, qoftë edhe për shkak të kushteve të vështira të sigurisë, përbën shkelje të së drejtës për të jetuar²²⁹.

Hetimet duhet të jenë të plota dhe rigoroz. Për shembull, e drejta për të jetuar është shkelur nëse autoritetet nuk kanë arritur të gjejnë të dhëna për dëshmitarë të mundshëm okularë apo të marrin deklaramë nga dëshmitarët dhe të marrin në pyetje të dyshuarit në një fazë të hershme të hetimit. Kështu në çështjen Kalicki kundër Polonisë ku nga ana e ankuesit u kërkua marrja në pyetje e dëshmitarëve, por nga ana e prokurorisë kjo marrja në pyetje u realizua 4 vjet me vonesë dhe për këtë dëshmitarët me të drejtë u shprehën se nuk e mbanin mend incidentin e vitit 2003. Marrja në pyetje e dëshmitarëve me vonesë sjell dhe dëshmi kontradiktore si në çështjen në fjalë. Gjykata vëren se hetimi fillestar në rrethanat e

²²⁷ Shih çështjen *Bektas kundër Turqisë*.

²²⁸ Shih çështjen *Esmukhambetov kundër Rusisë*.

²²⁹ Shih çështjen *Al-Skeini kundër UK*.

vdekjes së vëllait të ankuesit ishte shkëputur pas kërkesës së aplikantit në prill të vitit 2005²³⁰ duke e konsideruar si shkelje të afatit 6 mujor të procesit të hetimeve. Gjykata shprehet se mungesa e përgjegjësisë direkte të Shtetit për vdekjen e një individi nuk përjashton zbatueshmërinë e nenit 2. Hetimi duhet të jetë, ndër të tjera, të plotë, të paanshëm dhe të kujdesshëm. Në çështjen *Dalakov kundër Rusisë* Gjykata vëren se menjëherë pas incidentit, autoritetet vendase e kanë ndërprerë hetimin tre herë dhe se në dosje janë administruar informacione kontradiktore në lidhje me rrethanat e vdekjes së z Ahti Dalakov. Në këto kushte Gjykata thekson gjithashtu se neni 2 i Konventës nënkupton që duhet të ketë disa forma të hetimit efektiv, të plotë ndaj arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural të tij. Në çështjen *Lopes De Sousa Fernandes kundër Portugalisë* ku ankuesi pretendonte shkelje të drejtës së jetës së bashkëshortit të saj në bazë të neneve 6 dhe 13 të Konventës, ajo u ankua për kohëzgjatjes së procedurave të iniciuara nga ajo brenda dhe nuk ka qenë e sqaruar në lidhje me shkakun e saktë të vdekjes.

Në vendimin e kësaj çështje Gjykata thekson se shteti duhet të marrë masa për mbrojtjen e jetëve të individëve dhe nuk mund të përjashtohet se veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve në kuadrin e politikës së shëndetit publik mundet që në rrethana të caktuara të angazhohen përgjegjësinë e tyre për sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë së jetës. Sipas Gjykatës burri i aplikuesit ishte privuar nga mundësia për të pasur kujdesin e duhur emergjent dhe kjo ishte e mjaftueshme për të përcaktuar se shteti ka dështuar në detyrën e tij për të mbrojtur integritetin fizik të pacientit. Në këto kushte u konstatua shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së në aspektin substancial. Gjykata arrin në përfundimin koha e kryerjes së

²³⁰ Shih paragrafët 13 dhe 14 të çështjes *Kalicki kundër Polonisë*.

hetimeve nuk i ka plotësuar kërkesat e një të shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme dhe se ndaj viktimës nuk janë bërë të gjitha ekzaminimet e duhura dhe nuk i është dhënë informacion i hollësishëm në lidhje me pasojat që do të kishte ndërhyrja kirurgjikale nga sëmundja që ai kishte. Në këto kushte ka konstatuar shkelje të nenit 2 Të konventës në aspektin procedural. Në rastin e një gjykimi në lidhje me shkeljen e të drejtës së jetës Gjykatat duhet të shqyrtojnë me kujdes shpjegimet e zyrtarëve të shtetit për përdorimin e forcës prej tyre, të kërkojnë prova bindëse dhe të marrin në konsideratë provat e qarta.(Manual SLYNN, 2016:99) kështu gjykata konstatoi shkelje në aspektin procedural në çështjen Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë, sepse nga ana e qeverisë nuk u paraqitën prova bindëse që të vërtetonin mos përfshirjen e autoriteteve shtetërore në këtë çështje. Në lidhje me pretendimin e ankuesve se i afërmi i tyre ka qenë viktimë e një sulmi të jashtë ligjshëm Gjykata thekson nevojën për të pasur dëshmi bindëse për gjetjen e një ekzekutim jashtëligjor dhe jo të bazuar thjesht në hipoteza. Gjykata pranoi se policia besonte në mirëbesim, duke marrë parasysh informatat dhe udhëzimet që kishte marrë, se personat ishin të armatosur dhe më rrezikshmëri të lartë. Po kështu në çështjen Dalakov kundër Rusisë Gjykata ka konstatuar se Qeveria nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se vendimi i Gjykatës së Qarkut i ishte dërguar aplikantin. Dokumentet e paraqitura tregojnë se pavarësisht informacionit kontradiktore të mbledhur nga hetimi, autoritetet vendase, duke përfshirë komitetin hetues, departamentin e hetimeve ushtarake dhe Gjykatën e Rrethit Karabulak, nuk arritën të demonstrojnë një përgjigje të duhur ndaj akuzave të përdorimit të papërshtatshëm të forcës vdekjeprurëse nga agentët e shtetit. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural të tij.

Nga dokumentet e dorëzuara nga Qeveria duket se nuk janë marrë masat e duhura nga agjentët e shtetit me qëllim të ruajtjes së jetës së z Ahti Dalakov. Është e domosdoshme që gjatë proceseve hetimore në lidhje me të drejtën e jetës të kryhen autopsi të sakta, të thirren ekspertë për mbledhjen e provave, të kërkojnë prova për planifikimin e vdekjes dhe rrethanat që kanë shkaktuar atë dhe të hetohet vendngjarja. Në çështjen Öztünç kundër Turqisë, Gjykata thekson se shteti duhet realizoj një hetim zyrtar efektiv kur ka arsye për të besuar se një person ka pësuar lëndime të rrezikshme për jetën në rrethana të dyshimta pavarësisht mungesës së një anëtari të stafit të Gjendja e dëmit të pretenduar për jetën e aplikantit. Në mënyrë që të kualifikohet si "efektive" në kuptimin që ky term duhet të kuptohet në kontekstin e nenit 2 të Konventës, vëzhgimi i parë duhet të jetë i përshtatshëm.

Kjo do të thotë se duhet të jetë në gjendje të shpie në përcaktimin e fakteve dhe, kur është e përshtatshme, në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës. Gjykata thekson se detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim i mjeteve dhe jo i rezultatit: autoritetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm në dispozicion të tyre për të marrë prova në lidhje me faktet. (Manual SLYNN, 2016:90)

Hetimi duhet të jetë edhe më i plotë nëse nga përdorimi i armëve gjatë detyrës është shkaktuar vdekja²³¹. Kështu në çështjen *Dalakov kundër Rusisë*, z Ahti Dalakov kishte vdekur si pasojë e të shtënave me armë. Gjykata vëren se menjëherë pas incidentit, autoritetet vendase e kanë ndërprerë hetimin tre herë dhe se në dosje janë administruar informacione kontradiktore në lidhje me rrethanat e vdekjes së z. Ahti Dalakov. Po kështu dhe në *Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë* Gjykata konstaton që policia kishte vepruar në mirëbesim, mbi bazën e informacioneve të marra se viktimë ishte i armatosur

²³¹ Shih çështjen *Ramsahai kundër Holandës*.

dhe ishte pjesë e një grup militantësh të armatosur të PKK të cilët i janë përgjigjur thirrjes së zjarrit hapjes të policisë dhe se ata e qëlluan në vetëmbrojtje.²³² Gjykata vlerëson se vonesat e pa arsyetuara dhe të pabazuara në realizimin e procesit të hetimit, nuk mund të konsiderohen si një hetim i plotë dhe rigorozë nga ana e autoriteteve, dhe që mund të merren si prova absolute në vendimmarrje²³³.

Në rastet kur nga ana e autoriteteve përkatëse nuk mund të vërtetohet procesi i një hetimi atëherë ai do të konsiderohet si i pa realizuar asnjëherë. Pra mund të themi që keni shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së kur autoritetet përkatëse kanë dështuar në realizimin e një procesi hetimor të plotë dhe rigorozë, duke mos gjetur dhe marrë në pyetje dëshmitarët okularë të një çështjeje, duke mos kërkuar prova në lidhje me ngjarjen etj²³⁴.

4.1.3. Hetimi duhet të jetë i tillë që të përcaktojë përgjegjësinë e vdekjes

Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë personat përgjegjës për vdekjen, pra nëse zyrtarët e shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte apo jo e justifikuar. Hetimet duhet të jenë në gjendje të zbulojnë çdo të element që mund të ketë shkaktuar vdekjen, për shembull mënyra e planifikimit dhe organizimi i operacionit të shpëtimit²³⁵ dhe mënyra e planifikimit të operacioneve policore kundër terrorizmit²³⁶. Detyra për të kryer hetime të plota, duke përfshirë edhe të metat e sistemit, nuk varet nga prania e provave që tregojnë ekzistencën e të metave të tilla²³⁷.

²³² Shih çështjen *Muhacir Çiçek dhe të tjerë kundër Turqisë*.

²³³ Shih çështjen *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2002.

²³⁴ Shih çështjen *Bazorkina kundër Rusisë*, 27 korrik 2006, par. 120 – 125.

²³⁵ Shih çështjen *Andronicou & Constantinou kundër Qipros*.

²³⁶ Shih çështjen *McCann kundër MB*.

²³⁷ Shih çështjen *Al-Skeini kundër MB*.

Në çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*, Gjykata vendosi se përgjegjësia për vdekjen e disa personave në aksidentin tragjik në qendrën e riciklimit, ishte e autoriteteve lokale turke të cilat kishin toleruar ndërtimet e paligjshme të banesave në zonën e aksidentit.²³⁸

Në çështjen *Öztünç kundër Turqisë*, Gjykata thekson se shteti duhet të marrë masa për të mbrojtur jetën e atyre brenda juridiksionit të tij, duke krijuar një legjislacion që pengon kryerjen e veprave penale kundër personit. Kjo do të thotë se duhet të jetë në gjendje të shpie në përcaktimin e fakteve dhe, kur është e përshtatshme, në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës. Gjykata thekson se detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim i mjeteve dhe jo i rezultatit: autoritetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm në dispozicion të tyre për të marrë prova në lidhje me faktet. Gjykata vlerëson unanimisht se ka pasur një shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin procedural

Në çështjen *Elena Apostol dhe të tjerë kundër Rumanisë*, ankuesit, pretendonin se nuk ka pasur hetim efektiv në shtypjen e dhunshme të demonstratave anti-qeveritare në dhjetor të vitit 1989, në të cilën të afërmit e tyre ishin vrarë. Prokurorët hapën në vitin 1990 një hetim për përdorimin e forcës dhe të heqjes së paligjshme të lirisë së pjesëmarrësve në demonstratat në ditët e fundit të dhjetorit 1989 kundër regjimit të Causeshikut. Më 18 tetor 2010, zyra e prokurorit ushtarak në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë vendosi për të mos vazhdimin e një procedimi penale në lidhje me aktet e kryera nga ushtria, duke thënë se kërkesat e ankuesve kanë qenë pjesërisht të pabazuar. Më vonë në 15 prill 2011, kryeprokurori në zyrën e prokurorit ushtarak ka vendosur mos të marrë në konsideratë vendimin e 18 tetor 2010 për arsye se hetimi ende nuk ishte përfunduar dhe se nuk ishin

²³⁸ Shih çështjen *Oneryildiz kundër Turqisë*, 30 nëntor 2005.

identifikuar të gjitha viktimat dhe autorët e krimit. Dhe më vonë në 9 mars 2012 pasi materiali i klasifikuar në dosjen hetimore penale ishte hapur për publikun në vitin 2010 rasti u ri-regjistrua me qëllim realizimin e një hetimi nën dritën e informacionit të reja që kishin në dispozicion. Ankuesit u ankuan se hetimet penale të hapur nga ana e autoriteteve në vitin 1990 në ngjarjet e dhjetorit 1989 kishte qenë i paefektshëm. Ata pretenduan se shteti i paditur nuk ishte në përputhje me kërkesat procedurale të nenit 2 të Konventës²³⁹. Kërkesit theksuan se edhe pas njëzet e gjashtë vjetësh nga vdekja e të afërmeve të tyre, nga hetimi ende nuk ishin identifikuar personat përgjegjës dhe të dërgoheshin për gjykim.

4.1.4. Shpejtësia e autoriteteve në hetim

Shpejtësia në fillimin e hetimit konsiston në periudhën kohore kur ai fillon, e cila ndikon dhe në efektivitetin e hetimit dhe besueshmërinë e tij. Kështu në bazë të çdo legjislacioni menjëherë pas konstatimit të një veprë penale parashikohet fillimi i hetimeve nga ana e autoriteteve përgjegjëse. GJEDNJ-ja ka konstatuar në disa çështje shkelje procedurale në lidhje me mos fillimin e hetimeve në kohë dhe me tej zgjatjen e hetimeve, që çojnë në një përfundim jo të saktë dhe të besueshëm. Çështja Elena Apostol dhe të tjerë kundër Rumanisë, trajton vrasjen e disa personave gjatë protestave të viti 1989, prokurorët ushtarakë të Bukureshtit, hapën në vitin 1990 dhe vetëm në 18 tetor 2010, zyra e prokurorit ushtarak në Gjykatën e Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë vendosi mos vazhdimin e procedimit penale në lidhje me aktet e kryera nga ushtria, duke e konsideruar kërkesën e ankuesve si pjesërisht të pabazuar. Ankuesit parashtruan se kohëzgjatja e hetimit ka qenë e

²³⁹ Shih çështjen *Apostol dhe të tjerët kundër Rumanisë*.

tepruar dhe se autoritetet nuk kanë respektuar kërkesat e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës në nenin 2 të Konventës. Gjykata shprehet se hetimi ka filluar në vitin 1990 dhe ka zgajtur deri në vitin 2004, ndërkohë që ngjarja ka ndeshur në vitin 1989, dhe që hetimet në ngjarjet e dhjetorit të vitit 1989 janë kryer nga prokurorët ushtarakë të cilët, në bazë të legjislacioni në fuqi në atë kohë, ishin në një marrëdhënie të varësisë në kuadër të hierarkisë ushtarake, pra në këtë çështje ka një zgjatje të tepruar të hetimeve.

Gjykata ka konstatuar se hetimi i realizuar nga ana e autoriteteve penale vendase në çështjen *Öztünç kundër Turqisë* ka qenë i ngadaltë dhe jo efikase. Kjo çështje konsiston në vdekjen e vëllezërve Ali, Tahir, dhe Haxhi Hasan Oztunc, të cilët u pushkatuan në 9 gusht 1984. Ata kishin qenë viktimat të disa të shtënave me armë të bëra në rrugën në fshatin e tyre në hyrje të urës Tuzluca. Ankuesi u ankuan për kohëzgjatjen e procedurës penale kundër të dyshuarve për vrasjen e të afërmeve të tyre. Ata më tej thonë se ata kanë asgjësuar çfarëdo mjeti efektiv që do të kishte lejuar ata për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të ndëshkuar vrasësit e të afërmeve të tyre. Po kështu Gjykata ka konstatuar tej zgjatje të veprimeve hetimore edhe në çështjen Bilbija dhe Blažević kundër Kroacisë, ku nëna e ankueses vdiq në 13 shkurt 2001 për shkak të disa problemeve me frymëmarrjen në spital publik. Nga autopsia rezultoi se shkak i vdekjes ishte pamjaftueshmëria e frymëmarrjes që çon në komplikacione kardiake. Ankuesi kërkoi të dhënat mjekësore më synimin që të ndiqte çështjen në rrugë ligjore. Me marrjen e raportit mjekësor ankuesja depozitoj në 24 nëntor 2003 një ankesë në Gjykatën Administrative për të kundërshtuar vendimin e Komisionit hetimor, i cili nuk ishte konstatuar shkelje dhe nuk kishte gjetur ndonjë neglizhencë në trajtimin mjekësor të nënës së saj, dhe vetëm në më 11 maj 2006, mori një përgjigje nga Gjykata Administrative që shprehet se rasti i saj ishte ende nuk është

shqyrtuar. Në këto kushte Gjykata vëren se pas dorëzimit të ankesës pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit në Komunën e Zagrebit në shkurt të vitit 2004 deri në dhjetor të vitit 2007, nuk është marrë asnjë veprim hetimor. Gjykata e konsideron se në këtë periudhë ka pasur një pasivitet të pashpjegueshëm për ndërmarrjen e disa veprimeve të thjeshta procedurale të tilla si shkëmbimi dosjet përkatëse në mes të autoriteteve²⁴⁰, ose përcjellja e raportit të ekspertëve për aplikuesit e parë²⁴¹

GJEDNJ-ja e konsiderim si kohë jo efektive periudhën një vjeçare që iu desh Gjykatës Penale Komunale të Zagrebit për të kuptuar se aktakuza e ankuesve nuk ishin hartuar siç duhet dhe tetë muaj që të merrte veprimin e parë konkret procedural në këtë rast.²⁴² Gjykata vëren më tej se vetëm në prill të vitit 2011, pra pas tre vjetëve të depozitimit të padisë nga ana e ankuesve, Gjykata Penale e Komunës Zagreb, vendosi se rasti nuk ishte i gatshëm për gjykim dhe urdhëroi hetime të mëtejshme, duke i zgjatur edhe 1 vit e 7 muaj më tej hetimet e çështjes. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se mekanizmat përkatëse të sistemit të brendshëm juridik parë si një e tërë nuk ka siguruar në praktikë një përgjigje efektive dhe të shpejtë të autoriteteve "në harmoni me obligimet procedurale të shtetit sipas nenit 2 të Konventës, për këtë arsye GJEDNJ-ja arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

²⁴⁰ Shih paragrafët 52 dhe 53 të çështjes *Bilbija dhe Blažević kundër Kroacisë*.

²⁴¹ Shih paragrafët 57 dhe 58.

²⁴² Shih paragrafët 54 dhe 56.

4.1.5. Mundësia e marrjes pjesë të të afërmeve në procedurë

Neni 2 i KEDNJ i imponon Shtetit detyrimin për garantimin dhe kryerjen e një procedure efektive ex post facto, që do të mund të përcaktonte qartë faktet e rrethanave të vrasjeve, kur ato kryhen nga agjentët e Shtetit. Kjo në kuadër të një procesi të pavarur gjyqësor në të cilin palët (të afërmit e viktimave) duhet të kenë akses të plotë²⁴³ dhe në respektim të Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Punonjësit e Ruajtjes së Rendit, dhe ato mbi Parandalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve të konsideruara si Ekstraligjore, Arbitrare dhe atyre masive²⁴⁴. GJEDNJ-ja i referohet haptazi standardeve ndërkombëtare të paraqitura nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i shtetit të Irlandës së Veriut që është një organ shtetëror po kështu edhe nga Amnesty International, si dhe nga organizata të tjera jo-qeveritare të të drejtave të njeriut.²⁴⁵ (Kroff, 2006: 41) Nëse nuk do të ekzistonin dispozitat ligjore përkatëse dhe nuk do të zbatoheshin sanksione ligjor për përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga autoritetet shtetërore, atëherë nuk dot kishim një respektim të të drejtës së jetës. Kjo sepse detyrimi për të mbrojtur të drejtën e jetës, bazuar në neni 2 të KEDNJ-së, së bashku me detyrimin e përgjithshëm të shtetit sipas Nenit 1 të Konventës për t'i "siguruar çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë" kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një forme hetimi zyrtar efektiv në rastin e vrasjeve së individëve kur dyshohet se rezultojnë kushtet ose dyshimi i përdorimit të forcës nga,

²⁴³ Shih Vendimi i Dhomës së Madhe McCann, para. 157. Vëreni se ky kusht procedural rrjedh nga vetë Neni 2 dhe dallon nga të drejtat e tjera të "zgjidhjes efektive" kundrejt shkeljeve ndaj Konventës (Neni 13) dhe nga e drejta për akses në gjykatë për të ngritur procedura civile (Neni 6), ku asnjëri nga të cilët nuk u ngrit për trajtim në McCann (vendimi, para. 160).

²⁴⁴ Miratuar më 24 maj 1989 në Rezolutën e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara 1989/65

²⁴⁵ Shih Vendimi i Dhomës së Madhe McCann, paragrafët 138 – 140.

ndërmjet të tjerash, agjentët e shtetit²⁴⁶. Në çështjen Elena Apostol dhe të tjerë kundër Rumanisë Gjykata konstaton një zgjatje të tepruar të hetimeve dhe mungesë të përfshirjes së të afërmeve të viktimave në procedurë, si dhe mungesë të informacionit për publikun në lidhje me ecurinë e hetimeve. Gjykata vëren se të njëjtat mangësi janë dukshëm në rastet e pranishëm. Duhet pranuar fakti që shpesh herë mund të dalin pengesa apo vështirësi që frenojnë ose ngadalësojnë progresin e hetimeve në një situatë të caktuar. Megjithatë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet ndaj hetimit për përdorimin e forcës vdekjeprurëse në përgjithësi mund të konsiderohet si thelbësore në ruajtjen e fshehtësisë publike, në përkushtimin e tyre ndaj shtetit të së drejtës dhe në parandalimin e ndonjë shfaqjeje tolerance të përgjegjësve të vrasjes apo tolerance në përgjithësi të akteve të paligjshme. Po për të njëjtat arsye, duhet të ekzistojë një element i mjaftueshëm, ai i mbikëqyrjes publike për hetimin apo rezultatet e tij, për të siguruar kështu përgjegjshmërinë në këtë veprimtari. Shkalla e kësaj mbikëqyrjeje publike mund të ndryshojë qartë nga çështja në çështje. Megjithatë, në të gjitha çështjet një përfaqësues ligjor apo i afërm i viktimës duhet të përfshihet në procedurë, deri në atë masë sa të sigurojë kjo pjesëmarrje në proces interesat e tij legjitime²⁴⁷. Në konflikte të brendshme të armatosura, si edhe në ato ndërkombëtare (siç do të trajtohet më poshtë në këtë tezë), është e rëndësishme të fokusohemi te mbrojtja e së drejtës së jetës, si GJEDNJ vërejtë se humbja e jetës është një ngjarje tragjike dhe e shpeshtë përsa i përket situatës në Turqinë juglindore por gjithsesi, as shpeshtësia e përplasjeve të dhunshme të armatosura, as numri i lartë i viktimave nuk mund të

²⁴⁶ Shih Vendimi i Dhomës së Madhe McCann, paragrafi 161.

²⁴⁷ Shih *Gulec kundër Turqisë*, vendimi i 27 korrikut 1998, para. 82, ku i ati i viktimës nuk u njoftua për vendimet për të mos proceduar ligjërisht; *Oğur kundër Turqisë*, vendimi i 20 majit 2000, para. 92, ku familja e viktimës nuk kishte akses të hetimet dhe dokumentet e gjykatës; *Gal kundër Turqisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2000, paragrafi. 93.

mënjanojnë detyrimin që rrjedh në bazë të Nenit 2 të KEDNJ për të siguruar kryerjen e një hetimi efektiv e të pavarur në vdekjet që shkaktohen si pasojë e përplasjeve ku përfshihen forcat e sigurisë, për më tepër në çështje si kjo që është në shqyrtim ku rrethanat në shumë aspekte janë të paqarta (Kroff,2006: 42).

Në çështjen *Kelly*, Gjykata u shpreh ndër të tjerash, se ka pasur shkelje të këtyre kushteve procedurale, sepse në Irlandën e Veriut hetimet nuk mund të dhe nuk duhet të shmangin fajësinë për faktin se të afërmeve u ishte mohuar akses në dokumentat e fashikullit të çështjes dhe për shkak të vonesave të tepërta dhe të pajustificuara, për mbi disa vite, që kishin bërë të shtyhej hetimi i këtyre vdekjeve²⁴⁸.

Kërkuesit gjithsesi nuk ishin thirrur për të marrë dijeni për arsyen se përse të shtënat me armë nuk ishin konsideruar se përbënin shkelje të ligjit për përdorimin e armëve ose shkelje të qëllimshme të rregullores operationale, gjë që do të mund të themelonte një ndjekje të mundshme penale, pra pse nuk justifikohet ligjërisht ndjekja penale e pjesëtarëve të grupit të zjarrit të përfshirë në të. Nuk kishte pasur asnjë vendim të disponueshëm e të arsyeshëm për të siguruar publikun e interesuar se shteti ligjor ishte respektuar.

²⁴⁸ Shih Vendimi tek *Kelly*, paragrafët 124, 128 dhe 134. Për detaje shih të gjithë pjesën, paragrafët 119 – 134. Vëreni se Gjykata theksoi si faktin se hetimet në Irlandën e Veriut ishin më të kufizuara se hetimi në çështjen e McCann në Gjibraltari (në lidhje me të cilën nuk kishte konstatuar shkelje të kushteve procedurale të Nenit 2) (para. 123), edhe faktin se meqë në çështjen e McCann, “Gjykata i kishte vënë më shumë theksin rëndësisë së përfshirjes së të afërmeve të të ndjerit në procedurë dhe të dhënies së informacionit atyre” (para. 127, duke iu referuar çështjes Oğur kundër Turqisë, vendimi i 20 majit 1999, para. 92). Një arsye tjetër madhore ishte se nuk ishin dhënë shpjegime për faktin se përse nuk ishte ndjekur penalisht asnjë njeri për vrasjet e kryera. Në këtë ngjarje u qëlluan dhe ngelën të vdekur nëntë persona, njëri prej të cilëve një kalimtar i rastit që nuk kishte asnjë lidhje me IRA-n .

KAPITULLI V KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

5.1. Konkluzione

E drejta e jetës është një e drejtë themelore me fokus të gjerë, në të cilin përfshihen çështje që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme dhe gëzon një mbrojtje të posaçme nga instrumentat ndërkombëtare, ato evropiane, rajonale dhe kombëtare. Ajo është një e drejtë e paderogueshme, e pandashme, e patjetërsueshme e lidhur ngushtë me qenien njerëzore, e cila qëndron në majën e piramidës së të drejtave të njeriut, pa gëzimin e saj asnjë nga të drejtat e tjera nuk do të ekzistonte. E drejta e jetës nuk ka pasur të njëjtin nivel mbrojtjeje sepse dikur mbrojtja e jetës dhe vlera e saj varej nga gjykimi individual i vetë njerëzve. Gjatë trajtimit të historisë së mbrojtjes së kësaj të drejte konstatuam se periudha mes dy luftërave botërore, ka qënë periudha në cilën kjo e drejtë njohu shkeljet dhe cënimet më të renda sepse regjimi nazist kreu aktet më të tmerrshme kundër të drejtës së jetës, të cilat konsistonin në zhdukjen fizike të popullit hebre dhe të popujve të tjerë si romët e sllavët, të konsideruar si “raca inferiore” kundrejt racës gjermane. Përball këtyre ngjarjeve tronditëse njerëzimi u sensibilizua për rëndësinë e saj duke e kthyer mbrojtjen e saj në një prioritet të shoqërisë. Në kuadër të zhvillimeve të shumta në lidhje me sulme e shumta terroriste duhet të theksojmë se është bërë një përpjekje e madhe për të gjetur mënyrën me të cilën njeriu duhet të sigurojë të drejtën e padiskutueshme universale, të patjetërsueshme që nuk është veçse e drejta për të jetuar. Si një nga të drejtat që është esencialisht e lidhur me ekzistencën e njeriut e drejta e jetës gëzon mbrojtje ligjore në nivel kombëtarë duke u sanksionuar në kushtetutat e të gjitha shteteve.

E drejta e jetës është parashikuar në nenin 2 të KEDNJ-së si dhe në Protokollin Shtesë të kësaj Konvente dhe i referohet në kontekst vetëm jetës njerëzore. Gjatë analizimit

të kësaj t drejtë dhe problematikave që hasin shtetet në sigurimin e mbrojtjes së saj do të vërejmë që Konventa nuk e qartëson se çfarë është jeta dhe ku fillon apo mbaron mbrojtja e Nenit 2 të Konventës kjo si pasojë e mungesës së një kompromisi në nivel botëror ligjor apo shkencor në lidhje me çështjen, edhe sepse Komisioni, gjatë kohës kur ende ekzistonte, edhe GJEDNJ-ja nuk kanë vullnetin për të vendosur standarde të sakta në këtë drejtim. Në këtë punim është trajtuar çështja e abortit e analizuan në kuadrin e nenit 2 të Konventës. Ende nuk ka një konsensus ndërkombëtarë në lidhje me fillimin e mbrojtjes së jetës, he në këtë kontekst do të lindin dhe paqartësi në lidhje me njohjen e të drejtës së jetës së fetusit. Kështu Komisioni përjashtoi interpretimin e idesë së dhënies së fetusit cilësinë e mbartësit të së drejtës absolute të jetës duke i atribuuar të drejtën e jetës vetën personave që linin të gjallë. Në këto kushte çështja e lejimit ose jo të abortit ka qenë objekt i diskutimeve të vazhdueshme në panelet e ndryshme mjekësore dhe në ato juridike, kjo sepse aspektin juridik hartimi i një legjislacioni për lejimin e abortit ka qenë një sfidë ndaj jetës. Në disa legjislacione aborti gjenë rregullim ligjorë të ndryshëm kjo si pasojë e mos unifikimit të një koncepti globalë në lidhje me momentin e fillimit të jetës. Në vendin tonë e drejta e jetës në Shqipëri ka gëzuar mbrojtje që në fillimet e saj duke u konsideruar si e shenjtë dhe aborti ishte një akt i dënueshëm nga ana e opinionit dhe nga ana e akteve ligjore. Nga një analizim që i bëhet legjislacionit shqiptar në periudha të ndryshme vërehet se më shumë vendoset në qendër dhe i jepet rëndësi veprimeve kriminale ndaj grave shtatzëna sesa abortit se akt spontan. Aktualisht çështjet e abortit kanë rregullim ligjorë me ligjin Nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë” për herë të parë legjitimonte procesin e abortit por më kufizimin që të realizohen vetëm nga mjeku specialist *obstetërgjinekolog* në institucione shëndetësor sipas udhëzimit të ministrit të Shëndetësisë.

E drejta për të jetuar lidhet edhe me të drejtën për të vdekur dhe eutanazinë, megjithëse Gjykata ka thënë se nuk është e mundur të deduktosh të drejtën për të vdekur nga e drejta për të jetuar²⁴⁹. Fenomeni i eutanazisë është i hershëm sa vetë njërzimi dhe koncepti i saj ka evoluuar dhe koncepti që disponojmë sot për eutanazinë është *"shkaktimin e vdekjes të një personi/pacienti, pa dhe me pëlqimin e tij, ''që vuan nga një sëmundje e pashërueshme e cila njëkohësisht shkakton vuajtje të mëdha dhe të papërballueshme për të dhe për të cilin sipas diagnostikimit dhe pas të gjithë mënyrave të trajnimit mjekësor, nuk mund të shpresohet për shërim"*. Eutanazia ka ngjashmëri me vetëvrasjen sepse në rastin e eutanazisë personi është atë moment realisht i paaftë fizikisht t'i japë vetë fund jetës së tij dhe kështu që kërkon pjesëmarrjen e një personi tjetër për finalizimin e aktit. Në rastin e vetëvrasjes është vetë peroni i cili kryen aktin e marrjes së jetës së tij. Në punim në lidhje me eutanazinë kemi analizuar çështjen e Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar. Aplikantja vuan nga një sëmundje e sistemit nervor motorik dhe ndaj nuk ishte në gjendje t'i jepte fund jetës. Ajo dëshironte që bashkëshorti i saj ta ndihmonte për t'i dhënë fund jetës, gjë që ishte e ndaluar nga ligji anglez. Gjykata nuk gjeti shkelje as të Nenit 2 dhe as të Nenit 3, kur autoritetet refuzuan t'i garantonin bashkëshortit të saj mos-fillimin e ndjekjes penale. Në çështjen tjetër Lambert kundër France, çështja ishte nëse vendimi i mjekut për të hequr trajtimin mjekësor shkelte Nenin 2. Kjo çështje u shtrua nga familja e një tetraplegjiku, që kundërshtonte vendimin e Conseil de-État Francëz (Këshilli i Shtetit Francez) i cili e kishte përcaktuar si të ligjshëm vendimin e mjekut. Për shkak të mungesës së vullnetit të Shtetit për çështjen, Gjykata përcaktoi se është në hapësirën e vlerësimit të Shtetit për të përcaktuar ligje që lejojnë heqjen e trajtimeve që e mbajnë në jetë një person.

²⁴⁹ Shih çështjen *Pretty v Mbretërisë së Bashkuar*.

Në vazhdim, Gjykata gjeti se për shkak të çështjeve komplekse mjekësore, ligjore dhe etike të ngritura, ishte fillimisht detyrë e autoriteteve të brendshme të verifikonin nëse vendimi për heqjen e trajtimit ishte apo jo në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Gjykata gjeti se si kuadri ligjor që rregullon trajtimin mjekësor në fund të jetës së personit, ashtu edhe procesi specifik i vendimmarrjes, ishin në përputhje me detyrimet pozitive që rrjedhin nga Neni 2.

Pjesë e rëndësishme e trajtimit të punimit tonë ishte dënimi me vdekje në Shqipëri dhe në disa vende të tjera. Analizuam kuadrin ligjor nga kemi parashtruar se në Këshillin e Europës, dënimi me vdekje tashmë është një dënim i paligjshëm. E drejta për të jetuar e garantuar nga Neni 2(1) i KEDNJ parashikon rrethanat kur me mund të lejohet dënimi me vdekje. Protokoli 6 i KEDNJ heq dënimin me vdekje përveç akteve të kryera në kohë lufte. Protokoli 13 shkon më tej dhe shfuqizon dënimin me vdekje në çdo rrethanë. Në çështjen Öcalan kundër Turqisë, Gjykata ndaloi zbatimin e dënimit me vdekje në kohë paqeje. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut tashmë ka vendosur se fjalia e dytë e Nenit 2(1) nuk e ka ndaluar Gjykatën që të konstatojë se dënimi me vdekje përbën trajtim çnjerëzor dhe poshtërues²⁵⁰.

Në vitin 2014, Gjykata bëri disa deklaratatë të forta për dënimin me vdekje, duke përcaktuar faktin se ‘caktimi dhe përdorimi i dënimit me vdekje mohon të drejtat themelore të njeriut të njohura nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës’ dhe që zbatimi gjyqësor i këtij dënimi ishte ‘shkatërrim i qëllimshëm dhe i paramenduar i një qenieje njerëzore nga autoritet e Shtetit’. Në vitin 2015, Gjykata përcaktoi se ‘dënimi me vdekje konsiderohet një formë e papranueshme dënimi që nuk më lejohet nga Neni 2, i ndryshuar nga Protokoli 6

²⁵⁰ Shih çështjen *Al-Saadoon v Mbretërisë së Bashkuar*.

dhe 13, dhe përbën gjithashtu trajtim apo dënim çnjerëzor dhe poshtërues'. Kjo gjë u aplikua edhe ndaj Rusisë, ndonëse nuk kishte ratifikuar as Protokollin 6 dhe as Protokollin 13.

Të drejtat dhe liritë e sanksionuara nga Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut u bënë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (këtej e tutje GJEDNJ) në raport me çdo të drejtë të cënuar në të. GJEDNJ-ja është kompetente që të kontrollojë dhe sigurojë respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e normave të përcaktuara në KEDNJ nga ana e institucioneve legislative dhe ekzekutive të Palëve të Larta Kontraktuese. GJEDNJ-ja mund të vihet në lëvizje vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore sipas kuptimit nga parimet përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Vendimet e Gjykatës janë detyruese. Kur GJEDNJ-ja konstaton një shkelje, vendi në fjalë është i detyruar të ekzekutojë vendimin, duke marrë masa për të siguruar që një shkelje e tillë e ngjashme të mos ndodhë më. Një vlerë të veçantë në këtë studim ka përkufizimi dhe përcaktimi i përgjithshëm i detyrimeve pozitive nga ana e shtetit dhe agentëve që veprojnë në emër të tij sidomos në funksion të mbrojtjes së jetës dhe integritetit të personave. Këto në fakt janë detyrimet me karakter thelbësor si për shembull mbrojtja e jetës me ligj dhe elementët që përjashtohen nga detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës. Masat pozitive mund të përfshijnë marrjen e masave për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe për të rritur jetëgjatësinë veçanërisht duke shmangur kequshqyerjen dhe epidemitë. Ky urdhërim përfshin detyrimin që Shteti të sigurojë një regjim administrativ që mbron jetën në mënyrë efektive. Në veçanti, duhet të ndërmerren hapat e duhur për të siguruar jetën e personave që jetojnë në territorin e një shteti, brenda juridiksionit të tij. Kjo

mund të përfshijë parashikimin e një dispozite që jep informacion të një rreziku potencial për jetën, që mund të shkaktohet nga veprime të Shtetit, ky detyrim mund të shtrihet edhe për të dekurajuar individët që venë në rrezik shëndetin e tyre. Detyrim pozitiv ndaj të drejtës për të jetuar kërkon që ligji, në mënyrë të përshtatshme, të ndalojë dhe të dënojë vrasjet, dhe vrasja e paligjshme duhet t'i nënshtrohet sanksioneve penale, pavarësisht se kush i kryen vrasjet. Ky është rasti edhe kur një zyrtar i Shtetit është përgjegjës për marrjen e jetës, kur përdorimi i forcës vdekjeprurëse nuk mund të justifikohet dhe nuk ka qenë absolutisht i domosdoshëm. Të gjitha vdekjet duhet të hetohen në mënyrë të përshtatshme, dhe ligji duhet të zbatohet në mënyrë të efektshme. Kjo kryhet më mirë nga një gjykim penal, siç është përcaktuar nga Gjykata në rrjedhën normale të ngjarjeve, një gjykim penal, me një procedurë kontradiktore përpara një gjykatësi të pavarur dhe të paanshëm, konsiderohet se jep garanci më të forta për një procedurë efektive për gjetjen e fakteve dhe përcaktimin e fajtorit. Detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën, në rrethana të caktuara mund të kërkojë që Shteti të mbrojë jetën e individëve të caktuar nga kërcënime të identifikuara. Në përditshmëri, këto kërcënime mund të vijnë nga individë të tjerë, rreziqe mjedisore apo madje edhe nga vetvetja. Një vend të rëndësishëm në këtë studim mbrojtja që imponohet në kuadrin e veprimeve të organeve shtetërore, mbrojtja nga rreziqet që lindin si pasojë e veprimit të pushtetit publik, mbrojtja ndaj të tretëve, parandalimi i vetëvrasjes dhe përdorimi i forcës me efekt vdekjeprurës nga agjentët e shtetit.

Një detyrim tjetër pozitiv është për personat që mbahen në paraburgim. Ata janë në një pozicion delikat dhe Shteti ka detyrë t'i mbrojë. Ky detyrim lind atëherë kur autoriteti 'dinte, ose duhet të kishte ditur në atë kohë për ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm ndaj jetës së një individi të caktuar nga një palë e tretë apo nga vetvetja dhe

që ata dështuan të merrnin masa sipas kompetencave të tyre, nga të cilët, në mënyrë të arsyeshme, pritej që të shmangnin një rrezik të tillë.

Shtrirja e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën nuk është e pakufishme. Për këtë duhet të arrihet një ekuilibër i përshtatshëm, dhe Konventa nuk u imponon ‘autoriteteve një barrë të pamundur apo jo proporcionale’. Në qoftë se agjensitë ligjzbatuese dështojnë të veprojnë, për shembull, duke zgjedhur të mos arrestojnë një person i cili më pas merr një jetë (vret dikë), kjo nuk përbën domosdoshmërisht shkelje të së drejtës së jetës. Në çështjen *Osman kundër MB*, në lidhje me çështjen e mbrojtjes nga cënimet e palëve të treta, GJEDNJ nuk gjeti shkelje të së drejtës për të jetuar në rastin kur policia nuk arrestoi një individ i cili shqetësonte një familje, dhe që më pas vrau me armë babanë e kësaj familje. Policia, bazuar në rrethanat e çështjes, nuk kishte arsye të besonte se do të ndodhte një ngjarje kaq tragjike. Gjykata theksoi se policia nuk mund të kritikohet sepse dështoi të kryente arrestimin, pasi ajo në mënyrë të arsyeshme besoi se mungonte dyshimi si standart i nevojshëm për kryerjen e arrestimit. Nga ana tjetër, në çështjen e *Bljakaj kundër Kroacisë* Gjykata gjeti se mungesa e masave të arsyeshme, për të mbrojtur të tjerët nga një person që dihej se ishte i sëmurë mendor, të cilat çuan në vdekjen e avokatit të tij, përbën shkelje të së drejtës për të jetuar. Shiko gjithashtu *Kayak kundër Turqisë*, që lidhet me një dështim të mbikëqyrjes së situatës kur një fëmijë u godit me thikë nga një fëmijë tjetër në shkollë.

E drejta për të jetuar krijon dy lloj detyrimesh; detyrime substanciale që konsistojnë në garantimin e vetë të drejtës për të jetuar dhe detyrime procedurale në rastin e humbjes së jetës. Të dyja kërkesat kanë rëndësi të njëjtë dhe shpesh, por jo domosdoshmërisht ndërthuren në të njëjtat ngjarje. Në përfundim të studimit analizojmë disa nga karakteristikat me karakter procedural që formojnë besueshmërinë e hetimit. Kështu

detyrimi që ligji të mbrojë jetën e të gjithëve përfshin një aspekt procedural përmes së cilit rrethana e heqjes së jetës t'i nënshtrohet një hetimi të pavarur dhe publik. Me institucion të pavarur publik nënkuptojmë mungesën e hierarkisë së institucionit përgjegjës për realizimin e hetimeve nga organet më të larta shtetërore. Kjo pavarësi merr një kuptim më të rëndësishëm nëse në çështjen në të cilin po hetohet janë të implikuar vetë institucionet shtetërore. Hetimi duhet të jetë i plotë, i menjëhershëm, dhe rigoroz. Nëse hetimi nuk është i plotë, qoftë edhe për shkak të kushteve të vështira të sigurisë, përbën shkelje të së drejtës për të jetuar. Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë personat përgjegjës për vdekjen, pra nëse zyrtarët e shtetit janë përgjegjës, hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse vrasja ishte apo jo e justifikuar. Detyra për të kryer hetime të plota, duke përfshirë edhe të metat e sistemit, nuk varet nga prania e provave që tregojnë ekzistencën e të metave të tilla. Hetimi duhet të jetë i shpejtë në mënyrë që të konsiderohet i besueshëm. Gjatë proceseve hetimore duhet që pala ankuese të ketë akses në informacionet e hetimit me qëllim evitimin e abuzimeve të ndryshme që mund të kryhen në lidhje me mënyrën e marrjes ose përdorimit të provave dhe vërtetësinë e tyre.

5.2. Rekomandime

E drejta për jetuar është një e drejtë thelbësore dhe e pashmangshme. Të drejtës për jetuar i jepet një rëndësi e veçantë në të drejtën ndërkombëtare sepse të drejtat e tjera nuk do të kishin asnjë kuptim në mungesë të jetës dhe rëndësia e të drejtës së jetës është njohur si vlerë që përmban në vetvete qenia njerëzore. Në këtë kuptim, e drejta për jetën lidhet ngushtësisht me dinjitetin njerëzor. Pa të drejtën e jetës është e pamundur të gëzohen të drejtat e tjera. Ashtu si mbrojtja nga tortura, e drejta për të jetuar përbën një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike dhe kuptimi i saj duhet përcaktohet duke mbajtur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte. Për rrjedhojë, dispozitat që garantojnë atë duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë dhe strikte. Gjatë analizimit të kuadrit ligjor të të drejtës së jetës konstatova se ka disa mangësi ligjore të cilat do të ndihmonin legjislacionet kombëtare dhe ndërkombëtare në zbatimin dhe ndoshta në minimizimin e shkeljeve të kësaj të drejte. Në këto kushte rekomandohet që:

1. Krijimi i një koncepti universal se çfarë është jeta dhe ku fillon apo mbaron mbrojtja e Nenit 2 të Konventës në lidhje me jetën dhe fillimin e saj
2. Arritja e një konsensusi ndërkombëtar në lidhje me njohjen e të drejtës së jetës së fetusit.
3. Krijimi i një kuadri ligjor në nivel ndërkombëtar për eutanazinë, si një domosdoshmëri jetësore e kohëve të fundit.
4. Në lidhje me ekzistencën e sistemit ligjor duhet që të nga ana e shtetit të vendosen sanksione penale për autoritetet përgjegjëse të hetimin në rastet kur nuk realizojnë një hetim në kohen e duhur, duke eliminuar në këtë mënyrë “dispozitat e bardha”, pas të cilave fshihen një pjesë e mirë e hetuesve kur tejkalojë afatet ligjore.

5. Të krijojë grupe hetimi ndaj agjentëve të shtetit me qëllim kontrollimin e zbatimit të ligjit dhe kryerjes së funksioneve në përputhje me legjislacionin.
6. Përfshirja në legjislacionet kombëtare vendosja në kushtet e paraburgimit të mjeteve gjurmuese të cilat mund të ndihmojnë të evitosh vrasjet ose vetëvrasjet.
7. Mos përdorimi i 'vrasjeve të shenjestrura' nga ana e shteteve, të personave që dyshohen si terroristë.
8. Thirrja e një eksperti në mënyrë të detyrueshme në çdo raste të marrjes së jetës së një individi, si një masë minimale që mund të krijojë një kudër të qartë të ngjarjes dhe mos humbjes së provave që mund të çojnë në zbardhjen e ngjarjes ë kohë e duhur, duke evituar vonesat e pajustificuara.
9. Vendi ynë duhet të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mbi të drejtën për të jetuar, të drejtën për të vdekur dhe të drejtën e abortit në bazë të zhvillimeve të fundit dhe bashkëkohore lidhur me këto koncepte.

BIBLIOGRAFIA

Burime Paresore

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
3. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
4. Protokolli Nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Shfuqizimin e Dënimit me Vdekje, STE 114, e 28 prillit 1983, hyri në fuqi që në 1 mars 1985.
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
6. Ligji për përdorimin e armëve nr. 8290 dt 24.02.1998.
7. Protokolli Nr.4 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
8. Protokolli Nr.6 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
9. Protokolli Nr.7 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
10. Protokolli Nr.12 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
11. Protokolli Nr.13 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
12. Protokolli Nr.14 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

13. Protokolli Nr.15 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
14. Protokolli Nr.16 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
15. Ligjin nr. 8045 date 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatezaniisë”
16. Ligjin nr. 10107 date 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor ne Republikën e Shqipërisë”
17. Ligj nr. 10 339, datë 28.10.2010 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të drejtat e njeriut dhe Biomjeksinë”.

Burime dytësore

1. A Brown, (2002). “*What Can We Learn From the Pretty Cases?*” Human Rights & UKP 3.3(8).
2. A Meisel, (1995). *The Right to Die* (2 nd ed, vol 2), Wiley Law Pub, New York.
3. AA. VV. (2005), *Diritto, L’universale, Costituzionalismo*, Le Garzantine.
4. C Gaumer and P Griffith, (1998). “*Whose Life is it Anyway? An Analysis and Commentary on the Emerging Law of Physician Assisted Suicide*” 42 *S D L Rev* 357; Bradbury.
5. C. Casonato, (2009). *Introduzione al biodiritto. La bioetica nel diritto costituzionale comparato*, Torino.
6. Durkheim E. (1897). “*Vetëvrasja: një studim në sociologji*”.
7. E. Sgreccia, “*Manuale di bioetica*” vol.1, *Bioetica, eutanasia e dignità della morte*.

8. *Eutanazia për Xhorxhin V*, Gazeta Vima. 14/12/1986.
9. F Pakes, (2005). “*Under Seige: The Global Fate of Euthanasia and Assisted Suicide Legislation*” 13 *Eur J Crime*, Cr L & Cr J 119.
10. F. Giunta, (1997). “*Diritto di morire e diritto penale. I termini di una relazione problematica*”, Riv. It. Dir. Proc. Pen.
11. F. Sudre, (2005). *E drejta ndërkombëtare dhe europiane e të drejtave të njeriut*, Shtypi Universitar i Francës, Koleksioni E drejta themelore, botimi i 7-të.
12. F.M. Kamm, (1996). *Morality, Mortality*, vol. 2, Oxford: OUP, 272 (emphasis in the original)...
13. G S Neeley, (1995). “*The Right to Self Directed Death: Reconsidering an Ancient Proscription*” 35 *Catholic Law*.
14. Iason E, (1999). *Problematika e eutanazisë*, bot Sakoula, Athinë-Komotini.
15. J Scherer and R Simon, (1999). *Euthanasia and the Right to Die: A Comparative View*. Rowman & Littlefield Publishers, Lanham.
16. J Scherer, (1997). *Final Rights: An International Comparative Study of Euthanasia Regulations and Right to Die Issues*, 53, quoted in Bradbury.
17. J-P. Marguenaud, *Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut*, Dalloz, Paris koleks. Njohje e së drejtës, Botimi i 2-të.
18. Karabela D. Lambros, (1987). ‘*Eutanazia dhe e drejta e jetës dhe e vdekjes*’, bot. Estia, Athinë.
19. Katrougkalos G. (1993). *E drejta për jetën dhe vdekjen*, Athinë.

20. M. Janis, R. Kay, and A. Bradley, (2008). *European Human Rights Law Texts and Materials*. 3rd ed.
21. M. Kumm, 'Political Liberalism and the Structure of Rights: On the Place and Limits of the Proportionality Requirement' in Paulson and Pavlakos (eds).
22. More Th. (1981). *Utopia*, translated by Paul Turner, New York: Penguin.
23. N Lev, (1995). "The Legalisation of Euthanasia: The Right to Die or the Duty to Die?" 19 *Suffolk Transnat'l L*.
24. New York Task Force on Life and the Law, (1994). *When Death is Sought: Assisted Suicide and Euthanasia in the Medical Context*. at 79.
25. OTA Kraous-Erick Koukla, (1979). "Ausvic-I, Fabrika e vdekjes", Athinë.
26. P. BARILE, (1984). *Diritti dell'uomo e Libertà fondamentali*, Il Mulino.
27. P. CARETTI, (2005). *I Diritti Fondamentali, libertà e diritti sociali*, II Ed., Giappichelli.
28. P. RIDOLA, (2007). *Diritti Costituzionali, Il Diritto*, Enc. Giur., vol. 5, Il Sole 24 ore.
29. Pavlos D, *Enciklopedia e madhe greke*", vol 11.
30. Platoni, "Politia", Libri III.
31. R Sharpe, K Swinton and K Roach, (2002). *The Charter of Rights and Freedoms* (2nd ed) Irwin Law.
32. R. Alexy, (2002). *A Theory of Constitutional Rights* (Julian Rivers, trans, Oxford: OUP.
33. R. Nozick, (1974). *Anarchy, State, and Utopia*, Oxford: Blackwell.

34. Robert Alexy. (2007). *Law, Rights, Discourse: Themes of the Work of* , Oxford: Hart.
35. Sudre F, *Detyrimet positive në jurisprudencën europiane të drejtave të njeriut*, Revista tremujore e të Drejtave të Njeriut » 1995 faqe 363 dhe s. A.R. MOWBRAY,
36. Watkin, (2004). ‘*Controlling the Use of Force: A Role for Human Rights Norms in Contemporary Armed Conflict*’, 98 *AJIL* 1.
37. Zdenkowski, (1997). “*The International Covenant on Civil and Political Rights and Euthanasia*” 20 *UNSW Law Journal*.

- **Praktikë Gjyqsore**

- *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit 1978, para. 161.
- *Ağdaş kundër Turqisë*, vendimi i 27 korrikut 2004.
- *Ahmed kundër Austrisë*, vendimi i 27 nëntorit 1996.
- *Alex Menson dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 47916/99, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 6 majit 2003.
- *Alex Menson dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 47916/99, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 6 majit 2003
- *Coard et al. kundër Shteteve të Bashkuara*, Komisioni Ndër-Amerikan i të Drejtave të Njeriut, vendimi i 29 shtatorit 1999.
- *Ergi kundër Turqisë*, vendimi i 28 korrikut 1998.
- *Ergi kundër Turqisë*, vendimi i 28 korrikut 1998.

- *Ertak kundër Turqisë*, vendimi i 9 majit 2000, paragrafët 35-40
- *Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, vendimi i 9 dhjetorit 1994.
- *Guerra dhe të Tjerë kundër Italisë*, vendimi i 19 shkurtit 1998.
- *Gulec kundër Turqisë*, vendimi i 27 korrikut 1998,
- *Gal kundër Turqisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2000,
- *Gulec kundër Turqisë*, vendimi i 27 korrikut 1998,
- *Oğur kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 20 majit 1999.
- *Hugh Johnson kundër Mbretërisë së Bashkuar*
- *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit 1978, para. 161.
- *Isayeva kundër Rusisë*, vendimi i 24 shkurtit 2005.
- *Isayeva, Yusupova dhe Bazayeva kundër Rusisë*, vendimi i 24 shkurtit 2005.
- *Johnston dhe të tjerë kundër Anglisë*, 27 shtator 1986.
- *Kashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, vendimi i 24 shkurtit 2005.
- *Kaya kundër Turqisë*, vendimi i 19 shkurtit 1998.
- *Kaya kundër Turqisë*, vendimi i 19 shkurtit 1998.
- *Kelly dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit 2001.
- *Kelly kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit 2001.
- *Kılıç kundër Turqisë*, vendimi i 28 marsit 2000,
- *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 qershorit 1998.
- *Loizidou kundër Turqisë (Kundërshtimet Paraprake)*, vendimi i 23 shkurtit 1995.

- *Lopez Burgos kundër. Uruguait dhe Celiberti de Casariego kundër Uruguait*, nr. 52/1979 dhe 56/1979.
- *Lopez Ostra kundër Spanjës*, vendimi i 24 nëntorit 1994.
- *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe të 4 shkurtit 2005. *McCann dhe te Tjere kunder Mbreterise se Bashkuar*, vendimi i Dhomes se Madhe te 27 shtatorit 1995,
- *Mutatis mutandis, İlhan kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2000,
- *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 nëntorit 1991,
- *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (II)*, vendimi i 26 nëntorit 1991,
- *Groppera Radio AG dhe të Tjerë kundër Zvicrës*, vendimi i 28 marsit 1990.
- *Ocalan kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 majit 2005
- *Oneryildiz kundër Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe të 30 nëntorit 2004 (vendimi i Dhomës i rishikuar nga Dhoma e Madhe doli më 18 qershor 2002).
- *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998.
- *Pastori X dhe Kisha e Shentologjisë kundër Suedisë*, Kërkesa Nr. 7805/77, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 5 majit 1979 (ka kthyer në të kundërtën një vendim të hershëm: *Kisha e X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 3798/68, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 17 dhjetorit 1968).
- *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 29 prillit 2002.

- *Qipro kundër Turqisë*, vendimi i 10 majit 2001.
- *Reeve kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 24844/94, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 30 nëntorit 1994.
- *Said kundër Holandës*, vendimi i 5 korrikut 2005.
- *Sanles Sanles kundër Spanjës*, Vendimi për Pranueshmërinë i 20 tetorit 2000.
- *Shanaghan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit 2001.
- *Shanaghan-, Hugh Jordan-, Kelly- dhe McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar*
- *Gul kunder Turqisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2000, para. 89.
- *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 qershorit 1989.
- *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë* (shih shënimin e mësipërm). *Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, vendimi i 7 korrikut 1989.
- *Tomasi kundër Francës*, vendimi i 27 gushtit 1992, paragrafët 108-110.
- Vendimi LCB kundër Anglisë i 9 qershorit 1998, paragrafi 36.
- Vendimi në çështjen *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* i 14 marsit 2002.
- Vendimi *Osman kundër Anglisë* i 28 tetorit 1998,
- Vendimi te *Gaskin kundër Anglisë*, 23 qershor 1989,
- *Vendimi tek D. kundër Mbretërisë së Bashkuar*,
- Vendimin për çështjen *Yaşa kundër Turqisë*, vendimi i 2 shtatorit 1998
- Vendimin *Yaşa kundër Turqisë*, vendimi i 2 shtatorit 1998, paragrafët 102-104; *Cakıcı kundër Turqisë*, vendimi i 8 korrikut 1999;

- *Tanrikulu kundër Turqisë*, vendimi i 8 korrikut 1999, para. 109; *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, vendimi i 28 marsit 2000,
- *X kundër Gjermanisë*, Kërkesa Nr. 10565/83, Vendimi mbi Pranueshmërinë i 9 majit 1984.
- *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesë nr.8416/79, Vendim për Papranueshmërinë i 13 Majit 1980.